



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
ZËVENDËSKRYEMINISTRI

## MATERIAL PËRMBLEDHËS

*PËR MARRJEN E MASAVE DHE MONITORIMIN E  
VEPRIMTARISË, SJELLJES APO PËRDORIMIT TË  
BURIMEVE NJERËZORE, FINANCIARE DHE  
LOGJISTIKE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE,  
GJATË PROCESIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET E  
KUVENDIT TË SHQIPERISË PËR VITIN 2017*

**Miratoi:**  
Zëvendëskryeministri  
dhe  
Kryetari i Task-Forcës  
**LEDINA MANDIJA**

TIRANË, GUSHT 2017

## **PËRMBAJTJA E LËNDËS:**

- I. Hyrje**
- II. Qëllimi i Task-Forcës dhe Monitorimi**
- III. Objekti i Monitorimit**
- IV. Metodologjia e Ndjekur për Monitorimin gjatë Procesit Zgjedhor**
- V. Problematikat të lidhura me Bashkërendimin e Punëve gjatë Procesit të Monitorimit në Ministri dhe Institucione**
- VI. Koordinimi i Task-Forcës me Institucionet e Pavarura dhe Problematikat e Konstatuara**
- VII. Mbledhjet e Task-Forcës dhe Masat e Marra**
- VIII. Komunikimi me Publikun përmes Medias Vizive, Elektronike dhe Shtypit të Shkruar dhe Transparenca**
  - (i) Komunikimi me Publikun dhe Transparenca**
  - (ii) Komunikimi me Publikun Ditën e Zgjedhjeve**
  - (iii) Komunikimi me Subjekte Elektorale**
- IX. Rezultati i Monitorimit sipas Informacionit dhe Raportimit të bërë nga Institucionet**
  - A. Ngritja e grupeve të monitorimit dhe mënyra e funksionimit të tyre**
    - I. Ministrinë, Institucionet e Varësisë, Entet Publike dhe shoqëritë shtetërore*
    - II. Prefektura*
    - III. Bashkitë dhe ndërmarrjet në pronësi të tyre*
  - B. Caktimi i personit të kontaktit në Task-Forcë**
    - I. Ministrinë, Institucionet e Varësisë, Entet Publike dhe shoqëritë shtetërore*

**C. Shmangia e keqpërdorimit dhe keqinterpretimit të aktiviteteve institucionale në fushatë elektorale**

***I. Ministritë, Institucionet e Varësisë, Entet Publike dhe shoqëritë shtetërore***

***II. Prefektura***

**D. Sjellja dhe veprimtaria e administratës shtetërore dhe punonjësve të tjerë civilë**

***I. Ministritë, Institucionet e Varësisë, Entet Publike dhe shoqëritë shtetërore***

- (i)** Lejet vjetore gjatë fushatës zgjedhore
- (ii)** Masat e marra ndaj nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë civilë për pjesëmarrje në fushatë elektorale
- (iii)** Masat e pezullimit ndaj punonjësve kandidatë për deputetë
- (iv)** Angazhimi si komisionerë në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve të punonjësve të administratës dhe institucioneve të tjera

***II. Prefektura***

- (i)** Lejet vjetore gjatë fushatës zgjedhore
- (v)** Masat e marra ndaj nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë civilë për pjesëmarrje në fushatë elektorale
- (ii)** Masat e pezullimit ndaj punonjësve kandidatë për deputetë
- (vi)** Angazhimi si komisionerë në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve të punonjësve të administratës dhe institucioneve të tjera

***III. Bashkitë dhe ndërmarrjet në pronësi të tyre***

- (i)** Lejet vjetore gjatë fushatës zgjedhore
- (ii)** Masat e marra ndaj nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë civilë për pjesëmarrje në fushatë elektorale
- (iii)** Masat e pezullimit ndaj punonjësve kandidatë për deputetë
- (vii)** Angazhimi si komisionerë në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve të punonjësve të administratës dhe institucioneve të tjera

**E. Punësimet, largimet, transferimet dhe lëvizjet paralele gjatë fushatës elektorale**

***I. Ministritë, Institucionet e Varësisë, Entet Publike dhe shoqëritë shtetërore***

**II. Prefektura**

**III. Bashkitë dhe ndërmarrjet në pronësi të tyre**

**IV. Trajtimi i rasteve të tilla nga Zyra e Zëvendëskryeministrit**

**F. Përdorimi i burimeve financiare dhe logjistike të shtetit gjatë procesit zgjedhor**

**I. Ministritë, Institucionet e Varësisë, Entet Publike dhe shoqëritë shtetërore**

- (i) Shpenzimet e programuara dhe faktike gjatë procesit zgjedhor
- (ii) Konsumi mujor i karburantit
- (iii) Përdorimi i aseteve
- (iv) Dhënia e premtimeve, favoreve, moscënimi i të drejtave me qëllim favorizimin apo dhënien e votës një subjekti të caktuar politik

**II. Prefektura**

- (i) Shpenzimet e programuara dhe faktike gjatë procesit zgjedhor
- (ii) Konsumi mujor i karburantit
- (iii) Përdorimi i aseteve

**III. Bashkitë dhe ndërmarrjet në pronësi të tyre**

- (i) Shpenzimet e programuara dhe faktike gjatë procesit zgjedhor
- (ii) Konsumi mujor i karburantit
- (iii) Përdorimi i aseteve

**G. Përdorimi gjatë fushatës dhe procesit zgjedhor të mjeteve financiare nga burime të paligjshme apo të krijuara nga veprimtari të paligjshme**

- (i) Transaksionet e dyshimta gjatë fushatës elektorale dhe vitit elektorale 2017
- (ii) Tërheqjet e parave nga bankat e nivelit të dytë; paraja në qarkullim gjatë fushatës elektorale dhe vitit elektorale 2017
- (iii) Financimi i subjekteve elektorale përmes mjeteve financiare të krijuara nga veprimtari e paligjshme

**H. Përditësimi dhe ndjekja e problematikës me listat e zgjedhësve**

**I. Njoftimi apo kryerja e kallëzimeve penale në organin e Prokurorisë për rastet e marrjes/vënies në dijeni për veprat penale në fushën zgjedhore.**

- (i) Rastet e referuara apo kallëzuara në Prokurori nga Ministritë apo institucionet e tjera
- (ii) Rastet e referuara në Prokurori nga Policia e Shtetit
- (iii) Rastet e trajtuara dhe adresuara/kallëzuara në Prokurori nga Zyra e Zëvendëskryeministrit
- (iv) Rastet e referuara në Prokurori nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

**J. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës më Policinë e Shtetit në funksion të marrjes së masave të menjëhershme kur konstatohen raste të sjelljeve apo veprimtarisë së paligjshme**

- (i) Koordinimi dhe bashkëveprimi i Task-Forcës me Policinë e Shtetit në ndjekjen e rasteve të caktuara gjatë fushatës zgjedhore
- (ii) Implikimi i forcave të policisë në mbështetje të subjekteve elektorale dhe bashkëpunim me elementët kriminalë
- (iii) Shitblerja e votës gjatë fushatës elektorale dhe ditën e votimit

**X. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

**XI. TABELA**

**XII. ANEKSE**

## **TABELA**

**TABELA I** ‘Përmbledhëse e të gjithë informacionit të dërguar pranë Task Forcë nga Ministrinë dhe Institucionet e tyre të varësisë’

**TABELA II** ‘Masat e marra ndaj nëpunësve civil dhe punonjësve të tjerë civil të Ministrive dhe Institucioneve të varësisë për pjesëmarrje në fushatë elektorale’

**TABELA III** ‘Masat e pezullimit ndaj punonjësve kandidat për deputet për Ministrinë dhe Institucionet e varësisë’

**TABELA IV** ‘Punësime të bëra gjatë fushatës elektorale në Ministri dhe institucione të varësisë’

**TABELA V** ‘Përmbledhëse e të gjithë informacionit të dërguar pranë Task Forcë nga Bashkitë’

**TABELA VI** ‘Përmbledhëse e të gjithë informacionit të dërguar pranë Task Forcë nga Prefekturat’

## ANEKSE

**ANEKS I** - Raport i Monitorimit Ministria e Drejtësisë, shkresë nr. 3728/3 prot, dt. 10.07.2017

**ANEKS II** - Raport i Monitorimit Ministria e Arsimit dhe Sportit, shkresë nr. 6719/1 prot, dt. 10.07.2017

**ANEKS III** - Raport i Monitorimit Ministria e Mirëqenies Sociale Rinisë dhe Sporteve, shkresë nr. 3578/1 prot, dt. 10.07.2017

**ANEKS IV** - Raport i Monitorimit Ministria e Financave, shkresë nr. 9161/9 prot, dt. 10.07.2017

**ANEKSV** - Raport i Monitorimit Ministria e Shëndetësisë, shkresë nr.2803/8 prot, dt. 10.07.2017

**ANEKS VI** - Raport i Monitorimit Ministria e Punëve të Brendshme, shkresë nr. 5474/1 prot, dt. 10.07.2017

**ANEKS VII** - Raport i Monitorimit Ministria e Kulturës, shkresë nr. 4594/1 prot, dt. 10.07.2017

**ANEKS VIII** - Raport i Monitorimit Ministria e Mbrojtjes, shkresë nr. 4252/2 prot, dt. 10.07.2017

**ANEKS IX** - Raport i Monitorimit Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, shkresë nr. 3697/1, dt. 14.07.2017

**ANEKS X** - Raport i Monitorimit Ministria e Energjisë dhe industrisë, shkresë nr. 4841/1, dt.13.07.2017

**ANEKS XI** - Raport i Monitorimit Ministria e Zhvillimit Ekonomisë Turizmit Tregtisë dhe Sipërmarrjes, shkresë nr. 5996/1, dt. 10.07.2017

**ANEKS XII** - Raport i Monitorimit Ministria e Zvillimit Urban, shkresë nr. 3930/1 prot, dt. 10.07.2017

**ANEKS XIII** - Raport i Monitorimit Ministria e Punëve të Jashtme, shkresë nr. 10272 prot, dt. 7.07.2017

**ANEKS XIV** - Raport i Monitorimit Ministria e Mjedisit, shkresë nr. 5508/1 prot, dt. 17.07.2017

**ANEKS XV** - Raport i Monitorimit Ministria e Integritit, shkresë nr. 1485/1 prot, dt. 10.07.2017

**ANEKS XVI** - Raport i Monitorimit Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, shkresë nr. 5203/1, dt.24.07.2017

**ANEKS XVII - Kërkesa për Informacion për Ministrinë, Bashkitë dhe Prefekturat**

(i) Shkresë nr. 3294 prot, dt. 7.06.2017 drejtuar DPPP

(ii) Shkresë nr. 3295 prot, dt.7.06.2017 drejtuar DPSH

- (iii) Shkresë nr. 3296 prot, dt.7.06.2017, drejtuar PP
- (iv) Shkresë nr. 3297 prot, dt. 7.06.2017, drejtuar të gjitha Bashkive
- (v) Shkresë nr. 3298 prot, dt. 7.06.2017, drejtuar të gjitha Prefekturave
- (vi) Shkresë nr. 3299 prot, dt. 7.06.2017, drejtuar të gjitha Ministrive
- (vii) Shkresë nr. 3300 prot, dt. 7.06.2017, drejtuar të gjitha Ministrive
- (viii) Shkresë nr. 3311 prot, dt. 8.06.2017, drejtuar KQZ
- (ix) Shkresë nr. 3315 prot, dt. 8.06.2017, drejtuar KMSHC
- (x) Shkresë nr.3316 prot, dt.8.06.2017, drejtuar DAP
- (xi) Shkresë nr. 3369 prot, dt. 12.06.2017, drejtuar të gjitha Ministrive
- (xii) Shkresë nr. 3370 prot, dt. 12.06.2017, drejtuar të gjitha Ministrive
- (xiii) Shkresë nr. 3371 prot, dt.12.06.2017, drejtuar të gjitha Prefekturave
- (xiv) Shkresë nr. 3372 prot, dt. 12.06.2017, drejtuar të gjitha Prefekturave
- (xv) Shkresë nr. 3373 prot, dt. 12.06.2017, drejtuar të gjitha Bashkive
- (xvi) Shkresë nr. 3374 prot, dt. 12. 06.2017, drejtuar të gjitha Bashkive
- (xvii) Shkresë nr. 3394 prot, dt.13.06.2017, drejtuar të gjitha Bashkive
- (xviii) Shkresë nr. 3395 prot, dt.13.06.2017, drejtuar të gjitha Ministrive
- (xix) Shkresë nr. 3467 prot, dt. 13.06.2017, drejtuar KMSHC
- (xx) Shkresë nr.3468 prot, dt. 16.06.2017, drejtuar DAP
- (xxi) Shkresë nr.3469 prot, dt.16.06.2017, drejtuar MPB
- (xxii) Shkresë nr. 3470 prot, dt. 16.06. 2017, drejtuar të gjitha Ministrive
- (xxiii) Shkresë nr.3471 prot, dt. 16.06.2017, drejtuar të gjitha Ministrive
- (xxiv) Shkresë nr. 3472 prot, dt. 16.06.2017, drejtuar të gjitha Prefekturave
- (xxv) Shkresë nr.3473 prot, dt. 16.06.2017, drejtuar të gjitha Prefekturave
- (xxvi) Shkresë nr. 3474 prot, dt. 16.06.2017, drejtuar të gjitha Bashkive
- (xxvii) Shkresë nr. 3475 prot, dt. 16.06.2017, drejtuar të gjitha Bashkive
- (xxviii) Shkresë nr. 3546 prot, dt. 21.06.2017, drejtuar PP
- (xxix) Shkresë nr. 3594 prot, dt. 27.06.2017, drejtuar të gjitha Ministrive
- (xxx) Shkresë nr. 3595 prot, dt. 27.06.2017, drejtuar DPP, MPB
- (xxxi) Shkresë nr. 3596 prot, dt. 27.06.2017, drejtuar të gjithë subjekteve zgjedhore
- (xxxii) Shkresë nr. 3642 prot, dt. 30.06.2017, drejtuar KQZ
- (xxxiii) Shkresë nr. 3643 prot, dt. 30.06.2017, drejtuar DAP

## **ANEKSI XVIII - Komunikimet me Publikun për gjashtë Mbledhjet e Task Forcës**



## SHKURTIME

**DPPP** - Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave

**KM** - Këshilli i Ministrave

**KMSHC** - Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ose Komisioneri

**KQZ** - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

**MAS** - Ministria e Arsimit dhe Shkencës

**MD** - Ministria e Drejtësisë

**MEI** - Ministria e Energjisë dhe Industrisë

**MF** - Ministria e Financave

**MM** - Ministria e Mbrojtjes

**MMJ** - Ministria e Mjedisit

**MMSR** - Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

**MPB** - Ministria e Punëve të Brendshme

**MPJ** - Ministria e Punëve të Jashtme

**MSH** - Ministria e Shëndetësisë

**MTI** - Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

**MZHETTS** - Ministria e Zhvillimit Ekonomisë Turizmit Tregtisë dhe Sipërmarrjes

**MBZHRAU** - Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave

**MZHU** - Ministria e Zhvillimit Urban

**PP** - Prokuroria e Përgjithshme

**OSBE** - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

**OJF** - Organizata Jo Fitimprurëse

**SP** - Sekretari i Përgjithshëm

**VKM 473/2017- VKM nr. 473/2017** “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017”

**Urdhri 65/2017-** Urdhri i Kryeministrit nr. 65, datë 12.05.2017 “Për marrjen e masave për ndalimin e vënies në përdorim për subjektet zgjedhore të mjeteve, fondeve dhe materialeve të ndryshme, pronë e administratës publike, si dhe të burimeve njerëzore të institucioneve të administratës publike të çdo niveli për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 Qershor 2017”

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Monitorimi i veprimtarisë së administratës gjatë fushatës zgjedhore në zbatim të marrëveshjes politike të datës 18.05.2017 është realizuar nga ana e Task Forcës si dhe të grupeve të monitorimit në institucione të ngritura për këtë qëllim në bazë të VKM nr. 473, datë 01.06.2017 “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017” si dhe të kuadrit ligjor në fuqi.

### *(i) Mbi veprimtarinë e Task Forcës*

1. VKM për monitorimin e zgjedhjeve në administratë publike, u miratua më datë 01.06.2017, pasi kishte filluar fushata zgjedhore.
2. Task – Forca e ngritur për monitorimin e zbatimit të VKM nr. 473/2017, u konstituua më datë 5 Qershor 2017. Kjo strukturë kishte në dispozicion vetëm 20 ditë për realizimin e monitorimit dhe koha e shkurtër pamundësoi një monitorim efektiv, duke penguar në këtë mënyrë parandalimin e abuzimeve me pushtetin dhe pasojave të tjera negative në zgjedhje. Gjithashtu, Task-Forcës nuk ju vunë në dispozicion mjetet e nevojshme financiare apo logjistike, për të kryer një proces real monitorimi. Të gjitha këto shkaqe, bënë të vështirë, deri në pamundësi, përmbushjen e misionit të ngarkuar.
3. Në mbledhjet e Task-Forcës nuk kanë marrë pjesë në asnjë mbledhje Ministrat e mazhorancës anëtarë të Task-Forcës. Nuk kanë marrë pjesë përfaqësuesi i Prokurorisë dhe KQZ, në cilësinë e subjekteve të ftuara.
4. Ministritë dhe Institucionet e varësisë kanë ngritur grupet e monitorimit, por në shumicën e rasteve nuk kanë treguar procedurën e monitorimit dhe efektivitetin e saj.
5. Informacioni nuk është përcjellë në formën e kërkuar dhe në cilësinë e duhur, duke penguar diskutimin e problematikave në mbledhjen e Task-Forcës sa i takon objektit

të monitorimit. Madje nga monitorimi i kryer drejtpërdrejtë nga Task Forca për disa nga rastet e denoncuara ka rezultuar se informacioni i përcjellë ka qenë i pavërtetë, duke e bërë të dyshimtë edhe besueshmërinë e të dhënave të tjera të raportuara nga këto ministri.

6. Ministrat teknikë janë përballur me mungesë të vullnetit politik të demonstruar nga pengesa artificiale në ushtrimin e detyrës së tyre në funksion të monitorimit, të krijuar nga nëpunës civil apo funksionarë politikë, të cilët kishin si qëllim të pengonin punën e ministrave në zbatim të VKM 473/2017. Departamenti i Administratës Publike dhe veçanërisht KMSHC si një organ i pavarur, kanë mbajtur një qëndrim tërësisht të njëanshëm dhe mbështetës për sjellje të tilla penguese nga nëpunës civilë të nivelit të lartë.

*(ii) Mbi ecurinë e procesit zgjedhor*

Nga procesi i monitorimit të veprimtarisë së administratës gjatë fushatës zgjedhore nga ana e Task Forcës ka rezultuar se:

1. Janë angazhuar në mënyrë masive burime të dyshimta financiare në shit-blerjen e votës nga subjekte politike të mazhorancës ose persona të lidhur me këto subjekte, e raportuar kjo nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërkohë që Drejtoria e Paranadalimit dhe Pastrimit të Parave nuk ka raportuar raste të tilla.  
Kursi i këmbimit i monedhës Euro kundrejt asaj Lek, referuar Bankës së Shqipërisë, duke filluar nga data 19.05.2017 ka pësuar rënie domethënëse deri në datë 27.06.2017 pas të cilës ka nisur përsëri rivlerësimi i Euros, duke arritur kështu nivelin më të ulët prej shumë vitesh.
2. Janë angazhuar grupime të njohura kriminale në mbështetje të subjekteve politike të mazhorancës në fushatën elektorale veçanërisht në qarqet Durrës, Shkodër, Lezhë, Dibër, Elbasan, Tiranë, Berat, Fier dhe Gjirokastrë.
3. Punonjës të Policisë së Shtetit kanë mbështetur subjekte elektorale të mazhorancës në bashkëpunim me elementë kriminalë. Pavarësisht kërkesave të njëpasnjëshme të

Ministrit të Punëve të Brendshme, Drejtori Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka refuzuar marrjen e masave ndaj punonjësve të implikuar.

4. Në Ministrinë e Punëve të Brendshme, nga ana e qytetarëve kanë mbërritur 484 denoncime lidhur me veprat penale në fushën zgjedhore, të cilat i janë përcjellë për trajtim Policisë së Shtetit ku kjo e fundit vetëm 69 prej tyre i ka adresuar në Prokurori.
5. Rezulton fenomen i përhapur shitblerja e votës. Nga 484 denoncimet e mbërritura në MPB, 315 raste i përkasin ‘Korrupsionit aktiv dhe pasiv në zgjedhje’, për të cilat Policia e Shtetit nuk ka dhënë informacion lidhur me masat e marra për verifikimin e tyre. Policia ka dështuar të japë një shifër të saktë të çështjeve të adresuara në Prokurori për shitblerjen e votës gjatë fushatës elektorale, por ka raportuar vetëm 10 raste të verifikuara dhe të dërguara për veprime të mëtejshme në Prokurori në ditën e zgjedhjeve.
6. Në procesin e shitblerjes së votës janë përfshirë punonjës të administratës të nivelit të lartë dhe punonjës të policisë, për të cilët pavarësisht denoncimeve nuk është arritur të vihen para përgjegjësisë.
7. Nga institucionet shtetërore – kryesisht ministra teknikë - janë dërguar në organin e prokurorisë rreth 110 raste të dyshuara për kryerje të veprave penale në fushën e zgjedhjeve të cilat janë në proces hetimi.
8. Koordinimi mes Policisë së Shtetit dhe Ministrive nuk ka qenë në nivelin e duhur sa i takon monitorimit të veprimtarisë së administratës gjatë fushatës elektorale, përfshirë dhe ditën e zgjedhjeve në zbatim të masave operacionale të miratuara nga Task Forca.
9. Puna e Policisë së Shtetit, në parandalimin e korrupsionit zgjedhor dhe parandalimin e angazhimit të grupimeve kriminale në procesin zgjedhor, për shkaqe objektive dhe subjektive, ka qenë joefektive.
10. Është përdorur veprimtaria institucionale për qëllime elektorale dhe politike. Përvetësimi i veprimtarisë shtetërore nga kandidatë për deputetë, ka krijuar një pabarazi midis forcave politike pjesëmarrëse në zgjedhje.
11. Është konstatuar përdorimi i aseteve në mbështetje të subjekteve elektorale nga Ministri, institucione varësie dhe Bashkitë. Janë përdorur gjithashtu aktivitete në kopshte, shkolla, inaugurimi i shesheve dhe rrugëve për fushatë elektorale të

subjekteve elektorale në qeverisje, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore janë shpërndarë ftesa për të votuar subjekte elektorale të mazhorancës në kundërshtim flagrant me Kodin Zgjedhor. Shkolla, kopshte, ambiente të institucioneve janë vënë në dispozicion të subjekteve elektorale të mazhorancës.

12. Është konstatuar dhënia e privilegjeve të ndryshme gjatë fushatës elektorale, si pajisja me certifikatë pronësie, legalizimit, premtimi i vendeve të punës, premtimi i vlerësimit kalues ose më të lartë gjatë procesit të maturës shtetërore, etj.
13. Gjatë këtij viti elektoral janë tenderuar vlera të cilat tejkalojnë disa herë buxhetin e miratuar të një ministrie të caktuar.
14. Nëpunës të administratës publike, të regjistruar si kandidatë në zgjedhje, nuk kanë përmbushur detyrimin për të kërkuar pezullimin apo largimin nga detyra.
15. Nëpunës të administratës publike, në kundërshtim me ligjin, janë përfshirë në fushatë zgjedhore, në mbështetje ndaj subjekteve elektorale të mazhorancës, apo në intimidim të votuesve apo punonjësve në varësinë e tyre, duke i shërbyer në këtë mënyrë forcave të caktuara politike.
16. Ka rezultuar se raste të përfshirjes së administratës në fushatë të jenë evidentuar vetëm në ministritë apo drejtoritë e drejtuara nga ministra/drejtorë teknik. Pothuajse nuk ka pasur asnjë raportim për raste të tilla nga ministritë apo institucionet e tjera. Madje edhe në rastet kur është adresuar nga ana e një ministri në një institucion varësie, sërish nuk është marrë asnjë masë, pavarësisht se provat kanë qenë të pakontestueshme.
17. Gjatë fushatës zgjedhore sipas të dhënave zyrtare nga ana e organeve tatimore janë kryer rreth 3600 lëvizje të burimeve njerëzore në administratë publike në kundërshtim me nenin 88 të Kodit Zgjedhor. Në të gjitha rastet e verifikuara nga Task Forca ka rezultuar që vetdeklarimet nga institucionet e monitoruara kanë qenë të rreme. Kjo çështje është adresuar në Prokurori nga ZV/Kryeministri, ndërkohë që është penguar nga protokolli i Kryeministrit për veprime të mëtejshme.

## I. HYRJE

Në datë 18.05.2017, mazhoranca dhe opozita, të asistuar ngushtësisht nga partnerët ndërkombëtarë, nënshkruan një marrëveshje politike.

Në pjesën hyrëse marrëveshja politike, ndër të tjera përcakton se *“Angazhimi i palëve për zgjedhje me standarde demokratike do të jetë pjesë thelbësore e kontributit të përbashkët dhe të vazhdueshëm të palëve në kuadër të çeljes së negociatave dhe përparimit të vendit në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë”*.

Në bazë të marrëveshjes politike, u dakordësuar që të beshin ndryshime në qeveri në rang Zëvendëskryeministri, Ministrash dhe drejtorësh të lartë në disa institucione të administratës shtetërore, duke u vendosur në këto funksione persona teknik.

Në këto kushte, u ndryshua përbërja e Këshillit të Ministrave, duke u propozuar nga Partia Demokratike dhe emëruar në përputhje me procedurat ligjore dhe parlamentare Zëvendëskryeministri, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Punëve të Brendshme, Ministri i Financave, Ministri i Arsimit dhe Sportit, Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministri i Shëndetësisë. Gjithashtu, më pas, u emëruan edhe drejtorët e rënë dakord sipas marrëveshjes në fjalë.

Duhet theksuar se emërimi i ministrave në fjalë u bë në përputhje të plotë me procedurat kushtetuese dhe parlamentare, pavarësisht etiketimit të tyre si ministra “teknikë”. Këta ministra në aspekt kushtetues dhe ligjor gëzojnë të gjitha të drejtat kushtetuese dhe ligjore. Gjithsesi ministrat në fjalë kanë qenë të ndërgjegjshëm për qëllimin e emërimit të tyre dhe i kanë ushtruar detyrat e tyre vetëm për këtë qëllim pa ndërhyrë në zbatimin e politikave të shumicës qeverisëse të përcaktuara në programin qeverisës.

Me marrjen e detyrës, Ministrat filluan menjëherë monitorimin lidhur me përfshirjen e administratës shtetërore si nëpunës civilë, punonjësit me kontratë pune, punonjësit e policisë së shtetit, gardës, shërbimit informativ shtetëror, ushtarakët, etj. Monitorimi është kryer duke ndjekur përmbushjen e kuadrit ligjor në fuqi si Kodi Zgjedhor dhe ligji për partitë politike apo duke referuar rastet për trajtim të mëtejshëm në organin e Prokurorisë në përputhje me Kodin Penal.

Me qëllim garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, përveç ndryshimeve në kabinetin qeveritar, kryesimin e KQZ-së, ndryshimin e disa krerëve të institucioneve të dakordësuara nga forcat kryesore politike, një paketë ligjore u miratua në Parlament në datë 22 Maj 2017 dhe hyri në fuqi menjëherë, me qëllim krijimin e një klime më të qetë gjatë fushatës zgjedhore.

Me ligjin 89/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, u ashpërsuan sanksionet penale për veprat penale ekzistuese në fushën e zgjedhjeve dhe u parashikuan vepra penale të tjera, duke përcaktuar dhe sanksionet penale të ashpra ndaj subjekteve që do të përfshiheshin në cënimin e procesit zgjedhor.

Me ligjin 90/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar, u përcaktuan rregulla në drejtim të financimit të partive politike, monitorimit të shpenzimeve, kufizimit dhe përcaktimit të shpenzimeve në fushatë dhe dokumentimit të shpenzimeve.

Me ligjin nr. 91/2017 "Për një ndryshim në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, u përcaktuan dispozita për transmetimin e reklamave politike gjatë periudhës zgjedhore.

Zëvendëskryeministri me qëllim detajimin e detyrave të monitorimit ndërmori iniciativën në propozimin e një akti nënligjor me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave në drejtim të rolit monitorues dhe koordinues të Task-Forcës që do të ngrihej me qëllim garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme për qytetarët shqiptarë. Projekt-Vendimi u hartua në bashkëpunim me sektorin e hartimit të legjislacionit në Kryeministri dhe asistencën ligjore të ekspertëve të OSBE-së.

Përfundimisht, vendimi i miratuar nga Këshilli i Ministrave është ai nr. 473, datë 01.06.2017 "Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017" ("VKM 473/2017").

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi u shfuqizua Urdhri i Kryeministrit nr. 65, datë 12.05.2017 ("Urdhri 65/2017") "Për marrjen e masave për ndalimin e vënies në përdorim për subjektet zgjedhore të mjeteve, fondeve dhe materialeve të ndryshme, pronë e administratës publike, si

*dhe të burimeve njerëzore të institucioneve të administratës publike të çdo niveli për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 Qershor 2017” .*

Vendimi në fjalë, përveçse një akt me hierarki më të lartë se urdhri, zgjeroi si fushën e veprimit ashtu dhe rrethin e subjekteve të cilëve iu zbatohet krahasuar me urdhrin në fjalë të Kryeministrit.

Duke mbajtur në konsideratë:

- (i) objektin e Marrëveshjes Politike të datës 18 Maj 2017, ku caktimi i ministrave teknikë ishte në funksion të mbikëqyrjes së veprimtarisë së administratës në fushatë zgjedhore;
- (ii) faktin se tashmë procesi zgjedhor ka përfunduar tashmë;
- (iii) rolin dhe misionin e Task-Forcës, e cila përfundon veprimtarinë e saj me përfundimin e procesit zgjedhor.

Në cilësinë e Kryetares së Task-Forcës paraqes Materialin Përmbledhës “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2017”, i cili do të vihet në dijeni të anëtarëve të Task-Forcës, anëtarëve të ftuar në Task-Forcë, subjekteve zgjedhorë, organizmave ndërkombëtarë të përfshirë në fushën e zgjedhjeve dhe OJF-ve me objekt veprimtarie fushën e zgjedhjeve.

Qëllimi i këtij Materialin Përmbledhës është të vërë në dukje masat e marra për mbikëqyrjen e administratës shtetërore gjatë procesit zgjedhor, në kuadër të zbatimit të legjislacionit të posaçëm, pengesat e hasura si pasojë e politizimit të shërbimit civil, gjetjet e konstatuara gjatë procesit të monitorimit dhe nevojat për përmirësim në të ardhmen. Të dhënat e pasqyruara në këtë Material Përmbledhës janë vënë në dispozicion nga ana e Ministrive dhe institucioneve të varësisë dhe shoqëritë shtetërore të zotëruara apo kontrolluara nga shteti, entet publike, Prefekturat, Bashkitë dhe ndërmarrjet në pronësi të tyre si dhe Institucioneve të tjera të cilave u është kërkuar informacion nga ana e Kryetarit të Task-Forcës.

Në hartimin e këtij Materiali Përmbledhës, është bërë referencë në Raportet Përfundimtare të Ministrive<sup>1</sup> në përfundim të monitorimit të kryer si dhe në raportimet e tjera të bërë gjatë mbledhjeve të Task-Forcës nga anëtarët e Task-Forcës dhe raportime të tjera me shkrim nga institucione të ndryshme.

---

<sup>1</sup> Në disa nga Ministrinë, Raporti i Monitorimit në përmbajtje nuk përbën Raportim përfundimtar të monitorimit.



Të dhënat e pasqyruara në Materialin Përmbledhës përbëjnë të dhëna zyrtare nga Ministritë dhe institucionet e tjera në ushtrim të kompetencave të tyre bazuar në legjislacionin në fuqi në R.SH.-së.

Ky Material Përmbledhës, do të ketë bashkëngjitur në formën e Anekseve, të gjithë raportet e monitorimit të të gjitha ministrive që janë vënë në dispozicion të Task-Forcës.

## **II. QËLLIMI I TASK-FORCËS DHE MONITORIMIT**

Sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke përfshirë Kodin Zgjedhor, paketën ligjore të datës 22 Maj 2017 si dhe Urdhrin nr. 65/2017 të Kryeministrit, të gjitha Ministritë dhe Institucionet e tjera në nivel qendror apo lokal kishin për detyrë të merrnin masa për garantimin e një procesi sa më të qetë zgjedhor.

Urdhri 65/2017 i Kryeministrit kishte një fushë zbatimi më të kufizuar, konkretisht në drejtim të mospërdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe materiale të institucioneve të ndryshme publike dhe shpalljes së aktiviteteve institucionale me qëllim shmangien e keqpërdorimit apo keqinterpretimit të tyre.

Task-Forca e krijuar me VKM nr. 473/2017 ka si qëllim koordinimin e procesit të monitorimit si dhe marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017, me qëllim nxitjen e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve e partive politike në marrëdhëniet me administratën shtetërore dhe burimet e saj, për krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike në procesin elektoral, si dhe mospërdorimin e fondeve dhe burimeve publike për qëllime partiake.

Monitorimi që do të kryhej nga Ministritë, Institucionet e tjera në nivel qendror dhe vendor kishte si qëllim:

- (i) shmangien e përdorimit të burimeve njerëzore të administratës shtetërore në mbështetje të procesit zgjedhor;
- (ii) shmangien e përdorimit të burimeve financiare dhe logjistike të administratës shtetërore për qëllime partiake dhe të procesit zgjedhor;
- (iii) mbledhjen e informacionit rreth rasteve të përdorimit të parasë me burim të paligjshëm apo nga veprimtari të paligjshme me qëllim deformimin e vullnetit të

- zgjdhësve dhe referimin e tyre pranë organeve ligjzbatuese dhe të ndjekjes penale;
- (iv) pezullimin e iniciativave të reja për lidhjen e kontratave koncesionare apo të prokurimeve gjatë fushatës zgjedhore;
  - (v) monitorimin e rasteve të lidhjes së marrëdhënieve/kontratave të reja të punës, përfshirë kontrata pune të përkohshme, dhe shmangien e rasteve të punësimit, shkarkimeve apo transferimeve të punonjësve gjatë fushatës elektorale;
  - (vi) bashkëpunimin dhe ndërveprimin me Policinë e Shtetit, me qëllim referimin dhe ndjekjen e shkeljeve në fushën e zgjedhjeve, përfshirë ditën e votimit dhe raportimit në Task-Forcë nga kjo e fundit për rastet e referuara apo e ndjekura kryesisht;
  - (vii) bashkëpunimin me institucione të pavarura si Avokati i Popullit, Prokuroria, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mënyrë adresimin e menjëhershëm të problematikave të hasura sipas fushës së tyre të punës;
  - (viii) Përcjelljes së informacionit nga subjektet politikë për shkelje në fushën zgjedhore, duke synuar trajtimin e barabarte të tyre si dhe të kandidatëve të tyre deputetë në procesin elektoral.

### **III. OBJEKTI I MONITORIMIT**

Monitorimi i kryer nga Ministritë, Institucionet e tjera në nivel qendror dhe vendor referuar kuadrit ligjor në fuqi dhe kryesisht VKM 473/2017 konsistonte në:

- a. Monitorimin e sjelljes dhe veprimtarisë së administratës shtetërore;
- b. Monitorimin e administratës shtetërore në drejtim të përdorimit të autoritetit shtetëror vetëm në përputhje me ligjin duke mos lejuar përdorimin e burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të shtetit gjatë procesit zgjedhor si dhe duke mos lejuar kryerjen e veprimeve dhe/ose dhënien e premtimeve, favoreve apo moscënimin e të drejtave të shtetasve, si mekanizëm për favorizimin apo dhënien e votës një subjekti të caktuar politik;
- c. Monitorimin e punësimeve, shkarkimeve, transferimeve, lëvizjeve paralele, etj., gjatë fushatës elektorale referuar nenit 88 të Kodit Zgjedhor;
- d. Monitorimin e procesit zgjedhor me qëllim konstatimin dhe raportimin e përdorimit gjatë fushatës dhe procesit zgjedhor të mjeteve financiare nga burime të paligjshme apo të krijuara nga veprimtari të paligjshme;

- e. Monitorimin e procesit zgjedhor, përfshirë ditën e votimit, në funksion të mospërfshirjes në të, të zyrtarëve apo personave të tjerë që ndodhen në institucione shtetërore, përfshirë personat e burgosur, dhe marrjen e masave për ndëshkimin e atyre zyrtarëve që veprojnë në kundërshtim me ligjin. Pjesë e kësaj detyre është edhe monitorimi i lëvizjes së nëpunësve të lartë dhe të mesëm shtetërorë në qendër dhe qarqe apo bashki gjatë procesit zgjedhor;
- f. Monitorimin e përditësimit dhe ndjekjen e problematikave me listat e zgjedhësve;
- g. Monitorimin e zbatimit të masave për pezullimin e iniciativave për kontrata të përkohshme në nivel qendror e vendor;
- h. Bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me Policinë e Shtetit në funksion të marrjes së masave të menjëhershme në përputhje me ligjin kur konstatohen raste të sjelljeve apo veprimtarive të kundërligjshme gjatë procesit zgjedhor;
- i. Bashkëpunimin dhe ndërveprimin me Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave, me qëllim kryerjen e analizave dhe vlerësimeve për raste të përdorimit të parave për shitblerje të votës, përfshirë këtu përdorimin e parasë me burim të paligjshëm;
- j. Bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me institucionet e pavarura të ftuara në Task-Forcë brenda sferës së tyre të kompetencave;
- k. Çdo detyrë tjetër në funksion të monitorimit të zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi në fushën e zgjedhjeve dhe në mënyrë specifike referuar VKM 473/2017.

#### **IV. METODOLOGJIA E NDJEKUR PËR MONITORIMIN GJATË PROCESIT ZGJEDHOR**

Task-Forca ka koordinuar procesin e monitorimit të realizuar nga Ministritë dhe institucionet e tjera, si dhe në bashkëpunim me titullarët e ministrive dhe grupet e monitorimit ka përmbushur detyrat referuar pikës 31, të VKM 473/2017.

Monitorimi kryhej nga ministritë, përfshirë institucionet e tyre të varësisë, entet publike dhe shoqëritë shtetërore, prefekturat dhe bashkitë përfshirë ndërmarrjet në varësinë e tyre.

Në çdo ministri ngriheshin grupe monitorimi dhe këto grupe raportnin për ministrinë të cilës i përkisnin dhe për institucionet e varësisë së ministrisë në fjalë, përfshirë shoqëritë shtetërore dhe entet publike varësi e ministrisë. Ministritë referuar VKM-së 473/2017 vendosnin rregullat për realizimin e monitorimit dhe do të raportnin në Task-Forcë për rastet e ndjekura.

Monitorimi në Ministritë dhe institucionet e varësisë është bërë paralelisht, në mënyrë periodike mbi bazën e një plani të miratuar paraprakisht nga Ministri dhe mbi bazën e riskut spontan dhe të diktuar nga informacionet e marra nëpërmjet mjeteve të komunikimit me publikun të vëna në dispozicion nga Ministritë.

Zyra e Zëvendëskryeministrit, në cilësinë e drejtuesit të Task-Forcës, u ka adresuar institucioneve shtetërore që kryenin monitorimin një sërë pyetjesh të cilave duhej t'u jepej përgjigje. Në këtë kuadër, informacion është kërkuar edhe në lidhje me monitorimin e kryer referuar Urdhrit 65/2017.

Ministritë, Prefekturat dhe Bashkitë kishin për detyrë të mblidhnin informacionin nga institucionet, shoqëritë, entet publike apo ndërmarrjet në varësinë e tyre. Më pas, ky informacion do të përpunohej e konsolidohej (*në formë tabelore dhe përshkruese*) për t'iu dërguar nëpërmjet personit të kontaktit në çdo institucion sekretariatit teknik të Task-Forcës, i cili përbëhej nga 3 anëtarë, një anëtar nga Kabineti i Kryeministrit, një anëtar nga Kabineti i Zëvendëskryeministrit dhe një anëtar nga aparati i Këshillit të Ministrave.

Gjithashtu, monitorimi është kryer edhe duke iu referuar rasteve sporadike të referuara nga qytetarë, subjekte zgjedhorë, punonjës të administratës, etj. apo edhe kryesisht referuar një fenomeni të caktuar për të cilin është marrë dijeni gjatë fushatës zgjedhore nga media, OJQ, subjektet elektorale, etj.

Task-Forca diskutonte informacionet e përcjella sekretariatit teknik dhe arrinte në vendimmarrje, përmes adresimit të çështjeve në organet kompetente, apo dhënies së rekomandimeve, të cilat i drejtoheshin institucioneve shtetërore për marrjen e masave dhe me qëllim vendosjen standardit në trajtimin e rasteve të monitoruara me qëllim që të sigurohej barazia mes subjekteve zgjedhorë.

Secila nga Ministritë është ftuar të sjellë Raportin përfundimtar të monitorimit, vfarë përfshin dhe monitorimin e kryer dhe në institucionet e varësisë, entet publike dhe shoqëritë që kanë në kontroll.

## **V. PROBLEMATIKA TË LIDHURA ME BASHKËRENDIMIN E PUNËVE GJATË PROCESIT TË MONITORIMIT NË MINISTRI DHE INSTITUCIONE**

Gjejmë me vend të theksohet se fryma e marrëveshjes politike në nivel të lartë është përcjellë me mosbesim të theksuar në nivele më të ulëta, konkretisht në rang zëvendësministrash dhe nëpunësish civilë të nivelit të lartë e të mesëm duke krijuar situata artificiale konfliktesh dhe mosbashkëpunimi duke penguar kështu drejtpërdrejt arritjen e qëllimit të marrëveshjes politike.

Fryma e mosbesimit u konkretizua me moszbatim të urdhrave të Ministrit, vonesa në zbatimin e tyre duke bërë që urdhri të humbte aktualitetin, mospërcjellje informacioni tek ministrat, refuzimin për të dërguar korrespondencën e ministrave, presion i drejtpërdrejtë mbi nëpunësit civilë të nivele më të ulëta për të mos iu bindur urdhrave të Ministrit pasi autoriteti i vetëm të cilit duhej t'i bindeshin ishte Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë përkatëse.

Në shumicën e ministrive ku u emëruan ministrat e propozuar nga opozita një nga shkaqet e vështirësisë për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit rezulton të ketë qenë marrëdhënia e tendosur dhe konfliktuale midis ministrave si funksionarë politikë dhe nëpunësve më të lartë civilë në ministrinë përkatëse. Ky konflikt bëri që informacioni i kërkuar në kuadër të VKM 473/2017 të mos dërgohej e të mos përpunohej, për t'ju përcjellë më pas Task-Forcës.

Ky shqetësim është përcjellë përmes shkresave të MF<sup>2</sup>, MD<sup>3</sup> dhe MAS<sup>4</sup>, ku ka rezultuar se Ministrat përkatës janë penguar nga ana e personave të caktuar në administratë publike apo në nivel zëvendësministri në ushtrimin e funksioneve të tyre në përgjithësi dhe në veçanti në ushtrimin e funksionit të monitorimit sipas objektit të përcaktuar në VKM 473/2017.

Kryetarja e Task-Forcës e ka ngritur këtë shqetësim në mbledhjen e datës 16 Qershor 2017, ku ka rezultuar se pavarësisht kohës së vënë në dispozicion informacioni nuk ka ardhur fare, ka ardhur pjesërisht, i paplotë, i papërpunuar apo raste kur institucionet e varësisë nuk kanë raportuar fare në Ministri.<sup>5</sup>

---

<sup>2</sup> Shkresë nr. 7975, dt.1.06.2017, ku MF i drejtohet Kryeministrit: '... konstatohet se drejtues të MF dhe titullarët e institucioneve të tjera të varësisë po pengojnë në mënyrë të hapur dhe të papërgjegjshme ushtrimin e detyrës tonë dhe misionit tonë të përbashkët, për garantimin e zgjedhjeve të lira por edhe në mbarëvajtjen e punës së përditshme të MF-së'

<sup>3</sup> Shkresë dt. 31.05.2017 e MD, i cili i drejtohet Kryeministrit: '2. SP urdhëron verbalisht punonjësit që të mos shkojnë në inspektim/kontroll, duke i kërcënuar me fillimin e ecurisë disiplinore, si dhe nuk nënshkruan autorizimet për lëvizjen e automjeteve të institucionit që shoqërojnë grupet e inspektimit.3. SP i ka kërkuar të gjithë nëpunësve të nivelit të lartë drejtues, që të mos zbatojnë urdhrat apo porositë e MD , si dhe të mos përmbushin detyrat e caktuara..'

<sup>4</sup> Shkresë dt. 25.05.2017; 01.06.2017; 07.06.2017 drejtuar Kryeministrit.

<sup>5</sup> Shih Proces-Verbal dt. 16.06.2017, faqe 17.

Ministri i Financave dhe ai i Arsimit kanë bërë të ditur gjatë kësaj mbledhje pengesat me të cilat janë ballafaquar që i kanë penguar në përcjelljen e informacionit.<sup>6</sup> Kjo marrëdhënie ka vazhduar gjatë gjithë kohës çka është evidentuar dhe në raportet e monitorimit të përcjella nga Ministrat.

(i) **Ministri i Drejtësisë** në ushtrim të funksionit të monitorimit sipas Urdhrit 65/2017 të Kryeministrit ka kërkuar hapjen e një portali në faqe zyrtare të ministrisë nga Drejtoria e IT, me qëllim denoncimin e rasteve të administratës në zgjedhje dhe ka rezultuar se SP Znj. Juliana Hoxha ka urdhëruar heqjen e portalit. Gjithashtu, Ministri i Drejtësisë ka raportuar se SP ka urdhëruar grupet e inspektimit të mos shkojnë në kontrolle për monitorimin e sjelljes së administratës gjatë fushatës elektorale, u ka kërkuar të gjithë punonjësve të mos zbatojnë urdhrat e Ministrit, ka dërguar pranë zyrës së kodifikimit urdhrat e ministrit për interpretim dhe vlerësim. Ministri i Drejtësisë ka informuar përveç Kryeministrit edhe DAP në lidhje me sjelljet penguese dhe aspak bashkëpunuese të SP, duke kërkuar dhe marrjen e masave konkrete, gjë për të cilën nuk ka marrë asnjë përgjigje.<sup>7</sup>

Përveç të tjerash, Znj. Juliana Hoxha, megjithëse ishte kandidate për deputete në listat e subjektit zgjedhor Partia Socialiste vazhdonte detyrën duke mos u pezulluar nga detyra sipas nenit 37(3), të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”. DAP është njoftuar për një situatë të tillë menjëherë sapo ministri Bardhi ka marrë detyrën dhe me shkresën nr. 3624/1, datë 31.05.2017 e ka konstatuar të bazuar kërkesën e tij duke qenë se ndodhemi përpara shkaqeve të pezullimit të anëtarit të TND për shkak të ligjit. Në vijim Ministri referuar nenit 17 të VKM 473/2017, ka marrë masa të menjëhershme për pezullimin e Znj. Hoxha nga pozicioni i SP.<sup>8</sup>

(ii) **Ministri i Arsimit dhe Sporteve.** Pengimi i Ministrit për të përmbushur detyrat si anëtar i Task-Forcës, referuar të gjitha veprimeve të Sekretarit të Përgjithshëm (SP) dhe disa nëpunësve civilë të nivelit të lartë në MAS, të çon në përfundimin që kjo sjellje ka qenë e mirëorganizuar dhe e qëllimshme. Konkretisht, SP i kësaj ministrie ka përdorur një sjellje jo etike ndaj Ministrit që në ditën e parë të saj të detyrës. Si një nga shembujt më të dukshëm të mungesës së etikës në komunikim përmendim korrigjimet me shkrim dore që SP iu bënte shkresave të ministrit, e cila është jashtë detyrave funksionale të këtij nëpunësi civil. Për më

---

<sup>6</sup> Po aty, H. Vukaj ‘Si i bëhet në kushtet kur jo vetëm që ky informacion nuk vjen, nuk vjen i plote, kamuflohet ose gjenden arsye të paarsyeshme, të cilat nuk përligjin dhe nuk do të arrijnë qëllimin?’ faqe 7; L. Mandija ‘.. MAS ku përsëri ka dështuar dhe nuk ka ushtruar autoritetin për të më sjellë informacionin në kohë reale dhe jo vetëm për aparatit e ministrisë, por edhe për të gjithë institucionet e varësisë’, faqe 19.

<sup>7</sup> Raporti i Ministrit të Drejtësisë “ Për monitorimin e administratës shtetërore në varësi të Ministrisë së Drejtësisë gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2017” dt.10 Korrik 2017 (ANEKSI I), faqe 7-8.

<sup>8</sup> Po aty, faqe 29.

tepër, mbështetur në arsye të paqena SP refuzon të vërë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme për stafin e Ministrit duke penguar drejtpërdrejt këtë të fundit të përmbushë detyrat, duke e penguar deri në adresë zyrtare e-maili deri në datë 03.06.2017. Z. Ndreca ka ushtruar presion mbi stafin e Ministrisë nëse do të mbanin komunikim me ministrin dhe kabinetin e saj, ka penguar drejtoritë të zbatojnë urdhrat e Ministrit dhe ka penguar procesin e monitorimit të sjelljes së administratës referuar Urdhrit 65/2017 apo më tej të VKM 473/2017. Përveç të tjerash, Z. Ndreca është kallëzuar nga Ministri Arsimit për ndërhyrje në procesin e maturës shtetërore në Fushë-Krujë, ku ai ka hyrë në ambientet e shkollës “Shote Galica”, i paautorizuar, me qëllimin favorizimin e të rinjve që votonin për herë të parë, në mbështetje të Partisë Socialiste.<sup>9</sup>

Më tej konfiktualiteti i marrëdhënies shkon deri aty sa SP ndikon tek punonjësit civilë të niveleve më të ulëta të cilët fakti ka qenë që nuk kanë vepruar për përmbushjen e detyrave sipas kërkesave me shkrim të ministrit. Përmendim rastin e Z. Alqi Kushi, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse apo zyrës së protokollit në këtë ministri që refuzonte pa shkak apo duke gjetur justifikime të ndryshme të protokollonte dhe vuloste shkresat e Ministrit duke penguar drejtpërdrejt dërgimin e korrespondencës nga ky i fundit. Si përfundim, Ministri u gjend para faktit që duhej të krijonte një regjistër protokollit ekstra. Z. Kushi përmes veprimeve të tij ka penguar Ministrin në emërimin e anëtarëve të kabinetit të saj.<sup>10</sup>

Edhe Znj. O. Koleka në funksionin e Drejtorit të IT ka shpërfillur urdhrat e Ministrit dhe ka penguar përmbushjen e detyrave në drejtim të monitorimit të sjelljes së administratës shtetërore dhe përdorimit të fondeve publike apo të autoritetit shtetëror në mbështetje të subjekteve të caktuara elektorale. Gjithashtu, Znj. Koleka sipas urdhrit të Z. Ndreca ka refuzuar të publikojë në faqen zyrtare të MAS deklaratat për shtyp të Ministrit.<sup>11</sup>

Raste si këto më sipër ka pasur edhe në nivele më të ulëta nëpunësish civilë. Për shembull, përmendim rastin e MAS ku një drejtoreshë e një drejtorie rajonale arsimore refuzonte të zbatonte urdhrat e ministrit për zhvillimin e një takimi lidhur me vënien në zbatim dhe përmbushjen e detyrave sipas VKM 473/2017 me arsyetimin se eprori i saj ishte SP i MAS. Situata të ngjashme ka pasur edhe në drejtori arsimore të tjera edhe këto të orientuara nga vetë Z. Ndreca.<sup>12</sup>

---

<sup>9</sup> Raporti i Ministrit të Arsimit dhe Sporteve , (ANEKSI II ), faqe 17, 18, 29.

<sup>10</sup> Po aty, faqe 22.

<sup>11</sup> Po aty faqe 23, 27.

<sup>12</sup> Po aty, faqe 5.

Rasti më i fundit ishte hyrja me forcë në ambientet e ministrisë i SP, shoqëruar nga Znj. Koleka dhe Drejtori i Përgjithshëm të Shërbimeve Mbështetëse, shoqëruar nga policia private dhe madje edhe nga policia e shtetit.<sup>13</sup>

**(iii) Ministri i Mirëqenies Sociale** në raportimet periodike dhe në raportin përfundimtar, ka adresuar shkeljet, pengesat ligjore të krijuara nga SP e MMSR, e cila ka pasur sjellje pothuaj identike me ato të SP të MAS. Ka ushtruar presion të drejtpërdrejtë tek punonjësit civilë të niveleve më të ulëta për të refuzuar autoritetin e ministrit, ka fshehur në mënyrë abuzive shkresa hyrëse drejtuar Ministrit, ka penguar funksionimin dhe vënien në zbatim të akteve të tjera nënligjore në funksion dhe në zbatim të VKM nr. 473 datë 01.06.2017, ka refuzuar të firmosë çdo shkresë si dhe shkresat drejtuar Kryeministrit, ka refuzuar të firmosë urdhrat për emërimet e këshilltarëve të Ministrit, ka ushtruar presion dhe kontroll verbal tek zyra e financës duke penguar të gjitha pagesat për të përndjekurit politikë, të cilat janë detyrim ligjor dhe duke lejuar pagesa selektive, madje ka arritur deri në ekstreme duke bërë presion mbi njësitë e prokurimeve, të cilat më pas janë ankuar vetë tek stafi i ministrit, etj.<sup>14</sup>

Asistentja e ish ministrit znj. Olta Xhacka dhe asistentja e SP të MMSR kanë penguar Ministrin e MMRS ushtrorë funksionet e saj dhe vecanërisht në drejtim të procesit të monitorimit referuar VKM 473/2017. Sipas informacionit të përcjellë nga Ministri, ato kanë ushtruar presion mbi administratën dhe kanë bërë publike dokumente zyrtare me qëllim dëmtimin dhe pengimin e punës së Ministrit.

Gjithashtu, Artur Micko i komanduar Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit ka refuzuar të shqyrtojë në mënyrë objektive rastet e përfshirjes në fushatë të punonjësve të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe t'i shkarkonte nga detyra sipas propozimit të Ministrit. Ky qëndrim i tij ka qenë subjektiv për sa kohë Z. Micko ka mbajtur deri vonë pozicionin e kryetarit të FRESH dhe në këto rrethana, ai ka refuzuar të shkarkonte dy persona që bënin propagandë dhe ishin të përfshirë në fushatë për subjektin elektoral PS.<sup>15</sup>

Drejtori i ISSH nuk ka bashkëpunuar me Ministrin, në procesin e monitorimit të sjelljes së administratës shtetërore. Pavarësisht propozimeve të Ministrit që të merreshin masa administrative ndaj 22 punonjësve të ISSH pasi ishte provuar që ishin përfshirë në fushatë zgjedhore, është justifikuar me presionet që kishte marrë. Ministri nuk ka mundur të

---

<sup>13</sup> Po aty, faqe 20.

<sup>14</sup> Shih Raporti i MMSR, (ANEKSI III), faqe 12.

<sup>15</sup> Po aty, faqe 8-10.



ndërmarrë procedura për shkarkimin e drejtorit të ISSH, për sa kohë kjo ishte një vendimmarrje e Këshillit Mbikëqyrës dhe koha në dispozicion ishte shumë e shkurtër.<sup>16</sup>

(iv) *Ministri i Financave* është përballur me situata të ngjashme, ku administrata shtetërore ka refuzuar të jetë transparente në përcjelljen e dokumentacionit të kërkuar për sa i takon monitorimit të fondeve publike nga persona që janë në mbështetje të subjekteve zgjedhorë. Ministri ka denoncuar mospërcjelljen e qëllimtë të informacionit. Edhe institucionet e varësisë të MF kanë refuzuar të përcjellin informacionet e kërkuara nga MF duke u justifikuar se mungon qëllimi i kërkimit të informacionit.<sup>17</sup>

Ministri i Financave kërkoi dhe urdhëroi vënien në funksionim të numrit jeshil **0800 1963** (numër të cilin Ministria e ka pasur më parë në funksionim), me qëllim marrjen e denoncimeve për raste të përfshirjes së administratës së Ministrisë së Financave apo institucioneve të vartësisë në veprime të kundërligjshme. Ky urdhër nuk u zbatua për asnjë moment nga administrata e Ministrisë, për më tepër u be objekt refuzimi në mënyrë të vazhdueshme dhe të nxitur nga nivele të larta politike drejtuese në Ministri. Ky fakt prezumohet se ka shkaktuar pamundësi për të marrë informacion dhe për më tepër për të qenë në koherencë në veprime të kundërligjshme që cënonin standardet e zgjedhjeve të lira e të ndershme.

*Për personat përgjegjës u kërkua nga Ministri marrja e masave disiplinore. Masa disiplinore gjithashtu u kërkuan edhe për punonjës të tjerë të Ministrisë të cilët refuzuan zbatimin e urdhrat të Ministrisë për të qenë pjesë e grupit të punës për monitorimin e administratës shtetërore, si edhe përgjegjës për monitorimin e mospërdorimit të aseteve shtetërore (lëvizja e paautorizuar e automjeteve të ministrisë).*

---

<sup>16</sup> Po aty, faqe 14.

<sup>17</sup> Raporti i MF, (ANEKSI IV), faqe 13 Ministri i Financave ka urdhëruar marrjen e masave të menjëhershme dhe bashkërendimin e DPD dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese për hetim të thelluar për produktin e importuar kafe, për të cilin u analizua se DPD ishte në kushtet e një mungese prej afro 500 ton dhe kjo nënkuptonte kontrabandë në një periudhë shumë delikate siç ishte periudha zgjedhore. Ministri i Financave ngriti një grup pune për monitorimin e zbatimit të hetimit në doganë për çështjen e kafesë. Deri në hartimin e këtij raporti Ministrisë së Financave nuk i është vënë asnjë informacion në dispozicion për këtë rast, gjë e cila dëshmon mungesë totale bashkëpunimi ndërmjet strukturave përgjegjëse me Ministrinë e Financave.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka pasur disa komunikime shkresore sipas të cilave **nuk përcillet ky informacion tek Ministri i Financave pasi nuk është shprehur qëllimi i përdorimit të informacionit**<sup>17</sup>. Kjo konsiderohet e paprecedente në raport me hierarkinë dhe funksionimin ligjor të një institucioni, në këtë rast varësie.

**Pas mbledhjeve përkatëse të komisioneve të disiplinës, për asnjë nga rastet e sipërpërmendura nuk u mor masë disiplinore duke dalë me vendime pa masë, pavarësisht se sipas MF shkeljet ishin të provuara, argumentuara dhe dokumentuara.**<sup>18</sup>

Gjithashtu për administratën tatimore u konstatua neglizhencë dhe mangësi në përcjelljen e të dhënave të kërkuara në mënyrë të vazhdueshme. Bëhet fjale për të dhëna lehtësisht të gatshme nga ana e tyre për shkak se kanë të bëjnë me veprimtarinë e tyre ditore. Për rrjedhojë kjo vështirësoi edhe më shumë analizën e qartë të parametrave fiskalë dhe të të ardhurave po aq sa edhe mungesën e perceptimit në rastet kur subjekteve mund t'i bëheshin favore apo shtrëngime fiskale për qëllime subjektive. Për këtë arsye një nga detyrat e lëna nga Task-Forca ishte identifikimi i kryerjes ose jo të kontrolleve tatimore dhe rimbursimeve, me qëllime elektorale. Kjo detyrë nuk u përmbush pasi administrata tatimore nuk vuri në dispozicion në asnjë rast të dhënat për analizimin e tyre<sup>19</sup>.

(v) **Ministri Shëndetësisë.** Pavarësisht se nuk ka pasur dinamikë të përplasjeve në Ministrinë e Shëndetësisë, Ministri ka pranuar se ka munguar bashkëpunimi në kuadër të monitorimit referuar objektit të përcaktuar në VKM 473/2017, për sa i takon përdorimit të autoritetit shtetëror me qëllim dhënien e privilegjeve në rastet e dhënies koncesioneve apo përfitimeve të tjera për persona të caktuar që janë në mbështetje të subjekteve të caktuara zgjedhorë. Ministri i Shëndetësisë për shkak të vonesës në përgatitjen e udhëzimeve në zbatim të VKM nr. 473/2017 ka kërkuar nga SP dhe Komisioni i Disiplinës fillimin e procedimit disiplinor ndaj Drejtoreshës së Shërbimeve Mbështetëse Znj. Lindita Backa<sup>20</sup>.

Gjithë kjo mungesë bashkëpunimi mes ministrave të propozuar nga opozita si funksionarë politikë dhe nëpunësve civilë kryesisht me ata të nivelit të lartë drejtues, madje duke shkuar deri në konfliktualitet të hapur është për shkak të mënyrës së emërimit në detyrë të këtyre nëpunësve. Me keqardhje konstatohet se një pjesë e mirë e këtyre nëpunësve kanë fituar statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues jo mbi bazë konkurrimi për tu pranuar në shërbim civil, por duke u emëruar politikisht pa konkurs dhe duke u konfirmuar më pas në detyrë për shkak të efekteve të ligjit të ri për nëpunësin civil, nr. 152/2013. Rrjedhimisht, punonjës të tillë ndjehen më afër me partitë politike se sa me shërbimin civil që është i paanshëm politikisht.

<sup>18</sup> Po aty, faqe 14.

<sup>19</sup> Po aty, faqe 15.

<sup>20</sup> Raporti i MSH (ANEKSI V), faqe 1-3.

Punonjës të tillë për shkak të ligjit të ri nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i cili në dispozitën kalimtare në nenin 67 parashikon se punonjësit ekzistues (*pra ata që ligji në fjalë i gjen në detyrë, por që janë të emëruar dhe jo të përzgjedhur me konkurs sipas rregullave të shërbimit civil*) janë konfirmuar automatikisht në detyrat më të larta të këtij shërbimi nëse kishin të paktën 1 vit punë kur ky status konfirmohej nga Departamenti i Administratës Publike apo janë konfirmuar pas kalimit të periudhës së provës nëse kishin më pak se 1 vit punë. Pra në çdo rast nuk i janë nënshtruar konkurrencimit për praninë në këtë shërbim. Rezultoni që emërimet e tilla në këto nivele të larta janë thellësisht politike dhe vënë në dyshim paanësinë e tyre politike. Kjo frymë politizimi më pas është përçarë në punonjësit e shërbimit civil të nivele më të ulëta.

Mënyra e njëjtë e veprimit nga SP të ministrave ku u emëruan ministrat e propozuar nga opozita dëshmon se veprimet e tyre janë thellësisht politike dhe të koordinuara me qëllim për të penguar arritjen e qëllimit të VKM 473/2017 për shmangien e përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike në funksion të fushatës zgjedhore apo për largimin e vëmendjes nga qëllimi parësor që ishte monitorimi.

Është fakt i pakontestueshëm që situata të tilla nuk rezultojnë të kenë ndodhur për sa kohë kanë qenë në detyrë ministrat e shumicës. Me ardhjen e ministrave të propozuar nga opozita sipas marrëveshjes politike qëndrimi i nëpunësve civilë të lartë të nivelit drejtues ka ndryshuar katërcipërisht. Pra, ata vetëm nëpunës civilë të pavarur dhe të paanshëm politikisht nuk mund të mendohet se janë.

Nuk është rastësore që rezistenca më e madhe nga ana e nëpunësve civilë është hasur pikërisht në ministratë me institucione varësie më të shumta, të cilët kanë një staf shumë të madh dhe të shtrirë në territor si Ministria e Financave, që mbulon doganat dhe tatimet, MMSR që mbulon shumë drejtori me shtrirje të gjerë në territor, MAS që ka drejtoritë arsimore dhe zyrat e arsimit në territor.

Një nga shembujt më tipikë të një SP politik është ai i Genci Gjonçaj, SP i Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili është fakt i njohur dhe që mund të verifikohet lehtësisht se ka qenë në kohën e emërimit përfaqësues i subjektit politik Partia Socialiste.<sup>21</sup>

---

<sup>21</sup> Intervistë e Z. Gjonçaj si përfaqësues i Partisë Socialiste në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve data 4 Shkurt 2015. Z. Gjonçaj në mbledhjen e KQZ-së në datën 4 Maj 2015 si përfaqësues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve <https://www.youtube.com/watch?v=1hDQMZJjR08>  
<http://shqiptarja.com/video/index.php?IDVideo=33528>  
<https://www.youtube.com/watch?v=k6-4b3rFKgM>

Pa konflikt nuk ka shpëtuar as niveli politik, mes funksionarëve politikë të nivele të ndryshme të partive të ndryshme politike. Përmendim këtu rastin e Ministrit të Financave dhe Zëvendësministrit të Financave, Znj. Irena Beqiraj.<sup>22</sup> Kjo e fundit, nën justifikimin se mbronte nëpunësit civilë në Ministrinë e Financave (*çka nuk është tagër e saj pasi nuk është pjesë e shërbimit civil*) ka vepruar në shkelje të autoritetit të ministrit si titullari më i lartë në institucion duke cënuar hierarkinë administrative si dhe është sjellë në mënyrë tërësisht jo etike kundrejt ministrit në fjalë dhe madje edhe Zëvendëskryeministrit duke bërë edhe deklarata publike në media dhe rrjete sociale aspak serioze dhe të denja për një funksionar të lartë të administratës. Për këtë i është kërkuar Kryeministrit ta propozojë për shkarkim në Këshillin e Ministrave, kërkesë e cila ka mbetur pa veprim.<sup>23</sup>

Fryma e mosbesimit dhe mungesa totale e bashkëpunimit u reflektua edhe në nivel vendor, nga Bashkia e Tiranës, si bashkia më e madhe në vend, e cila administron një buxhet publik domethënës.

Kjo bashki nuk dërgoi informacion për Task-Forcën duke vepruar në mungesë të plotë transparence, megjithë mendimin e Komisionerit<sup>24</sup> për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil që të paktën për disa aspekte të kihej parasysh transparenca. Për më tepër, që në zbatim të pikës 2, paragrafi 2 dhe 4, të VKM 473/2017 Bashkia Tiranë, si çdo bashki tjetër që bashkëpunoi pa hezitim, kishte detyrim për të dhënë informacion.

## **VI. KOORDINIMI I TASK-FORCËS ME INSTITUCIONE TË PAVARURA DHE PROBLEMATIKA TË KONSTATUARA**

Task-Forca në përmbushjen e detyrave të saj bashkëpunoi edhe me institucione të pavarura të cilat ishin të ftuara në mbledhjet saj si PP, KQZ, KMSHC dhe Avokati i Popullit.

Me qëllim vendosjen e një marrëdhënie bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e pavarura nga ana e Zëvendëskryeministrit në cilësinë e Kryetares së Task-Forcës, ndërmori iniciativën për realizimin e një Memorandumi Mirëkuptimi katërpalësh midis KM, PP, KQZ dhe KMSHC nëpërmjet së cilës të përcaktoheshin detyra konkrete për palët për bashkërendimin e veprimtarisë së tyre me qëllim mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

<sup>22</sup> Raporti i MF (ANEKSI IV), faqe 14.

<sup>23</sup> Shkresa e Zëvendëskryeministrit drejtuar Kryeministrit nr. 3563, datë 23.06.2017, ku i propozon shkarkimin e Znj. Beqiraj, pasi ka paraqitur shkaqet dhe provat bashkëngjitur.

<sup>24</sup> Të shihet deklarimi i Komisionerit në proces-verbalin e mbledhjes së datës 16.06.2017 të Task-Forcës.

Kjo marrëveshje nuk u arrit të nënshkruhej pavarësisht shprehjes së vullnetit nga të gjitha palët e saj për shkak të kohës së shkurtër dhe angazhimeve të vazhdueshme të Prokurorit të Përgjithshëm.

#### **(i) Bashkëpunimi me Prokurorinë e Përgjithshme**

Neni 23 i VKM 473/2017 përcakton se në Mbledhjet e Task-Forcës ftohet të marrë pjesë dhe një përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme. Në këtë kuadër, Prokuroria e Përgjithshme është ftuar të përcaktojë përfaqësuesin e saj në Task-Forcë, por në asnjë rast nuk ka njoftuar për një të tillë në Task-Forcë. Prokurorisë së Përgjithshme përveç kërkesave me shkrim<sup>25</sup> gjithashtu iu bë thirrje në çdo mbledhje të Task-Forcës për të marrë pjesë në to, por asnjë përfaqësues i saj nuk mori pjesë në asnjë nga mbledhjet. Prokuroria e Përgjithshme nuk ka njoftuar ndonjë arsye specifike për mos marrjen pjesë në mbledhjet e Task-Forcës. Rezulton se në Task-Forca të tjera të ngritura me VKM merr pjesë përmes një përfaqësuesi.

Ndërkohë, organit të Prokurorisë i janë referuar të gjithë rastet e konstatuara gjatë procesit të monitorimit për të cilat ka dyshime të arsyeshme të ekzistencës së elementëve të veprës penale dhe për disa nga çështjet jemi vënë në dijeni në lidhje me regjistrimet e çështjeve penale. Gjithashtu, mbi bazën e kërkesave zyrtare kemi marrë informacion për çështje të caktuara të diskutuara në mbledhjet e Task-Forcës.

#### **(ii) Bashkëpunimi me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve**

KQZ ka qenë e gatshme në nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërinstitucional, duke shprehur paraprakisht dhe dakordësinë për draftin që iu vu në dispozicion nga ana e Kryetarit të Task-Forcës.

KQZ ka qenë e ftuar të marrë pjesë në Task-Forcë dhe ka njoftuar përfaqësuesin që ka qenë Kryetari i KQZ, Z. Zguri. Por, pavarësisht njoftimeve përmes adresës zyrtare të e-mail, Z. Zguri nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e Task-Forcës. Nuk rezulton që KQZ të ketë njoftuar arsye specifike të mos marrjes pjesë në mbledhjet e Task-Forcës nga ana e përfaqësuesit të tij.

KQZ dhe kryetari Zguri kanë qenë mjaft bashkëpunues gjatë procesit të monitorimit të realizuar nga Task-Forca, duke dhënë informacionet e kërkuara përmes shkresave zyrtare.

<sup>25</sup> Shkresë nr. 3296 prot., datë 07.06.2017, shkresë nr. 3546 prot., datë 21.06.2017.

**(a) Informacion lidhur me financimin e partive politike**

KQZ iu kërkua informacion mbi financimet për partitë politike.<sup>26</sup> KQZ është përgjegjës<sup>27</sup> që raporti përfundimtar lidhur me financimet referuar nenit 24/4 të Ligjit 90/2017 paraqitet në KQZ jo më vonë se 4 muaj nga shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Në këto kushte, ky raport nuk është ende gati. Ndërkohë KQZ ka njoftuar se dy raporte të ndërmjetme janë depozituar nga ana e ekspertëve financiarë në periudhën nga data e emërimit të tyre deri në datën e zgjedhjeve, për rezultatin e monitorimit të fushatës zgjedhore për të gjitha subjektet zgjedhore, si dhe raporte monitorimi specifike, në rastet e kërkuara nga KQZ.<sup>28</sup>

**(b) Adresimi i rasteve të përdorimit të materialeve të propagandës**

Task-Forca ka trajtuar dhe ankesa apo kërkesa të ndryshme gjatë periudhës zgjedhore për shkelje të dispozitave të Udhëzimit Nr. 1, datë 31.05.2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Për këtë arsye, iu është kërkuar të gjithë Kryetarëve të Bashkive që të dërgojnë pranë zyrës së Zëvendëskryeministrit informacion mbi masat e marra për zbatimin e udhëzimit të KQZ-së, për materialet propagandistike.

---

<sup>26</sup> Shkresë nr. 3311 prot., datë 08.06.2017 dhe shkresë nr. 3642 prot., datë 30.06.2017 e Zv/ Kryeministrit drejtuar KQZ-së.

<sup>27</sup> Shkresë nr. 4704/1 prot., datë 12.07.2017 e KQZ drejtuar Zv/Kryeministrit.

<sup>28</sup> Referuar këtyre raporteve të ndërmjetme rezultojnë se: (i) Monitorimi ndaj subjektit elektoral PDIU për periudhën 17.06.2017-23.06.2017, gjatë fushatës zgjedhore në Bashkinë Dibër ka shkelur dispozitat ligjore duke ngritur më shumë se një zyrë elektorale për lagje si dhe ka vendosur material propagandistike statike në distancë më shumë se 5m larg zyrave elektrorale; (ii) Monitorimi ndaj LSI për datë 13.06.2017, gjatë fushatës elektorale ka shkelur dispozitat ligjore duke vendosur banderola në distancë më të madhe se 5m pranë zyrës elektorale në qendër të Durrësit, pranë zyrës në Spitalë, në lagjen 15 në Durrës, lagjen 18 në Durrës, në 4 rrugët e Shijakut në distancë më të madhe se 25m etj; (iii) Monitorimi ndaj LSI për datë 23.06.2017 gjatë fushatës elektorale ka shkelur dispozitat ligjore duke ngritur zyra elektorale më tepër si psh: në NJA nr.1 Tiranë ka ngritur 8 zyra elektorale ndërkohë që duhet të kishte vetëm 4 zyra elektorale; në Bashkinë Bulqizë ka ngritur 4 zyra ndërkohë që duhet të kishte vetëm 2 zyra elektorale; në Rrogozhinë ka ngritur 2 zyra elektorale në afërsi 100m; në Paskuqan ka ngritur 2 zyra elektorale në afërsi 800m; në Bashkinë Berat ka ngritur 6 zyra elektorale ndërkohë që duhet të kishte vetëm 3 zyra elektorale në 3 lagje të qytetit; në Kuçovë dhe Berat ka vendosur postera në distancë më të madhe se 5 m nga zyra elektorale.

Gjithashtu, nga ana e Task-Forcës iu është kërkuar Bashkisë Elbasan, Bashkisë Peqin, Bashkisë Librazhd, Bashkisë Përrenjas dhe Bashkisë Berat që të marrin masa konkrete për të zbatuar dispozitat e udhëzimit në fjalë të KQZ-së pasi subjekte të caktuara politike kishin paraqitur ankesa në lidhje me vendosjen e materialeve propagandistike në kundërshtim me përcaktimet ligjore nga subjekte të ndryshme.

Në përgjithësi, këto bashki kanë marrë masat e nevojshme për heqjen e këtyre materialeve propagandistike, ndonëse me vonesë.

KQZ-së i është kërkuar informacion për rastet kur është konstatuar që nuk është zbatuar nga subjektet politike Udhëzimi nr. 1, datë 31.05.2017 *“Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”* nxjerrë nga ky institucion.

Ky udhëzim përcakton rregullat që duhet të respektohen për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet politikë. Më të njëjtën shkresë si më sipër, KQZ shprehet se nga përfaqësuesi i Partisë Demokratike janë paraqitur 3 raste afishimesh nga Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet të materialeve propagandistike në kundërshtim me këtë udhëzim në Bashkitë Peqin, Dibër dhe Cërrik dhe nga Lëvizja Socialiste për Integrim në Bashkitë Durrës dhe Përrenjas.

Nga verifikimet e kryera raportohet se është konstatuar shkelje e udhëzimit më sipër duke mos respektuar distancën për afishime jo më shumë se 5 metra nga zyra elektorale për subjektin Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet në Dibër dhe Lëvizja Socialiste për Integrim në Durrës. Nuk ka informacion për bashkitë e tjera të referuara.

Raportohet gjithashtu se kryetarët e Bashkive Dibër dhe Durrës u urdhëruan të marrin masat për heqjen e materialeve propagandistike të afishuara në kundërshtim me udhëzimin më sipër, por KQZ në shkresën e saj nuk sqarohen nëse këto vendime u zbatuan.

Një rast i veçantë lidhur me zbatimin e Udhëzimi nr. 1, datë 31.05.2017 *“Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”* është ai në territorin e Bashkisë Berat, ku në tokë apo mure ishin bërë vizatime të cilat nuk kanë të shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë lidhjen me një subjekt politik, por që një person i tretë fare lehtësisht mund të lexonte mesazhin e nënkuptuar për të votuar për një subjekt të caktuar politik. Konkretisht nga fotot dërguar KQZ bashkëlidhur për rastin në fjalë shihej vizatimi i një zemre dhe numrit 2 që pavarësisht se në pamje të parë nuk bënte lidhjen me një subjekt

politik të caktuar, nënkuptonte qartë që është thirrje për të votuar subjektin politik “Partia Socialiste” në kushtet kur në vizatim përdoret ngjyra “lejla” që identifikon këtë subjekt dhe numri 2 që është numri i këtij subjekti në listën zgjedhore.

Për sa më sipër, zyra e Zëvendëskryeministrit i kërkoi KQZ<sup>29</sup> mbajtjen e një qëndrimi të unifikuar për trajtimin e rasteve të tilla në kuptim të nenit 79 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 2, pika 4, të Udhëzimit Nr. 1, datë 31.05.2017 të KQZ-së.

KQZ përgjigjet<sup>30</sup> se “me aq sa shihet nga fotot nuk rezulton se vizatimet të klasifikohen si materiale propagandistike”. Por pavarësisht këtij qëndrimi, KQZ e përcjell rastin pranë Bashkisë Berat për vlerësim, në mënyrë që organet ligjzbatuese në varësi të saj të marrin masat për zbatimin e tij. Pra, KQZ nuk mban një qëndrim të unifikuar që të zbatohet njësoj për raste të ngjashme që mund të paraqiten në të ardhmen.

### **(iii) Bashkëpunimi me Komisionerin e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil**

Ndërveprimi me KMSHC ishte përmes shkresave dhe pjesëmarrjes së vetë Komisionerit në mbledhjet e Task-Forcës si e ftuar.

Komisioneri ka krijuar nga ana e tij mekanizmin e monitorimit të sjelljes së nëpunësve civilë në kushtet e zgjedhjeve politike për Kuvendin e Shqipërisë, të cilin ia ka njoftuar Task-Forcës duke bërë të ditur së fundi dhe Raportin Përfundimtar për periudhën e monitorimit 05.05.2017-30.06.2017.

Gjithashtu, Task-Forca është dakordësuar me interpretimin e bërë nga Komisioneri në lidhje me nenin 37, të ligjit “Për nëpunësin civil”.

Duke marrë shkas, nga procesi i monitorimit që kishte ndërmarrë Komisioneri, Task-Forca ka kërkuar informacion dhe raportim në mbledhjet e saj në lidhje me rastet e shkeljeve të konstatuara nga nëpunësit civil gjatë periudhës zgjedhore si dhe masat e marra për rastet kur është shkelur parimi i paanësisë politike, përdorimit të burimeve financiare dhe çdo shkelje tjetër.<sup>31</sup>

<sup>29</sup> Shkresa nr. 3381 prot., datë 12.06.2017 e Zv/Kryeministrit drejtuar KQZ.

<sup>30</sup> Shkresa nr. 3381/1 prot., datë 16.06.2017 dhe nr. 3381/2 prot., datë 16.06.2017 të KQZ drejtuar Zv/Kryeministrit.

<sup>31</sup> Shkresa nr. 3315 prot., datë 08.06.2017 e Zv/Kryeministrit drejtuar KMSHC.



Task Forca ka vlerësuar informacionin e përcjellë nga Komisioneri<sup>32</sup>, i cili raporton “*se u është kërkuar institucioneve të administratës të dërgojnë informacion për rastet e pezullimeve për shkak të kandidimit të nëpunësve civilë si deputetë si dhe për rastet e kërkesave për shërbyer si komisionerë. ... ka filluar të mbahet e plotësohet regjistri i prezencës së punonjësve dhe sa herë nuk janë prezent në institucion duhet të tregohet arsyeja e mungesës. Kjo me qëllim që nëpunësit civilë të mos merrnin pjesë në fushatë zgjedhore.*”

Me shkresën nr. 3467 prot., datë 16.06.2017 Komisioneri u ftua të dërgonte informacion të përditësuar për konstatimet e tij në kuadër të përmbushjes së funksionit të vet dhe për raste masash disiplinore që mund të jenë marrë kundrejt nëpunësve civilë për shkelje në fushën e zgjedhjeve.

Gjithashtu, me shkresën nr. 3501 prot., datë 19.06.2017, zyra e Zëvendëskryeministrit referon pranë Komisionerit për të kryer hetim administrativ të thelluar për problematikën SP të MAS, i cili me veprimet e tij dhe sjelljen jo etike që duhet të ketë një nëpunës civil po bëhej pengesë e vazhdueshme për vënien në zbatim të VKM 473/2017. Komisioneri me shkresën nr. 1120/31prot., datë 20.06.2017 shprehet se ka filluar ndjekjen e rastit dhe ka kërkuar dërgimin e provave. Gjithsesi, ky rast përfundimisht është zgjidhur me vendimin nr. 142, datë 30.06.2017 të Komisionerit dhe referohet edhe në raportin përfundimtar të KMSHC. Ministri i Arsimit përmes shkresës nr. 6595/1, datë 5.07.2017 ka shprehur rezerva në lidhje me procedurat e ndjekura nga ana e KMSHC si dhe interpretimet bëra nga ana e tij referuar ligjit. Këto rezerva Ministri i Arsimit ia ka përcjellur përmes shkresës nr. 6425/2 prot, datë 10.07.2017 Kryetarit të Task Forcës dhe Avokatit të Popullit.

Në Raportin përfundimtar të monitorimit të sjelljes së nëpunësit civil në kushtet e zgjedhjeve politike për Kuvendin e Shqipërisë, Komisioneri ka arritur në konkluzionin se:

- 1. se prezenca në punë e nëpunësve civilë, ndryshe nga çdo fushatë e mëparshme zgjedhore, ka qenë në nivele të shkëlqyeshme dhe se numri i mungesave të pajustificuara është i papërfillshëm dhe në normalitetin e punës së përditshme në administratës. Kjo do të thotë që nuk ka raste pjesëmarrje të nëpunësve civilë në fushatë zgjedhore gjatë orarit zyrtar të punës.*

<sup>32</sup> Shkresë nr. 1107/1 prot., datë 09.06.2017 e KMSHC drejtuar Zv/Kryeministrit.

2. *lidhur me pjesëmarrjen e nëpunësve civilë në fushatë nuk ka pasur asnjë ankesë nga nëpunësit civilë që kanë paraqitur kërkesë për të shërbyer si komisionerë.*
3. *lidhur me administrimin e shërbimit civil Komisioneri evidenton disa raste kur titullarët e institucioneve kanë tejkaluar haptazi kompetencat ligjore kur kanë nxjerrë urdhra pezullimi nga shërbimi civil, konkretisht rasti i pezullimit të sekretares së përgjithshme të Ministrisë së Drejtësisë, J. Hoxha, Drejtoreshës së Drejtorisë Arsimore Rajonale Vlorë, A. Hodaj, sekretarit të përgjithshëm të MAS, P. Ndreca, Drejtoreshës së Drejtorisë së Teknologjisë, Informacionit dhe Komunikimit të MAS, specialistit të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, M. Zylfo dhe përgjegjësit të Sektorit të Arkiv-Protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, A. Selamaj. Sipas Komisionerit urdhrat e pezullimit të këtyre punonjësve janë absolutisht të pavlefshme pasi masat disiplinore e pezullimit merret vetëm nga organet përkatëse të shërbimit civil dhe jo nga ministrat që nuk janë nëpunës civilë, por funksionarë politikë.  
Për punonjësit e burgjeve më sipër raporton se u kthyen në punë pasi koordinatorja e grupit të monitorimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve pranoi se ishte vepruar në tejkalim të kompetencave.*
4. *lidhur me procedimin disiplinor të sekretarit të përgjithshëm të MAS raportohet se nuk është provuar asnjë shkelje dhe vendimmarrje e ngjashme është edhe për rastin e sekretares së përgjithshme të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Komisioneri nuk ka marrë raste denoncimesh për përdorim të aseteve të shtetit apo burimeve njerëzore.*

Duke vlerësuar kontributin e dhënë nga ana e Komisionerit dhe pjesëmarrjen aktive në mbledhjet e Task-Forcës, me keqardhje konstatohet se raporti i komisionerit nuk është i paanshëm siç duhej të ishte duke qenë se është hartuar nga një institucion i pavarur. Komisioneri përkundrazi ka përkrahur çdo iniciativë të DAP dhe është nxituar të kryejë vendimmarrje të shpejta dhe pa hetim të thelluar administrativ apo në disa raste nuk ka ndërmarrë veprime fare. Konkretisht:

1. Saktësia e përmbushjes së detyrimit për verifikimin e prezencës në punë është e dyshimtë. Komisioneri në total raporton 270 mungesa të pajustificuara. Sipas raportimit<sup>33</sup> të Ministrisë së Financave janë evidentuar nga inspektime rastësore 44 mungesa të pajustificuara në ditë të ndryshme (pra njëditore) për punonjës të ndryshëm të cilat janë referuar pranë strukturave përgjegjëse për hetim administrativ dhe për të cilat deri në

<sup>33</sup> Raport përfundimtar i Ministrisë së Financave, faqe 12.

datën e raportit nuk ka informacion se në çfarë faze janë. MMSR ka evidentuar<sup>34</sup> 20 raste mungesash të pajustificuara përmes inspektimeve rastësore. Ministria e Drejtësisë raporton<sup>35</sup> mungesa të pajustificuara në IEVP Jordan Misja (313) dhe mosmbajtje të evidencave të hyrje-daljeve në institucion, në IEVP Fushë-Krujë dhe IEVP Mine Peza (302).

Këto raportime të paraqitura vetëm nga këto 3 ministri pas inspektimeve rastësore janë sa 1/3 e totalit të mungesave të pajustificuara të raportuara nga Komisioneri për ministrinë dhe rrjedhimisht lind dyshimi i arsyeshëm se mungesat e pajustificuara janë shumë të mëdha se sa raportohet.

***Për pasojë edhe saktësia e monitorimit vihet në dyshim nëse kemi parasysh të gjitha ministrinë. Mendojmë se numri i mungesave pa arsye është shumë më i lartë por nuk është raportuar i saktë nga të gjithë institucionet. Komisioneri vetë informacionin e ka mbi bazë vetëdeklarimi nga institucionet.***

2. Lidhur me pjesëmarrjen në fushatë Komisioneri raporton se nuk ka pasur asnjë denoncim. ***Ky është një raportim i përciptë dhe i pavërtetë.*** Raste të denoncuara përmes mediave janë të shumta dhe minimalisht Komisioneri mund të kishte filluar hetim administrativ kryesisht. Vetëm rastet e 3 ministrive më sipër janë raste të mjaftueshme të dyshuara që kanë merituar hetim të thelluar administrativ lidhur me shkakun e mungesave të pajustificuara dhe nëse këta punonjës kanë marrë pjesë në fushatë zgjedhore në ditët e mungesave.

3. Lidhur me tejkalimin e kompetencave nga ana e ministrave kur kanë pezulluar nëpunës civilë që janë bërë pengesë për vënien në zbatim të VKM 473/2017 apo për kandidim si deputetë theksojmë se interpretimi i Komisionerit është i gabuar dhe thellësisht i anshëm. Konkretisht:

a. Institucioni i Ministrit, si një pozicion politik, por edhe kushtetues, me vendimmarrjet në zbatim të detyrave të përcaktuara në VKM 473/2017 nuk është përfshirë në administrim të shërbimit civil.

b. Ligji nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, në nenin 5(1), parashikon se: “[...] Ministri është përgjegjës përpara Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit për tërësinë e veprimtarisë së ministrisë, institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome, më poshtë "sistem ministror",

---

<sup>34</sup> Raport përfundimtar i MMSR, faqe 3.

<sup>35</sup> Raport përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë, faqe 39-40.

*brenda fushës përkatëse të veprimtarisë shtetërore*”. Ndërkohë, neni 11(1), parashikon se: “*Ministria drejtohet nga ministri, i cili drejton politikën shtetërore për fushën që mbulon punën administrative dhe kontrolluese në institucion. [...]*”. Në këto kushte, Ministri është i detyruar të ndërhyjë për të rivendosur ligjshmërinë në funksionimin e strukturave të tij vartëse, përfshirë ligjshmërinë e veprimtarisë së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë, për shkak se veprimet e këtij të fundit në kundërshtim me ligjin, cenojnë tërësinë e veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë, e cila është përgjegjësi e Ministrit dhe për të cilën Ministri përgjigjet në Këshill të Ministrave.

c. Neni 6, i ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, parashikon se: “*Ministri, përveç kompetencave ose detyrave që parashikohen në Kushtetutë dhe në ligje të veçanta, ushtron edhe detyra të tjera, që i ngarkohen nga Këshilli i Ministrave ose nga Kryeministri.*” Në rastin konkret, VKM 473/2017 i ka ngarkuar ministrat me detyra të posaçme për parandalimin e përdorimit politik të administratës publike në funksion të fushatës zgjedhore si dhe përdorimin e burimeve të tjera materiale dhe financiare për përfitime të kësaj fushate. Pra, është detyrë e posaçme e Ministrit të Drejtësisë të garantojë brenda sferës së përgjegjësisë të ministrisë që drejton ligjshmërinë e veprimtarisë së administratës publike/nëpunësve civilë, veçanërisht në ato rate kur ka veprime të qëllimshme dhe të koordinuara në shumë ministri që pengojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë institucionin e ministrit të përmbushë detyrat e ngarkuara me vendim të Këshillit të Ministrave, për realizimin e të cilave ai përgjigjet pranë këtij të fundit.

d. Komisioneri, në bazë të ligjit nr. 152/2013, nuk është organ epror i Ministrit apo gjykatë, që të ketë tagrin të vlerësorë ligjshmërinë e urdhrave të Ministrit, por është përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil. Vlerësimi i ligjshmërisë së një akti administrativ, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, bëhet nga organi epror, ose gjykata. Komisioneri, nuk e ka të parashikuar në kompetencat që i ka dhënë ligji nr. 152/2013, të drejtën për të konstatuar pavlefshmërinë absolute të një akti të një organi kushtetues, siç është Ministri. Ky lloj vlerësimi dhe konstatimi i pavlefshmërisë absolute, sipas nenit 110 të Kodit të Procedurave Administrative, bëhet në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, të çdo të interesuari, nga: (i) organi publik që e ka nxjerrë atë, (ii) organi epror i tij apo organi që është kompetent të shqyrtojë mjetet ligjore administrative, si dhe (iii) nga gjykata kompetente për çështjet administrative, sipas ligjit. Për këtë arsye, interpretimet dhe vlerësimet e pasakta të Komisionerit mbi urdhrin e ministrit janë në tejkalim të kompetencave të tij ligjore, duke marrë rolin e organit epror të Ministrit, apo duke u sjellë e vepruar si gjykatë.

4. Lidhur me rastin e dy SP përmendur më sipër sqarojmë se vendimmarrja e Komisionerit çuditërisht ka qenë shumë e shpejtë dhe e dyzuar. Nga njëra anë kërkonte shkresa dhe informacion nga ministrat lidhur me vendimmarrjet e tyre për pezullimin e sekretarëve të përgjithshëm dhe nga ana tjetër ka nxituar të dalë me vendim pa u administruar ende dhe pa u shqyrtuar dokumentacioni që kërkonte.

Për shembull, në rastin e SP të Ministrisë së Drejtësisë Komisioneri me shkresën nr. 1021/4 prot., datë 07.06.2017, kërkoi përcjelljen e dokumentacionit të plotë në lidhje me praktikën zyrtare që ka të bëjë me Znj. Juliana Hoxha, e pezulluar nga detyra si SP për shkak të regjistrimit si kandidate në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të viti 2017, duke i lënë afat Ministrit të Drejtësisë për përcjelljen e këtij informacioni datën 12.06.2017. Ministri i Drejtësisë, brenda afatit të caktuar, përcolli me shkresën nr. 3841/1 Prot., datë 12.06.2017 të gjitha informacionet që u kërkuan.

Mirëpo, rezulton se pa administruar gjithë praktikën e kërkuar, dhe pa respektuar afatin që Komisioneri vetë i kishit vendosur Ministrit të Drejtësisë (*data 12.06.2017*), Komisioneri kishte dalë me vendim në datën 09.06.2017, ku shprehej se e kishte përfunduar verifikimin e informacionit. Kjo sjellje ngre dyshimin serioz që vendimmarrja e Komisionerit ka qenë e ndikuar nga rrethana subjektive dhe të anshme që çënojnë procesin e rregullt ligjor. Hetimi administrativ, sipas Kodit të Procedurave Administrative, kërkon hetim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të çështjes, duke përfshirë edhe shqyrtimin e informacionit që Komisioneri vetë kishit kërkuar me shkresën nr. 1021/4 Prot., datë 07.06.2017, dhe që iu dërgua brenda afatit të kërkuar.

5. Padijenja e Komisionerit për raste të përdorimit të aseteve dhe burimeve njerëzore të administratës është e çuditshme sidomos në kushtet kur Komisioneri mund të veprojë edhe kryesisht. Rastet e denoncuara në mediat vizive si dhe nga Ministrinë, të cilat janë referuar edhe në këtë raport (pika F/III) janë të mjaftueshme për të vënë në dyshim paanësinë e Komisionerit.

***Ky i fundit duhet të garantojë një shërbim civil që funksionon sipas ligjeve dhe jo të nxitojë të arrijë përfundime me rezultate të shkëlqyera kur situata e faktit dëshmon ndryshe.***

## **VII. MBLEDHJET E TASK-FORCËS DHE MASAT E MARRA**

Procesi i monitorimit është koordinuar nga ana e Task-Forcës, e cila është konstatuar në mbledhjen e saj të parë në datë 5 Qershor 2017 ku është sqaruar qëllimi i saj në drejtim të monitorimit të veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017 referuar pikës 1 të VKM 473/2017.

Referuar nenit 23 të VKM 473/2017, Task-Forca (grup ndërinstitucional), kryesuar nga Zëvendëskryeministri ka në përbërje: (i) Ministrin e Punëve të Brendshme, (ii) Ministrin e Mbrojtjes, (iii) Ministrin e Arsimit dhe Sportit, (iv) Ministrin e Drejtësisë, (v) Ministrin e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, (vi) Ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore, (vii) SP të Këshillit të Ministrave, (viii) Drejtorin e Departamentit të Administratës Publike, (ix) Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe (x) Drejtorin e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave. Në mbledhjet e Task-Forcës janë ftuar të marrin pjesë: (i) Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (ii) Avokati i Popullit, (iii) një përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme dhe (iv) një përfaqësues nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Gjithashtu, janë ftuar të marrin pjesë përfaqësues nga organizma ndërkombëtarë, përfaqësi diplomatike, përfaqësues të OJQ-ve të cilët kanë si objekt të punës së tyre monitorimin e procesit zgjedhor.

Përmes procesit të monitorimit dhe koordinimit të procesit monitorues Task-Forca ka pasur qëllim dhënien e mendimeve dhe orientimeve për trajtimin në parim të rasteve të ndryshme sipas një procedure standarde. Ministrinë dhe organet e tyre të varësisë janë institucione kompetente, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë shtetërore të cilat duhet të ndjekin administrativisht dhe pa vonesa çdo denoncim nga qytetarë, subjekte elektorale apo punonjës të administratës shtetërore si dhe, sipas rastit të referojnë në prokurori rastet kur ka dyshime të arsyeshme për kryerjen e veprave penale që kanë lidhje me zgjedhjet. Rastet të cilat nuk kanë qenë brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrive apo institucioneve të tjera, apo që janë adresuar në to por nuk kanë marrë masat e duhura janë trajtuar nga ana e zyrës së Zëvendëskryeministrit në cilësinë e Kryetarit të Task-Forcës.

Task-Forca ka zhvilluar gjashtë mbledhje deri në datën e hartimit të këtij raporti, konkretisht në datat 05.06.2017, 16.06.2017, 20.06.2017, 21.06.2017, 23.06.2017 dhe 25.06.2017.

Në mbledhjet e Task-Forcës ka pasur pjesëmarrje të rregullt të Ministrave të propozuar nga opozita, Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Drejtorit të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave, SP të Këshillit të Ministrave, ndërkohë që ***në asnjë mbledhje nuk kanë marrë***

*pjesë Ministrat e tjerë, anëtarë të Task-Forcës.* Vetëm në mbledhjen e parë ka marrë pjesë Zëvendësministri i Mbrojtjes Z. Koci.

Është mirëpritur pjesëmarrja e rregullt pothuaj në çdo mbledhje e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe Avokatit të Popullit, ndërkohë që përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithshme dhe KQZ të ftuar, nuk kanë marrë pjesë në asnjë mbledhje të Task-Forcës.

Gjithashtu, është mirëpritur pjesëmarrja në mbledhjet e Task-Forcës e përfaqësuesve të organizmave ndërkombëtarë që monitorojnë procesin zgjedhor dhe sipas kërkesës së tyre të përfaqësive diplomatike dhe të OJF-ve të cilat kanë në fokus të tyre monitorimin e procesit zgjedhor.

Mbledhjet e Task-Forcës janë regjistruar dhe më pas zbardhur nga stafi teknik në Kryeministri.

#### **(i) Mbledhja e Parë e Task-Forcës (Datë 5 Qershor 2017)**

Në këtë mbledhje është konstituuar Task-Forca.

Me qëllim ushtrimin e funksionit monitorues dhe të koordinimit gjatë procesit zgjedhor, në këtë mbledhje është vendosur që të gjitha Ministrinë dhe Institucionet e tjera të përcjellin informacionin si më poshtë vijon deri në datë 9 Qershor 2017:

1. nxjerrja sa më shpejt e akteve nënligjorë përkatës për vënien në zbatim të VKM-së;
2. dërgimi i informacionit lidhur me zbatimin e pikës 21 të VKM-së;
3. ngritja e grupit të monitorimit referuar VKM 473/2017;
4. caktimi i personit të kontaktit për secilin institucion anëtar të Task-Forcës që asiston punën e sekretariatit teknik, referuar nenit 24 të VKM-së nr.473, datë 1.06.2017;
5. dërgimi i informacioni (brenda datës 09.06.2017) lidhur me zbatimin e urdhrin të Kryeministrit nr. 65, datë 12.5.2017 dhe më pas të VKM-së nr. 473, datë 01.06.2017;
6. dërgimi i informacionit (brenda datës 09.06.2017) lidhur me respektimin e procedurës për dhënien e lejeve vjetore për punonjësit, bashkë me listën e lejeve vjetore për vitin 2017;

7. dërgimin i informacionit (brenda datës 09.06.2017) lidhur me konsumin e karburantit nga çdo institucion për periudhën janar 2017-qershor 2017, i ndarë në muaj dhe i krahasuar me periudha të njëjta të vitit paraardhës;
8. dërgimi i programit analitik të buxhetit si dhe buxhetin faktik të institucionit duke treguar njëkohësisht nëse ka pasur përdorim të buxhetit jashtë zërave të programit analitik të dërgohet një informacion i detajuar lidhur me përdorimin e karburantit nga ana e institucionit për vitin 2017;
9. krijimin e një rubrike/numri kontakti/e-maili në faqen zyrtare të internetit të institucionit përkatës ku do të denoncohen shkelje të legjislacionit për zgjedhjet dhe Kodit Penal për veprat e lidhur me sistemin e zgjedhjeve nga punonjës të administratës shtetërore, në lidhje me procesin zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017;
10. përgatitjen e një formulari tip për tu plotësuar atëherë kur merren denoncime për shkelje të legjislacionit për zgjedhjet dhe Kodit Penal për veprat e lidhur me sistemin e zgjedhjeve nga punonjës të administratës shtetërore;
11. Përgatitja e një formulari tip për referimin e rasteve kur punonjësi i administratës shtetërore ka shkelur legjislacionin në fuqi lidhur me procesin zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017;
12. Krijimi i një rubrike në faqen zyrtare të internetit të çdo ministrie dhe/ose institucioneve të varësisë ku do të raportohen rastet e shkeljeve të legjislacionit në fuqi në lidhje me procesin zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017. Publikimi i një numri kontakti në faqe;
13. Raportim ditor i Policisë së Shtetit për masat e marra për mbarëvajtjen e procesit dhe reagim në kohë reale për rastet e referuara.  
Policia e Shtetit cakton pika kontakti në të gjitha Drejtoritë Rajonale, ku të gjitha institucionet referojnë rastin e adresuar nga burime të ndryshme për të cilin ka nevojë për verifikim dhe vlerësim të menjëhershëm. Pikat e kontaktit pranë çdo Drejtorie Rajonale ofrojnë shërbimin e kërkuar, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet që kanë adresuar rastin.  
Policia e Shtetit gjithashtu duhet të raportojë sa më shpejt pranë sekretariatit të Task-Forcës lidhur me monitorimin dhe masat e marra nga ana e saj për luftën kundër lëndëve narkotike si dhe informacionin që disponon lidhur me elementë kriminalë që mund të çënojnë mbarëvajtjen e procesit zgjedhor apo të financojnë atë me mjete monetare/financiare të paligjshme.  
Informacioni që përbën sekret shtetëror t'i dërgohet personalisht vetëm Zëvendëskryeministrit si person i pajisur me certifikatë sigurie.



14. Informacion të vazhdueshëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit të Parave për financimet nga burime të jashtëligjshme në fushatën elektorale (informacioni i përcillet Kryetarit të Task-Forcës).

Në vijim të kësaj mbledhjeje me qëllim mbledhjen e informacionit referuar detyrave të lëna nga Task-Forca në këtë mbledhje dhe referuar problematikave të lindura gjatë procesit të monitorimit, Zyra e Zëvendëskryeministrit ka vlerësuar t'u kërkojë institucioneve shtetërore informacionin sa më sipër përmes shkresave zyrtare.<sup>36</sup>

#### **(ii) Mbledhja e Dytë e Task-Forcës (Datë 16 Qershor 2017)**

Kjo mbledhje u zhvillua disa ditë më vonë nga sa ishte menduar, për shkak se informacioni i kërkuar nuk ishte përcjellë në kohën e duhur, ishte i paqartë, i papërpunuar dhe i pakonsoliduar nga grupet e monitorimit në Ministri.

Në këtë mbledhje iu tërhoq vëmendja të gjitha Ministrive që të dërgonin informacionin e konsoliduar, duke përfshirë dhe informacionin e përcjellë nga institucionet e tyre të varësisë apo shoqëritë shtetërore që zotërojnë apo kontrollojnë.<sup>37</sup>

Ka rezultuar se Bashkia Tiranë ka refuzuar dhënien e informacionit dhe bërjen transparente të të dhënave të kërkuara referuar detyrimit që rrjedh nga VKM 473/2017 dhe transparencës me publikun.<sup>38</sup>

Task-Forca ka lënë detyra për Ministrat që të ndërmarrin masa në drejtim të titullarëve të institucioneve si dhe në drejtim të procedimit disiplinor të punonjësve të administratës shtetërore, të cilët kanë penguar mbledhjen, përpunimin e informacionit sipas kërkesës dhe përcjelljen e tij në sekretariatit teknik të Task-Forcës, duke e konsideruar këtë një shkelje të rëndë për sa kohë nuk zbatohet VKM 473/2017.<sup>39</sup>

<sup>36</sup> Shih shkresa të Zëvendëskryeministrit: nr. 3243, datë 5.06.2017, drejtuar Bashkive; nr. 3294, datë 7.06.2016, drejtuar Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave; nr. 3295, datë 7.06.2017, drejtuar Policisë së Shtetit; nr. 3296, datë 7.06.2017, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme; nr. 3297, datë 7.06.2017, drejtuar Bashkive; nr. 3298, datë 7.06.2017, drejtuar Prefekturave; nr. 3299 dhe 3300, datë 7.06.2017, drejtuar Ministrive; nr. 3311, datë 8.06.2017, drejtuar KQZ; nr. 3312 datë 8.06.2017, drejtuar Avokatit të Popullit; nr. 3315, datë 8.06.2017, drejtuar KMSHC; nr. 3316, datë 8.06.2017, drejtuar DAP; nr. 3369, 3370, dt.12.06.2017, drejtuar Ministrive; nr. 3371 dhe 3372, datë 12.06.2017, drejtuar Prefekturave; nr. 3373, 3373, datë 12.06.2017 dhe nr. 3394, 3395, datë 13.06.2017, drejtuar Bashkive.

<sup>37</sup> Shih Proces-Verbal datë 16.06.2017.

<sup>38</sup> Po aty

<sup>39</sup> Po aty

Në këtë mbledhje janë trajtuar dhe kërkesa të paraqitura zyrtarisht nga subjekti elektoral LSI referuar rastit Gjoza, ku në përfundim është njoftuar subjekti elektoral në lidhje me procedurat e ndjekura dhe përgjigjet zyrtare të kthyera nga organi i Prokurorisë.

Po ashtu subjekti elektoral LSI është ftuar të paraqesë fakte dhe prova lidhur me deklaratat e bëra përmes shkresës zyrtare për implikim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë me elementë kriminalë, kultivues të bimëve narkotike.<sup>40</sup>

Është trajtuar shqetësimi i ngritur nga KQZ në lidhje me pengimin e punonjësve të administratës në KZAZ, KQV dhe GNV nga ku ka rezultuar se në çdo rast Task-Forca veç ka kërkuar të respektohet një pjesëmarrje e tillë dhe në asnjë nuk ka luajtur rol pengues.

Drejtoria e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave ka raportuar në këtë mbledhje për një rast të transaksioneve të dyshimta, ndërkohë mbi bazën e informacionit të përcjellë nga Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë , i është kërkuar të hetonte në lidhje me tërheqje të parave nga bankat e nivelit të dytë gjatë muajit Prill-Maj 2017 dhe përdorimit të tyre për financim të subjekteve elektorale në mënyrë të paligjshme apo që mund të përdoren në procesin e shitblerjes së votës.

Në përfundim të mbledhjes u kërkuar informacion shtesë në drejtim të monitorimit të problematikave të listave të zgjedhjeve, pezullimeve të bëra nga DAP mbi bazën e konstatimeve apo me kërkesë të vetë nëpunësit civil, rezultatet e monitorimit dhe masat e marra nga ana e KMSHC si dhe informacione të tjera shtesë për kallëzimet në prokurori si rezultat i veprave penale në fushën e zgjedhjeve të kryera nga ana e punonjësve të administratës shtetërore në nivel qendror dhe vendor apo edhe punësime largime nga detyra referuar nenit 88 të Kodit Zgjedhor.<sup>41</sup>

### **(iii) Mbledhja e tretë e Task-Forcës (Datë 20.06.2017)**

Kjo mbledhje është thirrur me iniciativë të Kryetares së Task-Forcë, duke marrë shkas nga shkresat zyrtare të adresuara nga subjekti elektoral LSI, ku përveç denoncimit të dhunës gjatë procesit elektoral ka denoncuar aktivizim të elementëve kriminalë për të mbështetur subjekte politike.

<sup>40</sup> Shkresë e Zëvendëskryeministrit nr. 3361/1, dt.12.06.2017, drejtuar Kryetarit të LSI.

<sup>41</sup> Shih shkresa të Zëvendëskryeministrit: nr. 3468, datë 16.06.2017, drejtuar DAP; nr. 3467, datë 16.06.2017 drejtuar KMSHC; nr. 3469, datë 16.06.2017, drejtuar MPB; nr. 3470, 3471 dhe 3474, datë 16.06.2017, drejtuar Ministrive; nr. 3472, datë 16.06.2017, drejtuar Prefekturave; nr. 3473, datë 16.06.2017, drejtuar Prefekturave; nr. 3475, datë 16.06.2017 drejtuar Bashkive.

Përveç rasteve të adresuara në rrugë zyrtare nga subjekti elektoral LSI, Drejtorit të përgjithshëm të Policisë i është kërkuar të raportojë si më poshtë vijon<sup>42</sup>:

- (i) informacion për shitblerje të votës shoqëruar me rastet e identifikuar deri më sot;
- (ii) informacion për planin e masave të hartuar për trajtimin e incidenteve gjatë fushatës zgjedhore apo ditën e zgjedhjeve;
- (iii) informacion lidhur me implikimin e punonjësve të Policisë së Shtetit në mbështetje të subjekteve zgjedhore dhe bashkëpunimi me elementë kriminalë, si dhe masat e marra (nëse ka).

Referuar raportimit të datës 20 Qershor 2017 nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka rezultuar se ishin identifikuar 4 raste të shitblerjes së votës deri në atë datë, ku janë kryer veprimet procedurale dhe rastet i janë referuar organit të Prokurorisë.<sup>43</sup>

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka raportuar se deri në atë datë strukturat e Policisë së Shtetit nuk dispononin asnjë informacion për përfshirje të ndonjë punonjësi policie në procesin zgjedhor apo bashkëpunimi me elementë kriminalë.<sup>44</sup>

Task-Forca ka ftuar çdo qytetar apo subjekt zgjedhor të kallëzojë nominalisht pranë Policisë së Shtetit dhe/ose prokurorisë çdo punonjës të policisë së shtetit të përfshirë në kryerjen e veprave të tilla penale.

Gjithashtu, Task-Forca ka ftuar organin e Prokurorisë të ndjekë me përparësi çdo vepër penale që prek sistemin e zgjedhjeve të lira si dhe veprat penale që i janë referuar nga Policia e Shtetit për rastet e adresuara nga subjekti elektoral LSI në vëmendje të Task-Forcës.<sup>45</sup>

Në kuadër të transparencës dhe trajtimit të barabartë të të gjithë subjekteve zgjedhore në vijim të raportimit të bërë nga Policia e Shtetit, Task Forca ka informuar subjektin zgjedhor LSI duke e inkurajuar të paraqesë fakte dhe prova që tregojnë implikim të punonjësve të Policisë së Shtetit në mbështetje të subjekteve elektorale dhe të bashkëpunimit me elementë kriminalë.<sup>46</sup>

---

<sup>42</sup> Shih shkresë nr. 3490, datë 19.06.2017 e Zëvendëskryeministrit drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

<sup>43</sup> Shih raportim i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, nr. 865, datë 19.06.2017, drejtuar Zëvendëskryeministrit, faqe 3-4.

<sup>44</sup> Po aty, faqe 6.

<sup>45</sup> Shih Proces-Verbal i Mbledhjes së Task-Forcës, datë 20.06.2017.

<sup>46</sup> Po aty

**(iv) Mbledhja e katërt e Task-Forcës (Datë 21.06.2017)**

Kjo mbledhje ishte vendosur nga Task-Forca dhe kishte objekt monitorimin e sjelljes së punonjësve të administratës shtetërore, përdorimit të fondeve buxhetore dhe punësimeve apo shkarkimeve gjatë fushatës elektorale, bazuar në informacionin e kërkuar nga Ministritë, Bashkitë dhe Prefekturat referuar monitorimit të kryer sipas Urdhrit 65/2017 dhe në vijim VKM 473/2017.

Sërish ka pasur paqartësi dhe mangësi në informacion, çfarë ka penguar Task-Forcën të realizojë monitorimin sipas objektit të përcaktuar në VKM 473/2017.

Task-Forca i ka kërkuar Ministrit të Arsimit, Financave dhe jo vetëm, Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil që sipas fushës së tyre të kompetencës të monitorojnë dhe të propozojnë/marrin masa disiplinore në rastet kur nëpunësit civil nuk kanë përmbushur detyrat për raportim të saktë e të plotë referuar VKM-së më sipër, duke e konsideruar një shkelje disiplinore të rëndë të titullarëve të institucioneve dhe të punonjësve të administratës shtetërore të ngarkuar me këtë detyrë referuar pikës 32 të VKM 473/2017, ku përcaktohet se *“Moszbatimi i rregullave dhe detyrimeve të parashikuara në këtë vendim passjell përgjegjësi disiplinore dhe ligjore ..”*.<sup>47</sup>

Sipas raportimit të Ministrit të Brendshëm rezulton se nuk janë konstatuar probleme me listat e zgjedhësve, të cilat janë përditësuar me zgjedhësit që mbushin moshën për të votuar deri ditën e zgjedhjeve (*përfshirë këtë ditë*)<sup>48</sup>. Nga Avokati i Popullit u ngrit shqetësimi për rreth 900 të dënuar që nuk kanë mundësi të votojnë për arsye se i kanë dokumentet e identifikimit nëpër komisarate apo prokurori, apo edhe për një pjesë të tyre që e kanë të pamundur pajisjen me karta identiteti pasi duke qenë se vuajnë dënimin nuk kanë të ardhura për të paguar tarifën për pajisjen me to, çështje e adresuar paraprakisht dhe nga Ministri i Drejtësisë.<sup>49</sup>

Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit dhe të Parave lidhur me shqetësimin e Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë për tërheqjet e parave gjatë muajit Prill-Maj 2017 nga bankat e nivelit të dytë raportoi se nuk vërehet tërheqje jashtë trendit të viteve të kaluara dhe se nga analizat e kryera nga kjo drejtori nuk ka arsye të besohet se ka

<sup>47</sup> Shih Proces- Verbal i Mbledhjes së Task-Forcë, datë 21.06.2017.

<sup>48</sup> Shih shkresë e Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 4997/1, datë 19.06.2017, drejtuar Zëvendëskryeministrit.

<sup>49</sup> Shih Proces-Verbal datë 21.06.2017.

përdorim të parave të paligjshme në fushatë.<sup>50</sup> Pavarësisht informacionit, sipas VKM 473/2017 është detyrë e Drejtorisë së Policisë dhe Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave të raportimit të rasteve të transaksioneve të dyshimta apo të përdorimit të burimeve financiare që vjen nga veprimtaria e paligjshme.<sup>51</sup>

Sipas kërkesës së Task-Forcës, Komisioneri ka raportuar se numri i mungesave pa arsye të nëpunësve civilë në administratën shtetërore gjatë periudhës së monitorimit (data 25 Maj-21 Qershor) është rreth 100, por që nuk është bërë e mundur të identifikohet nëse këta punonjës kanë marrë pjesë në fushatë gjatë orarit të punës.<sup>52</sup>

Gjithashtu, Komisioneri ka raportuar se nga informacion që disponon nuk rezulton të ketë raste vonesash në dhënien e lejes për të shërbyer si komisionerë të nëpunësve civilë.

Sipas kërkesës të Task-Forcës, Drejtoresha e DAP ka raportuar se ka 14 raste shkeljesh që janë referuar për procedim disiplinor, të cilat janë në ndjekje e sipër. Njëkohësisht u raportua se janë pezulluar 24 nëpunës civilë për shkak kandidimi në zgjedhje.<sup>53</sup>

Task-Forca ka ftuar KQZ të adresojë rastet e pengimit për pjesëmarrje në KZAZ, KNV dhe GNV, ndërsa Prokuroria është ftuar të raportojë në lidhje me çështjet e adresuara në lidhje me veprat penale në fushën e zgjedhjeve dhe kryesisht përfshirjes së administratës dhe forcave të policisë.

Ministrive u është kërkuar që të dërgojnë informacion lidhur me regjistrin e ankesave që administrojnë për shkeljet në fushën e zgjedhjeve duke treguar mënyrën se si janë trajtuar ankesat dhe përfundimet e arritura për to.<sup>54</sup>

#### **(v) Mbledhja e pestë e Task-Forcës (Datë 23.06.2017)**

Kjo mbledhje është thirrur me iniciativë të Kryetarit të Task-Forcës referuar pikës 25 të VKM 473/2017.

Në këtë mbledhje është diskutuar lidhur me planin e masave operationale për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, duke caktuar detyra të posaçme për disa nga ministrinë dhe Drejtorinë e e

<sup>50</sup> Shih shkresë nr.477, datë 20.06.2017.

<sup>51</sup> Pika 26 e VKM 473/2017.

<sup>52</sup> Shih shkresa nr.1145, dt.21.06.2017, e KMSHC drejtuar Zëvendëskryeministrit, faqe 3.

<sup>53</sup> Shih shkresa nr. 4079/1, datë 20.06.2017 e DAP drejtuar Zëvendëskryeministrit dhe Proces- Verbal i mbledhjes Task-Forcë datë 21.06.2017.

<sup>54</sup> Shih Proces- Verbal datë 21.06.2017.

Përgjithshme të Policisë.<sup>55</sup> Plani i Masave Operacionale (ANEKSI XVIII(v)) është mirëpritur dhe dakordësuar nga anëtarët e Task-Forcës.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka raportuar planin e masave të saj tepër të detajuar për periudhën zgjedhore dhe se funksiononte edhe Qendra e Koordinimit në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, e cila vepron dhe koordinon procesin në kohë reale.

Drejtori i Përgjithshëm shprehu angazhim maksimal për bashkëpunim me Task-Forcën në mënyrën më të mirë të mundshme për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në ditën e zgjedhjeve për ndjekjen dhe trajtimin e rasteve të referuar prej saj.

Task-Forca në këtë mbledhje ka shprehur mbështetje për forcat e policisë, por ka kërkuar nga ana e tyre angazhim maksimal dhe masa shtesë për garantimin e zgjedhjeve të lira.<sup>56</sup>

#### **(vi) Mbledhja e gjashtë e Task-Forcës (Datë 25.06.2017)**

Kjo mbledhje është thirrur me iniciativë të Kryetarit të Task-Forcës referuar pikës 25 të VKM 473/2017, duke marrë shkas nga adresimet e rasteve të ndryshme në Task-Forcë në ditën e zgjedhjeve dhe informacioneve të ardhura për implikim të punonjësve të policisë në mbështetje të subjekteve elektorale dhe bashkëpunimit me elementë kriminalë pas takimit të realizuar me Ministrin e Punëve të Brendshme dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë në atë ditë.

Zëvendës drejtori i Policisë së Shtetit, Z. Qato ka raportuar për situatën e rasteve të denoncuara dhe masat e marra nga Policia e Shtetit.

Task-Forca referoi për 20 raste të denoncuara nga ana e saj, nga të cilat janë trajtuar vetëm 2 me arsyetimin se për shkak të ngarkesës së madhe me denoncime ka qenë e pamundur dhënia përgjigje për të gjitha rastet e referuara nga Task-Forca.

Task-Forcës referoi ditën e zgjedhjeve 35 emra personash në polici nga të cilat 15 kishin të bënë në administratën shtetërore në Korçë. Nuk u raportua lidhur me verifikimet e kryera për personat në fjalë.

Policisë së Shtetit iu kërkuar informacion dhe sqarime për rastet konkrete për të vlerësuar efektivitetin e policisë dhe mënyrën e ndjekjes dhe trajtimit të denoncimeve prej saj. Nga

<sup>55</sup> Shih Plani i Masave Operacionale miratuar në mbledhjen e Task-Forcë datë 23.06.2017.

<sup>56</sup> Shih Proces-Verbal datë 23.06.2017.

policia nuk u dhanë sqarime konkrete, pavarësisht angazhimit maksimal të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë gjatë miratimit të Masave Operacionale për Mbarëvajtjen e Procesit Zgjedhor.<sup>57</sup>

Kjo ka vënë në diskutim efektivitetin e koordinimit dhe marrjen e masave në kohë nga policia me qëllim parandalimin apo frenimin e fenomenit të shitblerjes së votës dhe intimidimit të qytetarëve gjatë procesit zgjedhor.<sup>58</sup>

Gjatë mbledhjes së Task-Forcës, Ministri i Punëve të Brendshme ka raportuar për raste të denoncuar të implikimit të punonjësve të policisë në mbështetje të subjekteve elektorale dhe bashkëpunimit me elementë kriminalë, duke treguar në mënyrë specifike implikimin e disa shefave të komisariateve në mbështetje të hapur të subjekteve të caktuar zgjedhorë si Lezhë, Pukë dhe Gramsh, raste të cilat i janë referuar nga ana e tij edhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

Ministri i Punëve të Brendshme ka pranuar se ka pohuar se ka informacione për implikime të forcave të policisë me elementë kriminalë në Delvinë, Dibër, Sarandë, Pukë, Lezhë, Dibër dhe Tiranë.

Ministri i Punëve të Brendshme dhe Z. Qato pranuan se ekziston mundësia e rrjedhjes së informacionit gjatë referimit të denoncimeve për ndjekje nga strukturat e policisë në qendër drejt atyre në bazë, por se nuk janë evidentuar raste konkrete.

Z. Qato raportoi për 14 raste veprash penale të referuara në prokurori nga policia e shtetit pa saktësuar sa prej tyre janë për shitblerje votash.

Policisë iu kërkua të sjellë raport të detajuar për çështjet e referuara nga Task-Forca dhe të merrte masa shtesë sigurie në përmbylljen e procesit të votimit.

Gjatë mbledhjes së Task-Forcës u diskutua edhe për disa raste konkrete të përfshirjes së punonjësve të administratës shtetërore në veprime të kundërligjshme, konkretisht rasti i drejtorit të OSHEE Vorë, i cili si komisioner i Partisë Socialiste është përfshirë në shitblerje votash sipas filmimeve video të regjistruara, rasti i përdorimit të faqes zyrtare të Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH) që është institucion i lartë i administratës, për propagandë zgjedhore në favor të subjektit zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim duke përdorur asete

---

<sup>57</sup> Shih Proces-Verbal datë 25.06.2017.

<sup>58</sup> Po aty

të institucioneve publike dhe rasti Kryetarit të Bashkisë Tiranë, i cili në shkelje të heshtjes zgjedhore sipas denoncimeve të shumë qytetarëve përmes fotove dhe dëshmime ka shpërndarë fletë-palosje nëpër shtëpi me lutjen për të votuar Partinë Socialiste me premtimin se buxheti i Bashkisë Tiranë do të përdoret për investime në favor të tyre.

Me qëllim përmbylljen e fazës së monitorimit gjatë procesit zgjedhor dhe në pritje të informacioneve nga KQZ në lidhje me auditimin e financimit të subjekteve elektorale dhe të denoncimit të rasteve të shitblerjes së votës dhe implikimit të punonjësve të administratës shtetërore dhe forcave të policisë në këtë proces përmes Zyrës së Zëvendëskryeministrit është kërkuar informacion dhe raportim nga ana e Ministrive që kanë pasur detyrim ngritjen e grupeve të monitorimit gjatë procesit zgjedhor.<sup>59</sup>

## VIII. KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN PËRMES MEDIAS VIZIVE, ELEKTRONIKE DHE SHTYPIT TË SHKRUAR DHE TRANSPARENCA

### (i) Komunikimi me publikun dhe transparenca

Komunikimi me publikun është një hallkë e rëndësishme në aktivitetin e Task-Forcës dhe zyrës së zëvendëskryeministres me qëllim përmbushjen e detyrimit ndaj publikut për të ofruar transparencë maksimale të vendimmarrjes dhe efektivitetit të saj, po ashtu edhe realizimit të misionit, sigurimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme.

Task-Forca për zgjedhjet 2017 ishte një organizimi ri, me një kohë të shkurtër veprimi dhe marrëdhëniet me publikun ishin intensive. Në këtë kuadër, zyra e zëvendëskryeministres e vlerësoi komunikimin ndërveprues me publikun si një çështje parësore dhe me rëndësi strategjike, për të transmetuar tek opinionin publik forcën vendimmarrëse të saj në drejtim të ndalimit të veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin e 2017.

Zyra e zëvendëskryeministres, përmes mjeteve të informacionit publik, medias vizive, elektronike dhe shtypit shkruar, i bërë të ditur publikut vendimmarrjen e Task-Forcës si dhe

<sup>59</sup> Shih shkresat e Zëvendëskryeministrit: nr. 3642, datë 30.06.2017, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; nr. 3594, datë 27.06.2017, drejtuar gjithë Ministrive; nr. 3595, datë 27.06.2017 drejtuar Ministrit të Punëve të Brendshme; nr. 3680, datë 4.07.2017 drejtuar Ministrive.



rastet e trajtuar nga kjo zyrë. Për informimin e publikut zyra e zëvendëskryeminstres përdori një sërë kanalesh komunikimi, me qëllim shpjegimin sa më qartë të objektivit të saj, si dhe të mënyrës së përmbushjes së tij. Ndër to përmendim: Komunikimet për shtyp, rreth rendit të ditës dhe të vendimmarrjes së Task-Forcës në zbatim të VKM 473/2017, pika 28 në të cilën shkruhet: *“Task-Forca, nëpërmjet zyrës së shtypit të Kryeministrit, komunikon me publikun për çështjet e shqyrtuara dhe masat e marra”*.

Nga gjashtë mbledhjet e Task-Forcës të realizuara nga periudha 5 qershor deri më 25 qershor publiku ka arritur të informohet si për rendin e ditës ashtu edhe përfundimet.<sup>60</sup>

Përgjatë periudhës intensive të punës 23 maj - 25 qershor, komunikimi me publikun është realizuar nëpërmjet njoftimeve, deklaratave për shtyp, daljeve publike dhe intervistave të zëvendëskryeminstres Mandija, në Televizionet Kombëtare me shikueshmëri të lartë, gjatë të cilave i është shpjeguar publikut të gjerë, mbi të drejtat dhe përgjegjësitë që kanë nëpunësit civilë, në nivel qendror e vendor mbi të drejtën e pjesëmarrjes jo aktive jashtë orarit zyrtar në veprimtari politike duke respektuar kufizimet e përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi.

Publiku është informuar edhe në lidhje me qëndrimet që zëvendëskryeministrja Mandija, në cilësinë e drejtueses së Task-Forcës, ka mbajtur në drejtim të pretendimeve të partive politike, të cilat kishin keqkuptuar veprimtarinë e punës së Task-Forcës. Për këtë qëllim zëvendëskryeministrja e vendosur në përmbushjen e misionin për garantimin e zhvillimit të një procesi zgjedhor të qetë, të lirë dhe të ndershëm ka komunikuar me publikun nëpërmjet intervistave dhe deklaratave për shtyp.

Nga zyra e zëvendëskryeminstres publiku është njohur edhe me ankesat e partive politike në drejtim të Policisë së Shtetit si dhe disa autoriteteve lokale. Njëkohësisht kjo zyrë ka mbajtur qëndrim publik ndaj këtyre shqetësimeve, duke nxitur paanshmërisë dhe trajtimin e barabartë të të gjithë kandidatëve dhe partive politike në procesin elektoral.

Zyra e zëvendëskryeminstres ka bërë komunikime të përditshme të rasteve të trajtuara nga informacionet e marra në rrugë operative që kishin të bënin me punësimet gjatë fushatës zgjedhore, largimet nga detyra, transferimet në kundërshtim me ligjin, të referimit të rasteve të caktuara në prokurori dhe polici me qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale në fushën e zgjedhjeve. Këto komunikime kanë pasur si qëllim inkurajimin e punonjësve të administratës dhe të çdo qytetari për të denoncuar pranë Task-Forcës rastet e përfshirjes në

---

<sup>60</sup> Shih ANKESI XVIII.

fushatë të administratës apo denoncimin e rasteve të përdorimit të funksionit publik në favor të një subjekti zgjedhor.

Ky model i komunikimit është ndjekur edhe nga ana e ministrave të Arsimit, Drejtësisë, Financave, Shëndetësisë, Rendit dhe të Punës dhe Mirëqenies Sociale, të cilët kanë bërë publik fillimin e çdo procedimi disiplinor, masat administrative të ndërmarrë në drejtim të shkarkimit, pezullimit apo edhe të denoncimit të organeve të policisë me qëllim parandalimin e situatave të ngjashme dhe të garantimit të një procesi zgjedhor të lirë dhe të ndershëm.

Zyra e zëvendëskryeminstres u kujdes që një ditë para zgjedhjeve të shpërndahej në mënyrë të gjerë në të gjithë median njoftimi për ekzistencën një portali denoncimesh dhe një numër telefoni të vënë në dispozicion të individëve dhe subjekteve elektorale. Kjo me qëllim referimin e rasteve të përfshirjes së administratës dhe policisë shtetit në veprimtari të paligjshme në ditën e zgjedhjeve dhe gjatë procesit të numërimit. Kjo ia arriti qëllimit sepse numri telefonik u përdor gjerësisht nga individë që i përkisnin subjekteve elektorale të ndryshme në denoncimin e parregullive në zgjedhje. Vetë zëvendëskryeministrja tha një prononcim për këtë ditë e zgjedhjeve në Televizionin informativ ABC News.

***Portali nuk ka funksionuar në asnjë rast, dhe akoma sot nuk funksionon. Zv/Kryeministrja në mbledhjet Task Forcës pati deklaruar lidhur me vendosjen e një portali në faqen zyrtare të Kryeministrisë, ku nga publiku të bëheshin të njohura të gjitha aktet, korrespondencat në kuadër të monitorimit si dhe të denoncoheshin rastet e ndryshme.***

Materiali Përmbledhës i Task-Forcës për zgjedhjet 2017, si instrumenti kryesor i komunikimit të shkruar të vendimmarrjes së saj, është akti i fundit zyrtar që synon t'i përcjellë publikut një tablo gjithëpërfshirëse të gjetjeve, problematikave dhe rekomandimeve, të cilat do të shërbejnë si orientim nëse qeveria shqiptare do të aplikojë një strukturë të tillë në të ardhmen.

## **(ii) Komunikimi me publikun në ditën e zgjedhjeve**

Komunikimi me publikun ditën e zgjedhjeve ishte një moment i rëndësishëm në aktivitetin e Task-Forcës dhe zyrës së Zëvendëskryeministrit me qëllim përmbushjen e detyrimit ndaj publikut për të ofruar transparencë maksimale të vendimmarrjes dhe efektivitetit të saj, po ashtu edhe në arritjen e objektivit kryesor të saj rritjen e besueshmërisë së qytetarëve dhe

subjekteve elektorale ndaj misionit të Task-Forcës, sigurimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme.

Në këtë kuadër, zyra e zëvendëskryeminstres e vlerësoi komunikimin me publikun si një çështje parësore dhe me rëndësi strategjike, për të transmetuar tek opinioni publik objektivin kryesor të saj, mos përfshirjen e administratës në nivel lokal dhe qendror si dhe mospërfshirjen e policisë së shtetit në veprimtari të paligjshme, në ditën e zgjedhjeve.

Ditën e zgjedhjeve zyra e Zëvendëskryeminstrit vuri në dispozicion të publikut dhe subjekteve elektorale portalin e denoncimeve dhe numrit të telefonin me qëllim referimin e rasteve të përfshirjes së administratës dhe policisë së shtetit në veprimtari të paligjshme këtë ditë dhe gjatë procesit të numërimit.

Madje për të rritur efektin dhe besueshmërinë Zëvendëskryeministri dha për këtë temë edhe në një intervistë në orët e para të mëngjesit të ditës së votimeve, në Televizionin informativ me shtrirje të gjerë ABC News.

Ky njoftim ia arriti qëllimit sepse numri i telefonit u përdor gjerësisht nga individë që i përkisnin subjekteve zgjedhorë të ndryshëm për denoncimin e parregullsive në zgjedhje. Të gjitha ankesat që u morën nëpërmjet thirrjeve telefonike iu adresuan në kohë reale për ndjekje qendres së koordinimit për zgjedhjet pranë Policisë së Shtetit.

Vonesa në reagim dhe përgjigje nga ana e Policisë së Shtetit detyroi Zëvendëskryeminstri të takohet në mesditë me Ministrin e Brendshëm Dritan Demiraj dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Z. Haki Çako me qëllim marrjen e masave nga ana e Policisë së Shtetit për rastet e denoncuar, nëpërmjet numrit të vënë në dispozicion dhe portalin elektronik të denoncimeve.

Në përfundim të takimit Zëvendëskryeminstri Mandija njoftoi mbledhjen e Task-Forcës në rendin e ditës të cilës si çështje kryesore është raportimi nga Ministri i Brendshëm dhe Drejtorit i Policisë së Shtetit për këtë problematikë.

Në përfundim të mbledhjes së Task-Forcës, zyra e Zëvendëskryeminstres Mandija, njoftoi për opinionin publik përfundimet e kësaj mbledhje ku u theksua se nga 20 raste të referuara në polici nga subjektet elektorale dhe qytetarë të ndryshëm përmes Zyrës së Kryeminstrit si kryetar i Task-Forcës, policia ktheu përgjigje vetëm për 2 raste. Kjo vuri në diskutim efektivitetin e koordinimit dhe marrjen e masave në kohë reale nga policia me qëllim

parandalimin apo frenimin e fenomenit të shitblerjes së votës dhe intimidimit të qytetarëve gjatë procesit zgjedhor.

Qëllimi i kësaj Task-Force në përmbushjen e detyrimit ndaj publikut për të ofruar transparencë maksimale të vendimmarrjes dhe efektivitetit të saj ia arriti qëllimit. Informacionet gjetën shpërndarje gjerësisht si shtypin e shkruar, median vizive ashtu edhe atë elektronike.

### **(iii) Komunikimi me subjektet elektorale**

Task-Forca në mbledhjen e datës 23.06.2017 me qëllim marrjen e denoncimeve apo njoftimeve nga subjektet politike pjesëmarrëse në zgjedhje bëri publik një numër telefoni me qëllim që të gjitha ato subjekte zgjedhorë të cilat do të kishin informacione për cënim të procesit zgjedhor të adresonin shqetësimet e tyre pranë Task-Forcës.

Gjatë gjithë procesit të dorëzimit të materialeve zgjedhore një ditë para datës së zgjedhjeve, ditën e zgjedhjeve dhe gjatë procesit të numërimit të votave asnjë subjekt zgjedhor nuk adresoi shqetësime apo informacione pranë zyrës së Zëvendëskryeministrit, me përjashtim të një rasti nga dega e PS Priskë.

Deri në hartimin e këtij materiali përmbledhës asnjë subjekt zgjedhor nuk ka paraqitur informacion pranë zyrës së Zëvendëskryeministrit në lidhje me këto raste.

## **IX. REZULTATI I MONITORIMIT SIPAS INFORMACIONIT DHE RAPORTIMIT TË BËRË NGA INSTITUCIONET**

Monitorimi është kryer mbi bazën e informacioneve dhe raportimeve të dërguara nga ministritë, përfshirë shoqëritë shtetërore të zotëruara apo kontrolluara prej tyre, institucionet e tyre të varësisë, entet publike, prefekturat dhe bashkitë, përfshirë ndërmarrjet publike në varësinë e tyre.

Të dhënat e kërkuara për çdo Ministri apo Institucion tjetër, përfshirë Bashki dhe Prefektura janë në formë tabelore.<sup>61</sup>

Duhet theksuar se të gjitha institucionet më sipër kanë kthyer përgjigje, ndonëse jo për të gjitha çështjet.

I vetmi institucion që nuk ka kthyer asnjë përgjigje të vetme është Bashkia Tiranë, e cila besojmë se ka mbajtur këtë qëndrim për shkak të mendimit të dhënë nga KMSHC se pushteti vendor nuk ka asnjë detyrim për të dërguar të dhëna Task-Forcës për shkak se VKM 473/2017 nuk gjen zbatim për bashkitë.

Këtë qëndrim Komisioneri e ka shprehur dhe në mbledhjen e datës 16.06.2017 të Task-Forcës, pavarësisht se ka përmendur disi faktin që për pjesë të informacionit, konkretisht atë që ka të bëjë me leje vjetore për marrëdhëniet e punës që rregullohen nga Kodi i Punës institucioni vlerëson nëse do dërgojë informacion sigurisht duke mos cënuar transparencën. Pjesa e fundit e mendimit të Komisionerit është e paqartë së çfarë nënkuptohet.

Gjithsesi, theksojmë se ky qëndrim i Komisionerit, ashtu siç u diskutua edhe në Task-Forcë është tërësisht i gabuar pasi referuar pikës 2, paragrafi 2 dhe 4 i VKM 473/2017 Bashkia Tiranë ishte e detyruar të përgjigjej. Për më tepër që dërgimi i informacionit të kërkuar i shërbente transparencës dhe vendosjes së besimit të opinionit publik që edhe kjo bashki si bashkia më e madhe në vend që administrojnë para publike të konsiderueshme zbaton kuadrin ligjor për zgjedhjet.<sup>62</sup>

## A. Ngritja e grupeve të monitorimit dhe mënyra e funksionimit të tyre

### I. Ministrinë, Institucionet e Varësisë, Entet Publike dhe shoqëritë shtetërore

Lidhur me aktet nënligjore në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit 65/2017 dhe më pas VKM 473/2017, e cila shfuqizoi këtë urdhër rezulton se të gjitha Ministrinë përgjithësisht kanë zbatuar këtë detyrim. Ministrat në cilësinë e titullarëve të institucioneve kanë nxjerrë urdhrat përkatës për ngritjen e grupeve të monitorimit si edhe kanë miratuar rregulloret e funksionimit të tyre sipas përcaktimeve të akteve në fjalë. Këtu bëjnë përjashtim ministrinë pa portofol (*Ministri për Marrëdhëniet me*

<sup>61</sup> **Tabela nr.1** ‘Përmbledhëse e të gjithë informacionit të dërguar pranë Task Forcës nga Ministrinë dhe Institucionet e tyre të varësisë’; **Tabela nr. 5** ‘Përmbledhëse e të gjithë informacionit të dërguar pranë Task Forcës nga Bashkitë’; **Tabela nr.6** ‘Përmbledhëse e të gjithë informacionit të dërguar pranë Task Forcës nga Prefekturat’.

<sup>62</sup> Shih Proces- Verbalin e Task Forcës datë 16.06.2017, faqe 2-8.

*Parlamentin, Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministri i Shtetit Për Çështjet Vendore*) të cilat janë ministri që nuk kanë zë të vetin në buxhetin e shtetit, por janë pjesë e buxhetit të Kryeministrit. Këto ministri nuk kanë as strukturë të vetën pasi struktura e tyre është pjesë e strukturës së Kryeministrit dhe as institucione varësie. Për rrjedhojë, aktet nënligjore në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 65/2017 dhe më pas VKM 473/2017 janë nxjerrë nga ana e Kryeministrit.

Në shumë raste është konstatuar që ministratë janë mjaftuar me faktin se ngritja e grupeve të monitorimit është bërë kryesisht në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 65/2017 dhe në momentin e hyrjes në fuqi të VKM 437/2017 është konsideruar i plotësuar ky detyrim.

Krejt ndryshe paraqitet situata në 173 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre) institucionet e identifikuar në varësi të ministrave. Nga këto institucione vetëm në 39 (tridhjetë e nëntë) raste është zbatuar ky detyrim, ndërsa për pjesën tjetër të tyre nuk është dhënë informacioni që të jenë zbatuar detyrimet që burojnë nga Urdhri i Kryeministrit 65/2017 dhe më pas VKM 473/2017.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 473, datë 01.06.2017, fillimisht Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrja e Arsimit dhe Sporteve, Ministria e Financave, Ministri i Shëndetësisë si dhe Ministri i Punëve të Brendshme gjatë muajit Maj e Qershor kryen takime sensibilizuese me strukturat e ministrave si dhe drejtuesit e tyre në nivel qendror dhe vendor për t'i përçarur rëndësinë që ka iniciativa politike për hedhjen e një hapi me vlerë historike – siç është mosçënimi i administratës shtetërore e publike nga përdorimi i kushtëzuar nga subjekte të ndryshëm elektorale. Ministrat theksuan se *'ata janë aset dhe nuk duhet të bëhen palë apo te bien pre në asnjë rrethanë nga provokime, shantazhime apo intimidime të mundshme në këmbim të votës apo si pjesë e mekanizmit aspak ligjor të shitblerjes së votës'*.<sup>63</sup>

Është për t'u theksuar fakti se nga informacionet e mbledhura në Task Forcë lidhur me rastet e referuara të shkeljeve të ndryshme ligjore nga punonjës të administratës, ka rezultuar se përgjithësisht se struktura e monitorimit nuk ka funksionuar siç duhet apo siç ishte parashikuar në VKM 473/2017. Në shumë raste institucionet (ministratë,

---

<sup>63</sup> Shih raportin MMRS, faqe 15; MSH, faqe 2; MF, faqe 12.

bashkitë dhe institucionet përkatëse të varësisë) janë mjaftuar me verifikimin formal të prezencës në punë të punonjësve të administratës dhe nuk kanë evidentuar realisht problematikat apo shkeljet e mundshme të detyrimeve që burojnë nga VKM e sipërcituar. Mungesa e këtij informacioni, krijon dyshimin e arsyeshëm, se procesi i monitorimit nga titullarët e institucioneve nuk është kryer në mënyrë serioze, por është realizuar fiktivisht.

Disa ministri kanë referuar se kanë qenë në pamundësi burimesh njerëzore dhe financiare që të mbanin nën mbikëqyrje mënyrën e realizimit të këtij procesi nga titullarët e institucioneve të varësisë, qoftë për shkak të numrit të lartë të institucioneve të varësisë, qoftë për shkak se disa prej tyre kanë edhe degë të shtrira në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, ndërkohë që aparati i ministrive në fjalë kishte në dispozicion numër të reduktuar automjetesh për inspektim në këtë proces. Në këtë kuadër, me qëllim realizimin e një procesi efikas të monitorimit të zbatimit të VKM 473/2017, do të kishte qenë e nevojshme një proces i sinqertë bashkëpunimi midis titullarëve të institucioneve të varësisë dhe ministrave. Ky proces i sinqertë bashkëpunimi përgjithësisht mungoi, duke vështirësuar monitorimin e plotë dhe korrekt të zbatimit të detyrimeve që buronin nga VKM 473/2017.

Vlen të evidentohet rasti i **Ministrisë së Drejtësisë**, ku pavarësisht miratimit të akteve të nevojshme nënligjore nga titullarët e institucioneve në varësi të kësaj ministrie, **me përjashtim të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, asnjë institucion tjetër i varësisë, nuk solli asnjë informacion për shkelje potenciale të detyrimeve që buronin nga VKM nr. 473/2017 nga nëpunësit nën varësinë e tyre administrative.**<sup>64</sup>

Kjo ka sjellë që shumë nga shkeljet ligjore të punonjësve të administratës janë verifikuar e konstatuar, jo si pasojë e referimit nga grupet e monitorimit, por nga referimet apo denoncimet e qytetarëve të ndryshëm si edhe nëpërmjet publikimeve në media.

Një rast tjetër i veçantë që mendojmë se duhet evidentuar, duke marrë shkas nga raporti i Komisionerit (faqe 16), lidhur me saktësinë e monitorimeve është ai i Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës, A. Halilaj. Ky person ishte denoncuar nga një qytetar se kishte marrë pjesë në veprimtari politike në kundërshtim me ligjin. Në kuadër të hetimit administrativ Komisioneri, ndër të tjera, për të

---

<sup>64</sup> Shih Raportin Përfundimtar të MD, faqe 10.

vërtetuar që pjesëmarrja në aktivitet ka qenë jashtë orarit zyrtar të punës ka administruar edhe regjistrin e prezencës në punë nga i cili ka rezultuar se drejtori ka qenë në punë nga ora 08:00-16:30 në ditën kur është zhvilluar aktiviteti politik dhe se nuk ka asnjë provë që të vërtetojë të kundërtën. Pa dashur të vëmë në dyshim saktësinë e informacionit, në mënyrë të arsyeshme mund të ngrihen dyshime për saktësinë e regjistrit të prezencës në punë në ato raste kur njësia e burimeve njerëzore duhet të monitorojë dhe raportojë për titullarin e institucionit apo për nëpunës të lartë civilë, nga të cilët kanë varësi administrative hierarkike.

***Nuk duket se është efektive mënyra e monitorimit të nëpunësve të lartë civilë të nivelit drejtues nga nëpunës civilë të niveleve më të ulëta, pasi këta të fundit varen nga të parët në hierarkinë administrative, çka me të drejtë vë në dyshim saktësinë e monitorimit.***

## **II. Prefektura**

Referuar informacionit të mbledhur rezulton se të gjitha Prefekturat kanë dërguar informacionin e kërkuar.<sup>65</sup> Këto Prefektura në informacionin e dërguar në përgjithësi janë shprehur se kanë marrë masa për zbatimin e Urdhrit nr. 65 të Kryeministrit duke hartuar rregulloren dhe duke ngritur grupin e monitorimit.

Për sa i përket zbatimit të VKM nr. 473 datë 01.06.2017, përveç Prefekturës të Qarkut Gjirokastrë dhe Fierit, të cilat kanë hartuar rregullore dhe kanë ngritur grup monitorimi në zbatim të kësaj VKM-je, të tjerat nuk janë shprehur, mendojmë për arsye se e kanë konsideruar si të shteruar këtë detyrë me zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit. Nga përpunimi i materialeve të ardhura nga Prefekturat e Qarqeve u vure se ky informacion nuk është shoqëruar me dokumentacionin provues (Rregulloren e Hartuar).

***Lidhur me mënyrën se si është realizuar monitorimi dhe objektivitetin e tij nuk është sqaruar përmes informacioneve të përcjella.***

## **III. Bashkitë dhe ndërmarrjet në pronësi të tyre**

Në lidhje me ngritjen e grupeve të monitorimit dhe mënyrës së funksionimit të tyre rezulton se nga 61 Bashki në rang vendi i janë përgjigjur kësaj pyetjeje vetëm 38

<sup>65</sup> Shkresa nr. 3298 prot., datë 07.06.2017.



Bashki. Këto Bashki në informacionin e dërguar janë shprehur se kanë marrë masa për zbatimin e Urdhrit nr. 65 të Kryeministrit duke hartuar rregulloren dhe duke ngritur grupet e monitorimit. Nga përpunimi i materialeve të ardhura u konstatua se ky informacion nuk është i shoqëruar me dokumentacionin përkatës siç mund të ishin urdhrat për ngritjen e grupeve të monitorimit apo rregulloret përkatëse. Gjithashtu, nuk është shpjeguar se si kanë funksionuar këto grupe të monitorimit.

Nuk kanë dërguar këtë informacion Bashkitë: Sarandë, Korçë, Maliq, Divjakë, Mirditë, Himarë, Fushe- Arrëz, Kolonjë, Pukë, Has, Pustec, Tiranë, Rrogozhinë, Finiq, Përrenjas, Vlorë, Krujë, Kavajë, Berat, Mat, Selenicë, Shkodër dhe Dropull.

*Lidhur me mënyrën se si është realizuar monitorimi, objektivitetin dhe efikasitetin e tij nuk është sqaruar përmes informacioneve të përcjella.*

## **B. Caktimi i personit të kontaktit në Task-Forcë**

### ***I. Ministrinë, Institucionet e Varësisë, Entet Publike dhe shoqëritë shtetërore***

Personi i kontaktit me Task – Forcën është caktuar nga 14 (katërbëdhjetë) ministri dhe vetëm nga 5 (pesë) institucione të varësisë së tyre.

Ndërsa emrat e personave dhe numrat e kontaktit për denoncime të rasteve të shkeljeve të dispozitave të ndryshme ligjore që kanë lidhje me zgjedhjet janë publikuar nga 15 (pesëmbëdhjetë) ministri dhe vetëm nga 11 (njëmbëdhjetë) institucione të varësisë së tyre. Pavarësisht kësaj sipas raportimeve të çdo ministrie rubrika e kontaktit/email/numra telefoni ishin funksionale për të gjitha ministrinë.

## **C. Shmangia e keqpërdorimit dhe keqinterpretimit të aktiviteteve institucionale në fushatë elektorale**

### ***I. Ministrinë, Institucionet e Varësisë, Entet Publike dhe shoqëritë shtetërore***

Ky detyrim parashikohet në pikën 21, të VKM 473/2017, sipas të cilit duhen publikuar në faqet zyrtare të internetit aktivitetet publike të programuara për muajt qershor dhe korrik dhe listën e projekteve të nisura/procedurave publike konkurruese

të realizuara prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh. Për këtë çështje rezulton se janë përgjigjur pozitivisht vetëm 11 (njëmbëdhjetë) nga 19 (nëntëmbëdhjetë) Ministri dhe 12 (dymbëdhjetë) nga 173 (njëqind e shtatëdhjetë e tre) institucione varësie të identifikuar.

Pavarësisht deklarimeve të bëra nga vetë ministritë, në fakt kanë rezultuar raste kur listat e aktiviteteve nuk ishin publikuar në faqen zyrtare të internetit, në këndvështrim me kriteret e përcaktuara në pikën 21/a të VKM nr. 473, datë 01.06.2017, duke mos ofruar në këtë mënyrë një informacion transparent dhe konkret për aktivitetet publike të institucionit, të programuara për muajt qershor dhe korrik 2017.

I tillë është rasti i organizimit nga Ministria e Kulturës i “Panairit Festiv Tradicional” në Libohovë, në datat 9 – 11 qershor 2017. Konkretisht, në adresë të Task-Forcës ka ardhur informacioni se ky panair do të përdorej për qëllime elektorale. Nga verifikimi i bërë nga Zyra e Zëvendëskryeministrit, dhe ballafaqimit të këtij informacioni me listën e aktiviteteve të publikuara nga Ministria e Kulturës në faqen e saj zyrtare të internetit, rezultoi se panairi në fjalë nuk figuronte i parashikuar në këtë listë. Ndërkohë që për këtë aktivitet ishin shpërndarë edhe ftesa, në të cilat nga ana formale nuk ishte përcaktuar institucioni organizator. Për këtë arsye, nga ana e Zyrës së Zëvendëskryeministrit i është kërkuar zyrtarisht Ministrisë së Kulturës anulimi i këtij aktiviteti.<sup>66</sup> Ky aktivitet është anuluar nga ana e Ministrisë së Kulturës.

Gjithashtu janë edhe rastet e raportuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit si edhe nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, konkretisht: Drejtuesja e DAR Gjirokastër Znj. Lindita Rova ka organizuar takimeve festive të papërfshira më parë në kalendarin e aktiviteteve të DAR, me pjesëmarrje të të gjithë mësuesve të shkollave duke refuzuar transparencën e burimeve financiare për realizimin e aktivitetit. Seria e takimeve të tilla të zhvilluara gjatë fushatës elektorale në prani të kandidatëve për deputetë të subjekte politike, konsiderohet si një formë presioni për të detyruar stafin pedagogjik të votojë për një subjekt politik të caktuar.<sup>67</sup>

**Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR)** raporton rastin e aktivitetit të organizuar në datë 16 qershor 2017 në ambiente të administratës publike, më saktësisht “Qendrën e Shërbimeve Publike ADISA” Fier, me pjesëmarrjen e Znj. Milena Harito. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit Z. Artur

---

<sup>66</sup> Shih shkresën nr. 3287, datë 07.6.2017 e vijuese të Zëvendëskryeministrit.

<sup>67</sup> Shih Raportin Përfundimtar të MAS, faqe 12.

Mickaj, ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e pikës 16 shkronja “ç”, “d” dhe “dh” të VKM nr. 473 datë 01.06.2017 me qëllim kryerjen e fushatës elektorale për një subjekt politik të caktuar. Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk është lajmëruar paraprakisht në faqen zyrtare të Ministrisë së Inovacionit, dhe as të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë apo të Shërbimit Kombëtar të Punësimit siç kërkohet nga pika 21 shkronja “a” duke treguar se ky ishte një aktivitet i menduar në momentin e fundit dhe kishte për qëllim vetëm propagandën elektorale.<sup>68</sup>

## **II. Prefektura**

Në lidhje me këtë informacion janë përgjigjur 6 (gjashtë) nga 12 (dymbëdhjetë) Prefektura të cilat kanë cituar se kanë bërë publikimin në faqen zyrtare të internetit të aktiviteteve të programuara nga Prefektura si dhe kanë publikuar listën e projekteve të nisura nga to.

Nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje Prefekturat e Qarkut: Dibër, Kukës, Durrës, Vlorë, Berat dhe Fier.

## **D. Sjellja dhe veprimtaria e administratës shtetërore dhe punonjësve të tjerë civilë**

### **I. Ministrinë, Institucionet e Varësisë, Entet Publike dhe shoqëritë shtetërore**

#### **(i) Lejet vjetore gjatë fushatës zgjedhore**

Lidhur me informacionin e kërkuar për lejet vjetore të punonjësve të dhëna nga data 25.05.2017 - 25.06.2017 rezulton se pjesa më e madhe e ministrive janë përgjigjur dhe kanë dërguar të dhënat e kërkuara nga Task – Forca, ndërsa nga institucionet e varësisë janë përgjigjur vetëm 52 (pesëdhjetë e dy) prej tyre.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministri i marrëdhënieve me Parlamentin, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike si edhe Ministria e Kulturës dhe institucionet e varësisë së saj nuk kanë dhënë asnjë informacion për këtë pikë.

Nga të dhënat rezulton se në aparatën e ministrive gjatë kësaj periudhe janë dhënë lejet e pushimit vjetor të paguar (të pjesshme apo të plota) për 52 (pesëdhjetë e dy)

<sup>68</sup> Shiko Raportin Përfundimtar të MMRS, faqe 9.

punonjës. Ndërsa për institucionet e varësisë të cilët kanë sjellë të dhëna, rezultojnë se numri i punonjësve të tyre të cilët gjatë kësaj periudhe kanë marrë lejet e pushimit vjetor të paguar (të pjeshme apo të plota) është 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë). Në total kanë marrë lejen e pushimit vjetor të paguar 168 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) punonjës.

Ministrat e MF, MD, MSH, MMRS, MAS krijuan praktikën që përmes urdhërësive të ndryshme të riorganizojnë lejet vjetore, dhe të vendosnin rregullin që administrata të ndalohej të merrte lejen vjetore gjatë fushatës elektorale, me përjashtim të rasteve të veçanta kur çmohej e nevojshme për punonjësin. Si rezultat i këtyre urdhërësive, është ndaluar fenomeni i marrjes së lejes vjetore gjatë fushatës elektorale. Në këtë drejtim, edhe Ministrat dhe institucionet e tjera të varësisë kanë krijuar praktikën e riorganizimit të lejeve vjetore dhe kanë penguar në praktikë marrjen e lejeve në mënyrë masive gjatë fushatës elektorale.

#### **(ii) Masat e marra ndaj nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë civilë për pjesëmarrje në fushatë elektorale**

Lidhur me informacionin e kërkuar për masat administrative të marra ndaj punonjësve pas datës 25.05.2017 të tilla si: largime nga detyra, pezullime apo transferime, rezultojnë se informacioni është dhënë nga të gjitha ministrat dhe 128 (njëqind e njëzet e tetë) institucione të varësisë së tyre.

Përgjithësisht informacioni nuk është dhënë i qartë për të gjitha rubrikat e kërkuara dhe për më tepër përse i përket masave të marra ndaj nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë civilë për pjesëmarrje në fushatë. Ai është dhënë në mënyrë të pjeshme dhe shpeshherë janë përfshirë edhe largimet nga detyra për shkaqe që nuk kanë të bëjnë me shkelje në fushën e zgjedhjeve si mbushja e moshës së daljes në pension, dorëheqja nga vetë punonjësi, etj.

Nga informacioni i përcjellë nga Ministrat, institucionet e tyre të varësisë rezultojnë se në total janë pezulluar 24 punonjës, transferuar 1 dhe larguar 22 të tjerë. Pothuajse, të gjithë personat e pezulluar dhe të larguar janë punonjës të tjerë të administratës, ndërkohë që për nëpunësit civilë të cilët janë denoncuar për pjesëmarrje në fushatë vazhdojnë procedimet disiplinore dhe nuk ka një vendim përfundimtar nga ana e komisioneve të disiplinës.

Ndërkohë, DAP ka raportuar në mbledhjen e Task-Forcës të datës 20.06.2017 për 14 raste procedimesh disiplinore të nëpunësve civilë, nga të cilët 5 janë nëpunës të nivelit të lartë drejtues. Nga këta 5 nëpunës civilë, 4 janë referuar pranë DAP për marrje mase disiplinore, për të cilat nuk ka pasur informacion të përditësuar për statusin aktual të procedimit apo nëse ka përfunduar dhe mënyrën e përfundimit.<sup>69</sup>

Sipas informacionit të përcjellë nga DAP është njoftuar se në lidhje me shkeljet disiplinore të lidhur me zgjedhjet janë administruar njoftimet përkatëse për ngritjen e Komisioneve Disiplinore, zhvilluar 11 procedime disiplinore në ngarkim të nëpunësve civilë, prej të cilëve 3 janë ndërprerë pasi nuk ka rezultuar të ketë shkelje nga ana e nëpunësit, ndërsa për 8 raste të tjera procedura vijon.<sup>70</sup>

Gjithashtu nga monitorimi i sjelljes dhe veprimtarisë së administratës shtetërore gjatë procesit zgjedhor rezulton sipas ministrive se janë kryer denoncimet si më poshtë për punonjës të administratës shtetërore të dyshuar si të përfshirë në shkelje në fushën e zgjedhjeve. Të dhënat janë paraqitur dhe në formë tabelare në anekse të materialit përmbledhës.<sup>71</sup>

## **(1) MINISTERIA E SHËNDETËSISË**

Nga kjo ministri, janë trajtuar 20 raste nga të cilat 7 punonjës, shumica e të cilëve në nivel drejtor spitali, shërbimi spitalor apo qendre shëndetsore janë pezulluar nga detyra, ndërsa dy të tjerë janë larguar nga puna.<sup>72</sup> Në një rast QSUT, institucion në varësi të MSH ka vednosur pezullimin e një punonjësi për shkak të pjesëmarrjes në fushatë.

Nga ana MSH janë marrë 7(shtatë) masa administrative për shkak të përfshirjes së personelit në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin, konkretisht:

1. Drejtoresha e qendrës shëndetësore nr. 1, Lushnje për shkak të zhvillimit të aktiviteteve elektorale brenda orarit të punës është pezulluar nga detyra;
2. Drejtoresha së qendrës shëndetësore Kamëz Viola Fera, për pjesëmarrje në fushatë u lirua nga detyra dhe është transferuar si mjeke në një qendër shëndetësore tjetër;

---

<sup>69</sup> Shih, Proces- Verbali i Task-Forcës datë 20.06.2017.

<sup>70</sup> Shih shkresa nr. 4359/1, datë 7.07.2017 nga DAP drejtuar Zëvendëskryeministrit.

<sup>71</sup> Shih **Tabela nr. 2** 'Masat e marra ndaj nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë civilë të Ministrive dhe institucioneve të varësisë për pjesëmarrje në fushatë elektorale'.

<sup>72</sup> Raporti i MSH, faqe 10.

3. Drejtori i Spitalit Rajonal Berat Ildir Frashëri për korrupsion aktiv në procesin zgjedhor ( premtonte vende pune së bashku me një deputet G.R), është pezulluar nga detyra për shkak të fillimit të procedimit penal ndaj tij;
4. Drejtori i Shërbimit Spitalor Librazhd Bledar Hima, i përfshirë në fushatë elektorale gjatë orarit të punës, pezulluar nga detyra;
5. Drejtori i Spitalit Rajonal Fier, Brunilda Cami, e përfshirë në fushatë elektorale gjatë orarit të punës është pezulluar nga detyra;
6. Drejtori i Spitalit Rajonal Gjirokastrë Krenar Kula, përfshirë në fushatë elektorale gjatë orarit të punës është pezulluar nga detyra;
7. Kryeinfermier në Shërbimin spitalor Kolonjë Z. Pandeli Cunge i përfshirë në fushatë gjatë orarit të punës është pezulluar nga detyra.
8. Armida Lula Drejtore e komanduar e shërbimit Spitalor Tepelene është përfshirë në fushatë gjatë orarit zyrtar është pezulluar nga detyra.

Nga Ministria e Shëndetësisë nuk janë regjistruar gjatë ditës së zgjedhjeve denoncime apo ankesa në lidhje me punonjës të administratës së shëndetësisë.

## (2) MINISTRIA E FINANCAVE

Ministria e Financave gjate periudhës se fushatës zgjedhore **ka evidentuar disa raste të pjesëmarrjes së administratës shtetërore në favor te subjekteve elektorale kryesisht si protagonist.**<sup>73</sup> Këto raste kanë ardhur si rezultat i monitorimit në vend, verifikimit të dokumentacionit apo nëpërmjet denoncimeve nga publiku. Të gjitha këto raste janë referuar pranë titullarëve të institucioneve përkatëse me qëllim nisjen e procedurave disiplinore ndaj tyre. Gjithsej janë konstatuar 8 raste të përfshirjes së administratës si më poshtë:

1. **Kliton Bistrin** me detyrë inspektor i hetimit tatimor. Është kërkuar administratës tatimore nisja e procedurave disiplinore. Nga informacionet e deritanishme rezulton që z. Bistri është ende në detyrë.
2. **Pranvera Resulaj** me detyrë Drejtoreshë Rajonale e Tatimeve ne Vlorë. Është kërkuar administratës tatimore nisja e procedurave disiplinore. Nga informacionet e deritanishme rezulton që Znj. Pranvera Resulaj është ende në detyrë.

---

<sup>73</sup> Raport i MF, faqe 11,12.

3. **Albert Halitaj** me detyrë Drejtor Rajonal i Tatimeve ne Kukës. Është kërkuar administratës tatimore nisja e procedurave disiplinore. Nga informacionet e deritanishme rezulton që z. Halitaj është ende në detyrë.
4. **Adriatik Hamza** me detyrë punonjës i degës doganore Tiranë. Është kërkuar administratës doganore nisja e procedurave disiplinore. Nga informacionet e deritanishme rezulton që Z. Hamza është ende në detyrë.
5. **Misto Kano me detyrë** punonjës i doganës Kakavijë. Është kërkuar administratës doganore nisja e procedurave disiplinore. Nga informacionet e deritanishme rezulton që z. Kano është ende në detyrë.
6. **Erlish Shalari** me detyrë punonjës i doganës Kakavijë. Është kërkuar administratës doganore nisja e procedurave disiplinore. Nga informacionet e deritanishme rezulton që Z. Shalari është ende në detyrë.
7. **Enid Hito** me detyrë Inspektor kontrolli prane DR Tatimeve Sarande. Është kërkuar administrates tatimore nisja e procedurave disiplinore. Nga informacionet e deritanishme rezulton që z. Hito është ende në detyrë.
8. **Brunilda Meleqi** me detyrë përgjegjëse e degës së Thesarit në Delvinë. Është proceduar administrativisht nga ana e MF duke e përcjellë për vlerësim ne komisionin e disiplinës.

DAP ka njoftuar kryetarin e Task-Forcës se procedimet disiplinore janë ndërprerë pasi nuk ka rezultuar të ketë shkelje nga ana e nëpunësit në këto raste:<sup>74</sup>

1. Gentian Opre, Drejtor i Analizës dhe Programit buxhetor në Ministrinë e Financave, i cili është proceduar me pretendimin se ka refuzuar pjesëmarrjen në grupin e monitorimit për DPT të ngritur me urdhër MF.
2. Ismet Lala, Drejtor i Shërbimeve të Brendshme në MF për të cilin pretendohej përdorim i mjeteve (makinës së MF).
3. Olta Prifti, Drejtor i IT në Ministrinë e Financave për refuzim të vënies në punë të numrit të gjelbër pranë Kabinetit të ministrit për regjistrimin e ankesave të adresuara në këtë ministri nga publiku.

### (3) **MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

Ministria e Arsimit dhe Sportit ka trajtuar 30 raste dhe nga këto ka evidentuar 12 raste për të cilat ka marrë masa administrative si ‘pezullim nga detyra’ për Drejtoreshen e Drejtorisë Arsimore Vlorë si dhe në dy raste të tjera ka bërë propozime për fillim të procedurave disiplinore.

---

<sup>74</sup> Shih shkresa nr. 4359/1, faqe 07.07.2017 e DAP drejtuar Zv/Kryeministrit.

Mbi bazën e informacioneve të datës 31.05.2017, Ministria e Arsimit dhe Sportit pas informacionit të marrë ka njoftuar publikisht rastet e evidentuara ku drejtues të institucioneve arsimore apo punonjës të sistemit arsimor, janë raportuar të angazhuar në fushatë elektorale, në kundërshtim me përcaktimet ligjore, si më poshtë:<sup>75</sup>

1. Drejtore e Zyrës Arsimore Rajonale, Librazhd Znj. Bardha Qatja.
2. Punonjësi i Zyrës Arsimore Kolonjë Z. Ermal Zylfo ka mbështetur fushatën elektorale të Kandidates për Zgjedhjet Parlamentare, e cila rezulton Drejtuese e Drejtorë Arsimore Rajonale, Ersekë.
3. Drejtuesi i Zyrës Arsimore Tepelenë Z. Shkëlqim Imera.
4. Drejtuese e Zyrës Arsimore, Kuçovë Znj. Eglantina Zeqo.

Më datë 01.06.2017, mbi bazën e informacioneve të raportuara, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka konstatuar përfshirjen e disa drejtuesve e punonjësve arsimorë në fushatën elektorale, duke ushtruar presion në forma të ndryshme tek nxënësit dhe mësuesit dhe ka bërë njoftim publik duke cituar detyrimet dhe përcaktimet ligjore të cituara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 473, datë 01.06.2017, “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017”, konkretisht:

1. Përgjegjëse e Zyrës Arsimore, Kurbin, znj. Majlinda Shalsi-Cara.
2. Përgjegjës i Zyrës Arsimore, Gramsh, z. Xhevit Dermyshe.
3. Përgjegjës i Zyrës Arsimore, Has, z. Selman Qema.
4. Mësuese në gjimnazin “Ibrahim Rugova” Tiranë, znj. Arjana Metaliaj.
5. Mësues në gjimnazin “Asim Vokshi”, në Bajram Curri, z. Afrim Brahaj.
6. Përgjegjëse e Zyrës Arsimore, Bulqizë znj. Bedrie Manjani e cila përveç pjesëmarrjes në fushatë në kundërshtim të plotë me përcaktimet ligjore, ka bërë presion të hapur ndaj mësuesve për përfshirjen e nxënësve në fushatë elektorale gjatë orarit mësimor (10:00 - 13:00).

Për rastet e mësipërme Ministria e Arsimit dhe Sportit ka kërkuar zyrtarisht në institucionin përkatës marrjen e masave disiplinore në dy raste, Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale të Elbasanit.

---

<sup>75</sup> Raporti i MAS (ANEKSI II).



Për të gjithë rastet e tjera, për të cilat ka fakte të dokumentuara, është bërë referimi zyrtarisht pranë organit të Prokurorisë në rrethet përkatëse.

#### **(4) MINISTERIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË**

Në këtë ministri në zbatim të detyrave të lëna në mbledhjet periodike të Task-Forcës janë administruar dhe ndjekur raste te denoncimeve të ndryshme të ardhura për përfshirjen e punonjësve të administratës apo të institucioneve të varësisë në aktivitet zgjedhor në kundërshtim me ligjin.

Sipas informacionit të dhënë rezultojnë se pas verifikimeve të kryera për rastet e referuara për periudhën 01 – 25.6.2017 janë marrë 29 (njëzet e nëntë) masa administrative ndaj punonjësve të MMRS<sup>76</sup>. Konkretisht:

1. 2 masa “Propozim për largim nga shërbimi civil”.
2. 17 masa “Vërejtje” për shkak të mungesës së paarsyeshme gjatë orarit të punës.
3. 2 masa propozim “largim nga detyra” për punonjës të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, për shkak të angazhimit të tyre në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin, për të cilët masa administrative nuk është zbatuar nga Drejtori i Shërbimit Kombëtar të Punësimit.
4. 1 masë “Largim nga detyra” për shkak të angazhimit në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin.
5. 2 raste propozime për dhënie mase disiplinore për të cilat procedura është në vazhdim.
6. 5 masa “Pezullim nga detyra” deri në përfundim të procedurës të largimit nga detyra.

#### **(5) MINISTERIA E ZHVILLIMIT URBAN**

Në këtë ministri dhe në 5 (pesë) nga 6 (gjashtë) institucionet e saj të varësisë, nuk janë evidentuar raste te denoncimeve të ndryshme të ardhura për përfshirjen e punonjësve të administratës në aktivitet zgjedhor në kundërshtim me ligjin, në zbatim të detyrave të lëna në mbledhjet periodike të Task-Forcës.

Vetëm në njërin nga institucionet e varësisë, konkretisht **ALUIZNI**, janë trajtuar 5 (pesë) raste përfshirjen e punonjësve të administratës në aktivitet zgjedhor në kundërshtim me ligjin. Rastet e referuara janë verifikuar, por ka rezultuar se është e

---

<sup>76</sup> Shih Raporti i Monitorimit të MMRS (ANEKSI III).

pamundur të provohet pretendimi i ngritur në informacionin e referuar. Për rrjedhojë ndaj personave të denoncuar nuk është dhënë asnjë masë administrative.<sup>77</sup>

## **(6) MINISTERIA E MBROJTJES**

Në këtë ministri, në zbatim të detyrave të lëna në mbledhjet periodike të Task-Forcës janë administruar dhe ndjekur 2 (dy) raste të denoncimeve të ndryshme të ardhura për përfshirjen e punonjësve të administratës apo të institucioneve të varësisë në aktivitet zgjedhor në kundërshtim me ligjin.<sup>78</sup> Konkretisht:

- 1 (një) masë disiplinore “lirim nga detyra” dhe “Lirim nga shërbimi aktiv në Forcat e Armatosura rast, ndaj një personeli ushtarak ka marrë pjesë në një tubim elektorale të një subjekti politik.
- 1 (një) rast i referuar nga Zyra e Zëvendëskryeministrit, për një punonjës të Uzinës Mekanike Gramsh i cili gjatë orarit të punës ka përdorur mjete propagandistike në favor të një subjekti politik, është dërguar për verifikim në drejtorinë e uzinës. Sipas informacionit të marrë nga ministria, Këshilli Drejtues i Uzinës Mekanike Gramsh nuk ishte i bindur se punonjësi në fjalë kishte bërë propagandë në interes të subjektit politik dhe arriti në përfundimin se nuk duhej dhënë masë disiplinore.

## **(7) MINISTERIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Në këtë ministri nga monitorimi i situatës zgjedhore dhe veprimtarisë së Policisë së Shtetit gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.06.2017 janë konstatuar një sërë problematikash që lidhen me korrupsionin aktiv në zgjedhje si dhe me veprimet dhe mosveprimet e punonjësve të Policisë së Shtetit në shkelje të ligjit zgjedhor, ligjit për Policinë e Shtetit dhe Kodit Penal. Nga informacioni rezulton se:

Në numrin e telefonit 0694137777 të vendosur në dispozicion të qytetarëve nga MPB kanë mbërritur rreth **484 denoncime** që lidhen me vepra të ndryshme penale. Nga 484 denoncimet e mësipërme, **33 raste** janë denoncime për përfshirje të punonjësve të policisë në procesin zgjedhor si: “Shpërdorim i autoritetit policor” neni 332/a, “Për ndikim në mbështetje të një partie politike ose kandidati”, “Mosushtrimit të funksionit”.

---

<sup>77</sup> Shih Raportin e Ministrisë së Zhvillimit Urban, datë 10. 07.2017, nr. 3930/1, faqe 2 ( **ANEKSI XII**).

<sup>78</sup> Shih Raportin Përfundimtar të Ministrisë së Mbrojtjes nr. 4252/2 prot, datë 10.7.2017 (**ANEKSI VIII**).

Për sa i përket përfshirjes së paligjshme të Policisë së Shtetit në procesin zgjedhor në mbështetje të subjekteve politike, denoncimet i janë përcjellë për ndjekje SHÇBA dhe Policisë së Shtetit. Nga këto, në tre raste ka pasur procedim të mëtejshëm, konkretisht:

1. Arrestuar – një punonjës policie.
2. Liruar nga detyra – dy punonjës të strukturave të MPB nga të cilët një oficer policie dhe një oficer i Gardës së Republikës.
3. Transferuar – një oficer policie.
4. Propozuar për tu transferuar si të përfshirë në shpërdorimin e autoritetit policor – tre drejtues të lartë të Policisë së Shtetit në funksionin e shefit të komisarariatit të Policisë (posaçërisht të Komisariateve të Policisë së Pukës, Gramshit dhe Dibrës). Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka refuzuar pezullimin e tyre.

Për sa i përket abuzimeve nga punonjësit e aparatit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (pa përfshirë Policinë e Shtetit) në shkelje të VKM nr. 473, datë 01.06.2017, ka pasur vetëm një denoncim, i cili është shqyrtuar dhe nuk është provuar.<sup>79</sup>

## **(8) MINISTRIA E DREJTËSISË**

Ministria e Drejtësisë ka trajtuar 23 raste të pjesëmarrjes së punonjësve në fushatë elektorale, dhe pasi janë verifikuar të gjitha rastet, për 11 punonjës ka marrë masë administrative të shkarkimit, me motivacionin e pjesëmarrjes së kundërligjshme në fushatë zgjedhore. Kryesisht, shkarkimet janë ndërmarrë nga Ministri i drejtësisë ndaj drejtorëve të ZRPP-ve në 4 raste, 1 rast të një punonjësi të shërbimit të kontrollit të brendshëm, një rast të një drejtuesi të shërbimit përmbartimor dhe në gjashtë raste të tjera të IEVP-ve. Ndërsa, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve janë marrë 5 masa ‘pezullim nga detyra’ për shkak të pjesëmarrjes në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin.

Konkretisht, për shkak të pjesëmarrjes së kundërligjshme në fushatë apo veprimtari politike, janë shkarkuar:

1. Regjistruesi i ZVRPP Shkodër Z. Edmond Ndou.
2. Kryetari i Zyrës Përmbartimore Gjyqësore Durrës z. Surin Hoxha.
3. Regjistruesi i ZVRPP Durrës Z. Ani Dyrmishi.
4. Regjistruesi i ZVRPP Sarandë Znj. Adriana Shehu.
5. Drejtori i IEVP Fier Z. Jetnor Krakulli.

---

<sup>79</sup> Shih Raportin Përfundimtar të MPB. nr. 5474/1, datë 10.7.2017 (ANEKSI VI).

6. Drejtori i IEVP Lezhë Z. Eduard Kurti.
7. Drejtori i IEVP Rrogozhinë Z. Ahmet Bala.
8. Drejtori i IEVP Tropojë Z. Granit Kurmekaj.
9. Drejtori i IEVP Burrel Z. Fatjon Kurti.
10. Regjistruesi i ZVRPP Berat Z. Ledian Shehu.
11. Drejtori i IEVP Kavajë Z. Durim Perja.

Gjithashtu, për shkak të shkeljes së disiplinës në punë janë shkarkuar gjatë kësaj periudhe 11 punonjës të tjerë të administratës.<sup>80</sup>

## (9) MINISTRIA E BUJQËSISË

Në Ministrinë e Bujqësisë janë raportuar rastet e largimit nga detyra apo të propozimit për pezullim si më poshtë vijon<sup>81</sup>:

1. Z. Ledio Gjyla –Përgjegjës Sektorit Lushnjë, në Bordin Rajonal të Kullimit Fier larguar nga detyra për shkak pjesëmarrje në fushatë elektorale gjatë orarit të punës.
2. Znj. Liljana Hyseni- Përgjegjës Sektori Kolonjë, në Drejtorinë e Bujqësisë Korçë propozuar nga Ministri MBZHRAU për t’u pezulluar nga shërbimi civil. Sipas raportimit të Ministrit përvec ngritjes së komisionit të disiplinës nuk ka informacion tjetër të përcjellur në lidhje me masë administrative të marrë përfundimisht.
3. Z. Pajtim Myrtollari- Specialist i Sektorit të Monitorimit dhe Inspektimit për rrethin Korce pranë Drejtorisë së Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës, i ndaluar nga forcat e Policisë së Shtetit me akuzën e ‘Korrupsionit aktiv në zgjedhje’. Ministri nuk ka raportuar në lidhje me masat administrative të marra ndaj këtij personi.

Në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, në Ministrinë e Integritimit Evropian, në Ministrinë e Mjedisit, në Ministrinë e Kulturës, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe në institucionet e varësisë së saj, dhe nga Ministrat e Shtetit nuk janë raportuar raste të denoncimeve të ndryshme të ardhura për përfshirjen e punonjësve të administratës në aktivitet zgjedhor në kundërshtim me ligjin, në zbatim të detyrave të lëna në mbledhjet periodike të Task-Forcës dhe për rrjedhojë nuk janë raportuar masa administrative të marra. Por, referuar informacioneve që ka në dispozicion zyra e Kryetarit të Task-Forcës, ka rezultuar se:

---

<sup>80</sup> Shih Raportin përfundimtar të MD, faqet 36 e vijues të tij (ANEKSI I).

<sup>81</sup> Shih Raporti Përfundimtar të MBZHRAU (ANEKSI XVI).

**Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes** në raportin përfundimtar të kësaj ministrie<sup>82</sup> nuk është relatuar aspak rasti i shoqërisë së varësisë së saj, Posta Shqiptare sh.a. Konkretisht nuk është relatuar shkarkimi nga ana e ministrit të Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj shoqërie z. Majlind Lazimi, rast i bërë publik edhe në media.

**Ministria e Energjisë dhe Industrisë** në raportin përfundimtar të kësaj ministrie<sup>83</sup> nuk është relatuar aspak rasti i shoqërisë OSHEE, ku punonjësi i OSHEE u filmua duke dhënë para në shkëmbim të votave në qytetin e Vorës, rast i cili u publikua dhe në emisionin investigativ STOP. Në vijim, Administratori i OSHEE e shkarkoi nga detyra.

### **(iii) Masat e pezullimit ndaj punonjësve kandidatë për deputetë**

Lidhur me informacionin e kërkuar për rastet e pezullimeve për shkak të kandidimit në zgjedhje, në referim të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, rezulton se në total informacioni është dhënë nga 10 (dhjetë) ministri. Nga të gjitha Ministrinë dhe institucionet e varësisë së tyre janë relatuar gjithsej 43 (dyzet e tre) raste të pezullimit dhe 3 (tre) raste të shkarkimit nga detyra për efekt të kandidimit në zgjedhje.

Të dhënat në lidhje me kandidatët për deputetë dhe masat e marra ndaj tyre janë paraqitur në formë tabelare në anekset e këtij materiali.<sup>84</sup>

Ndërkohë, Departamenti i Administratës Publike nëpërmjet shkresës nr. 4359/1 prot., datë 07.07.2017 relaton 22 nëpunës civilë të pezulluar për shkak kandidimi si deputetë në listat shumë emërore të subjekteve zgjedhorë, nga të cilët për 9 nëpunës civilë pezullimi është kryer kryesisht nga njësitë e burimeve njerëzore të institucioneve ku punojnë, ndërsa për 13 të tjerë është kërkuar nga vetë nëpunësit.

Diferenca mes raportimeve të ministrive dhe institucioneve të tyre të varësisë dhe DAP mund të shpjegohet se jo të gjithë personat e deklaruar si të pezulluar nga ministrinë janë nëpunës civilë që janë në sferën e kompetencës së DAP, apo me faktin se mund të ketë raste kur nëpunës të ministrive që kanë kandiduar për deputetë, në kundërshtim flagrant me ligjet në fuqi, nuk kanë deklaruar apo kanë deklaruar me vonesë faktin e të qenit kandidat për deputet, duke mos dhënë dorëheqjen nga detyra publike që ushtronin.

<sup>82</sup> Shih Raportin Përfundimtar të MZHETTS nr. 5996/1, datë 10.7.2017 (ANEKSI XI).

<sup>83</sup> Shih Raportin Përfundimtar të MEI (ANKES X).

<sup>84</sup> Shih Tabelën nr. 3 'Masat e pezullimit ndaj punonjësve kandidat për deputet për Ministrinë dhe institucionet e varësisë'.

Rast tipik për të ilustruar këtë fenomen është rasti i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë.<sup>85</sup> Konkretisht:

Ministri i Drejtësisë, në mbështetje të neneve 68, pika 1, 69, pika 1, shkronja “e”, dhe 102, pika 4 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të neneve 63, pika 4 dhe 73, pika 4 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 37 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe pikës 17 të vendimit nr. 473, datë 01.06.2017 të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017”, në cilësinë e titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe eprorit direkt të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, ka urdhëruar pezullimin e Znj. Juliana Hoxha nga detyra e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, deri në përmbushjen e kushtit për heqjen e pezullimit.

Znj. Juliana Hoxha ka ushtruar detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë. Ajo ka pranuar të regjistrohet si kandidate për deputete në listën e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, **e renditur me nr. 24 në Qarkun Tiranë**. Për këtë qëllim, ka paraqitur edhe dokumentacionin e nevojshëm pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe për pasojë **me vendimin nr. 291, datë 07.05.2017 është regjistruar zyrtarisht si kandidate për deputete**.

Ministri, ka vlerësuar se:

*“a) Neni 69, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të qartë përcakton se nuk mund të kandidojnë për deputetë, **pa hequr dorë nga detyra funksionarët e lartë të administratës shtetërore të parashikuar nga ligji**.*

*b) Neni 37, i ligjit nr. 152/2013, parashikon se: “Nëpunësi civil ka të drejtë të kandidojë dhe të zgjidhet në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë apo për organet e qeverisjes vendore. Në këtë rast, **nëpunësi detyrohet të kërkojë pezullimin nga detyra**”.*

*c) Neni 54, pika 1, shkronja “d)” e ligjit nr. 152/2013, parashikon se: “Nëpunësi civil pezullohet nga shërbimi civil në rastin **kur regjistrohet, sipas ligjit, si kandidat për***

---

<sup>85</sup> Shih Raporti i Monitorimit i MD faqe 25-32.

*zgjedhjet vendore apo politike, për periudhën nga regjistrimi deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar apo deri në përfundim të mandatit;”.*

Ligji, pezullimin e lidh me faktin e regjistrimit si kandidat dhe nuk e ka lidhur atë me shprehjen e vullnetit të nëpunësit civil për të kandiduar. Regjistrimi si kandidat për deputet është i lidhur me vendimmarrjen e organit kompetent sipas ligjit, pra Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në këtë kuptim, edhe heqja dorë nga kandidimi, duke të jetë objekt vendimmarrjeje nga organi kompetent dhe duhet të sjellë efektin ligjor të çregjistrimit të kandidatit. Çdo veprim tjetër që nuk sjell efektin ligjor të çregjistrimit, nuk mund të pengojë pezullimin sipas ligjit, për shkak se ky i fundit është i lidhur me situatën juridike të “regjistrimit sipas ligjit si kandidat”. Pra ligji, për efekt të aplikimit të pezullimit, kërkon vetëm verifikimin e faktit juridik të regjistrimit si kandidat. Nga konsultimi me listën e deputetëve të Qarkut të Tiranës, rezulton se Znj. Hoxha vijon të jetë e regjistruar si kandidate për deputete, pavarësisht se formalisht ka hequr dorë nga kandidimi. Mirëpo, që heqja dorë të ketë efekt mbi pezullimin ose jo të nëpunësit civil, duhet që të eliminojë rrethanën që shkakton pezullimin, pra regjistrimin si kandidat.

Në rastin konkret, jo vetëm që heqja dorë nga kandidimi nuk ka prodhuar eliminimin e rrethanës që passjell pezullimin, por nuk është aprovuar as nga organi kompetent sipas ligjit (KQZ). Në këtë kuptim, për sa kohë nuk ka eliminuar shkakun që sipas ligjit sjell pezullimin, atëherë heqja dorë nga kandidimi është pa efekt. Në të kundër, do të ishim përpara një situatë absurdi ligjor, që e lë pa efekt nenin 54/1/d të ligjit nr. 152/2013, për shkak se secili kandidat, pas regjistrimit sipas ligjit, do të bënte një procedurë formale “heqje dorë nga kandidimi”, që nuk do të prodhonte asnjë efekt në drejtim të regjistrimit të tij si kandidat dhe mundësisë potenciale për të fituar mandatin e deputetit, duke penguar në këtë mënyrë pezullimin nga detyra të nëpunësit civil, edhe pse kjo është e detyrueshme sipas ligjit. Kjo është arsyeja se përse ligji, e ka lidhur pezullimin, jo me momentin e kandidimit (që është shprehje vullneti personal i kandidatit), por me regjistrimin e tij si kandidat (që është vendimmarrje e organit kompetent).

Për pasojë, edhe heqja dorë nga kandidimi (që është shprehje vullneti personal i kandidatit) nuk ndikon mbi pezullimin e nëpunësit civil, nëse nuk ka vendimmarrje të organit kompetent për çregjistrimin e kandidatit. Rezulton e provuar që organi kompetent (KQZ) nuk ka marrë asnjë vendimmarrje për çregjistrimin e Znj. Hoxha nga lista e kandidatëve, për shkak se sipas nenit 68 të Kushtetutës, lista e kandidatëve pas regjistrimit është e pandryshueshme. Përkundrazi, KQZ ka informuar Znj. Hoxha me shkresën me nr. 3288/1 prot., datë 23.05.2017, mbi faktin se, referuar nenit 73, pika 4, të Kodit Zgjedhor, kërkesa për t'u

tërhequr si kandidat për deputet nga lista shumë emërore e subjektit politik, nuk mund të aprovohej. Në këto rrethana, pavarësisht se Znj. Hoxha ka hequr dorë nga kandidimi, në rast se subjekti zgjedhor që e kandidon fiton në zgjedhje 24 mandate, atëherë KQZ do t'i jepte mandatin Znj. Hoxha. Vetëm në këtë moment, vullneti i saj është përcaktues, për shkak se nëse heq dorë nga mandati, atëherë nuk mund të marr mandatin e deputetit.

Kushtetuta, në cilësinë e aktit më të lartë ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ka parashikuar jo vetëm të drejtën për t'u zgjedhur (neni 45 i Kushtetutës), por edhe kushtin që e drejta për t'u zgjedhur duhet të shoqërohet me heqjen dorë nga funksioni publik për zyrtarët e parashikuar nga Kushtetuta apo ligji (neni 69 i Kushtetutës). Kjo nënkupton që vetë Znj. Hoxha me vullnet të lirë, kur ka pranuar kandidimin dhe ka dorëzuar deklaratën e kandidimit, duke hequr dorë nga funksioni, ka qenë e ndërgjegjshme për pasojat e pranimit të këtij kandidimi, ku përfshihet edhe pezullimi i menjëhershëm nga detyra. Heqja e pezullimit më pas, sipas ligjit, nuk është e lidhur me heqjen dorë në mënyrë formale nga kandidimi, çka nuk njihet nga legjislacioni në fuqi, por sipas ligjit (pika 1/d, neni 54, ligji nr. 152/2013) është e lidhur me kushtin e “përfundimit dhe shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve apo mandatit”.

Paraqitja e kërkesës së saj për heqjen dorë, vetëm pas datës 07.05.2017 (moment ku është regjistruar në mënyrë përfundimtare lista), ndonëse kishte kohë nga data 28.04.2017 - 07.05.2017 për ta kryer këtë akt, provon se qëllimi nuk është tërheqja nga kandidimi, **por krijimi i rrethanave të rreme për të përfitur në mënyrë të paligjshme vijimin e ushtrimit të detyrës si Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë**. Në këtë rast, Znj. Hoxha nuk mund të përfitojë nga fakti i mos zbatimit prej saj të detyrimit ligjor për t'i kërkuar në mënyrë të rregullt DAP pezullimin nga detyra, apo mos ushtrimit të së drejtës për të hequr dorë, brenda periudhës së lejuar nga ligji (që është periudha nga paraqitja e listës deri në miratimin e saj nga KQZ).

d) Ligji nr. 52/2013 parashikon në nenin 54, pika 3, se konstatimi i pezullimit, për anëtarët e TND-së bëhet nga DAP, me marrjen dijeni për shkakun e pezullimit. Edhe pse ishte në detyrimin e Znj. Hoxha që të kishte njoftuar rregullisht DAP për rrethanën ku ndodhej nga data 07.05.2017, rezulton se një gjë e tillë nuk është kryer në mënyrë të rregullt. Për këtë arsye, Ministri i Drejtësisë i ka kërkuar DAP që të pezullojë nga detyra Sekretaren e Përgjithshme, për shkak se ajo vijon të jetë e regjistruar si kandidate për deputete.

DAP, në përgjigje të shkresës së Ministrisë së Drejtësisë ka evidentuar se: *“Në lidhje me këtë kërkesë, bazuar në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar,*



nenet 37, 54, pika 1, germa “d)”, si edhe VKM nr. 124, datë 17.2.2016 “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, Kreu I, pika 3, **Departamenti i Administratës Publike, si njësi përgjegjëse e ngarkuar nga ligji për të menaxhuar marrëdhënien e shërbimit civil për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues TND, konsideron të bazuar kërkesën, duke qenë se ndodhemi përpara shkaqeve të pezullimit të anëtarit të TND për shkak të ligjit**”. Kjo përgjigje përbën konstatim të faktit të pezullimit, i cili sipas nenit 54, të ligjit nr. 152/2013, është i mjaftueshëm ligjrisht për të urdhëruar pezullimin. Rasti kur për pezullimin kërkohet edhe miratimi i DAP, rregullohet nga neni 55, i ligjit nr. 152/2013, që flet për shkaqe të tjera pezullimi, të cilat nuk aplikohen në këtë rast. Kjo konfirmohet edhe nga përmbajtja e pikës 3, të VKM-së nr. 124/2016, që parashikon se: *Pezullimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkaqet e parashikuara në nenin 54, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, bëhet me konstatimin e shkakut të ligjshëm të pezullimit nga njësi e burimeve njerëzore. Për TND-në, konstatimi i pezullimit bëhet nga DAP-i me marrjen djene për shkakun e pezullimit.*

Në përputhje me VKM nr. 124/2016, Kreu I, pikat 3, 8 dhe 9, DAP ka njoftuar se ka vijuar me nisjen e procedurës së pezullimit të Znj. Hoxha. Mirëpo, gjatë kohës që DAP, duke vijuar me ndjekjen e procedurës ligjore që përcakton vendimi nr. 124/2016 i Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave ka miratuar dhe ka hyrë në fuqi vendimi nr. 473/2017 i Këshillit të Ministrave, i cili në pikën 17 të tij, shprehimisht ngarkon titullarët e Ministrive të marrin masa për pezullimin nga detyra të nëpunësve civilë të institucioneve të tyre, të cilët janë regjistruar si kandidatë për zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 qershor 2017. Në këto kushte, rezulton se sipas ligjit detyrimi i vetëm i titullarit të Ministrisë, është që të presë që konstatimi të bëhet nga DAP për ekzistencën e kushtit të pezullimi. Ky konstatim që buron nga pika 3 e nenit 54 të ligjit nr. 152/2013, është bërë nga DAP me shkresën nr. 3624/1 prot., datë 31.05.2017. Për pasojë, për shkak se jemi përpara dy procedurave të ndryshme, të parashikuara nga dy akte normative me fuqi të njëjtë ligjore (VKM nr. 124/2016 dhe VKM nr. 473/2017), duhet të zbatohet akti nënligjor i cili është miratuar më vonë në kohë. Akti i miratuar më vonë në kohë, është VKM nr. 473/2017, ku specifikohet se: “17. Në zbatim të përcaktimeve të pikës 4, të nenit 63, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 37, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësit civil”, të ndryshuar, **titullarët e ministrive ose drejtuesit e institucioneve të varësisë, marrin masa për pezullimin nga detyra të nëpunësve civil të institucioneve të tyre, të cilët janë regjistruar si kandidatë për zgjedhjet e Kuvendit, të datës 25 qershor 2017.**” Për të qenë në përputhje me

procedurën që përcakton VKM nr. 124/2016, Ministri i Drejtësisë priti vendimmarrjen e DAP, vendimmarrje që duhej të kryhej brenda orës 13:00 të datës 7.06.2017, dy ditë pas seancës dëgjimore që DAP ka njoftuar se do të zhvillonte me Znj. Hoxha. Në kushtet kur kjo vendimmarrje nuk u përcoll pranë Ministrisë së Drejtësisë brenda afatit që përcakton VKM nr. 124/2016 dhe kur VKM nr. 473/2017, ka përparësi mbi VKM nr. 124/2016, sa i përket detyrimit me të cilin ngarkon titullarët e institucioneve për të marrë masa të menjëhershme për pezullimin e nëpunësve që kandidojnë në zgjedhje, si dhe ka ndryshuar procedurën mbi këtë vendimmarrje, ministri i drejtësisë ka vendosur masën e pezullimit nga detyra.<sup>86</sup>

**(iv) Angazhimi si komisionerë në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve të punonjësve të administratës dhe institucioneve të tjera**

Lidhur me numrin e kërkesave të paraqitura nga punonjës të ndryshëm të administratës së ministrive dhe institucioneve të tyre të varësisë për t'u angazhuar si komisionerë apo si numërues gjatë procesit zgjedhor rezulton se ky informacion është dhënë nga 15 (pesëmbëdhjetë) ministri dhe 80 (tetëdhjetë) institucione varësie të tyre.

*Numri i personave që kanë paraqitur kërkesë raportohet në total 504 (pesëqind e katër). Rezulton se lejet nga eprorët për të shërbyer si komisionerë janë dhënë në të gjitha rastet pa vonesë.*

Të dhënat në lidhje me angazhimin si komisionerë në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve të punonjësve të administratës në ministritë dhe institucionet e varësisë është e paraqitur në formë tabelare në anekset e Materialit Përmbledhës.<sup>87</sup>

## **II. Prefektura**

**(i) Lejet vjetore gjatë fushatës zgjedhore**

Lidhur me informacionin e kërkuar për realizimin e lejeve vjetore të punonjësve nga data 25.05.2017- 25.06.2017<sup>88</sup> rezulton se kanë dërguar informacionin e kërkuar të

<sup>86</sup> Shih Raportin Përfundimtar të MD datë 10.07.2017.

<sup>87</sup> **Tabela nr. 4** 'Angazhimi si komisioner në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve të punonjësve të Ministrive dhe institucioneve të varësisë'.

gjitha Prefekturat. Shumica e Prefekturave e kanë pezulluar dhënien e lejeve vjetore të punonjësve duke iu referuar Urdhrit nr. 359 datë 02.06.2017 të Ministrit të Punëve të Brendshme “Për pezullimin e lejeve vjetore të punonjësve të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Institucioneve të varësisë për periudhën 02.06.2017 deri 30.06.2017”.

Nuk i është pezulluar marrja e lejes vjetore punonjësve për arsye shëndetësore/familjare apo kur kanë pasur të planifikuara udhëtime jashtë Shqipërisë. Nga informacioni i dërguar rezulton se gjatë kësaj periudhe kanë qenë me leje vjetore 7 (shtatë) punonjës.

#### **(ii) Masat e marra ndaj nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë civilë për pjesëmarrje në fushatë elektorale**

Pyetjes për marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve të prefekturës për shkelje në fushën e zgjedhjeve<sup>89</sup> rezulton se kanë kthyer përgjigje të gjitha Prefekturat. Sipas informacionit të dërguar rezulton se nuk është konstatuar asnjë shkelje në fushën e zgjedhjeve nga ana e punonjësve të Prefekturave.

#### **(iii) Masat e pezullimit ndaj punonjësve kandidatë për deputetë**

Nga informacioni i dërguar rezulton se nuk ka punonjës të administratës së Prefekturës të pezulluar për shkak kandidimi në zgjedhje për Kuvend 2017. Faktikisht janë liruar nga detyra me Urdhër të Ministrit të Punëve të Brendshme dukë qenë se janë persona të emëruar, Nënprefekti i Lushnjës, Nënprefekti i Kurbinit, Nënprefekti i Peqinit dhe Nënprefekti i Kavajës. Janë liruar me urdhër të Prefektit të Qarkut Tiranë për shkak kandidimi Përgjegjësi i Zyrës së Gjendjes Civile dhe Drejtori i Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë.<sup>90</sup>

Gjithashtu nga informacioni i ardhur nga Prefekturat kanë dhënë dorëheqje nga detyra si Prefekt Qarku ai i Tiranës dhe i Beratit për shkak të regjistrimit si kandidat për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.06.2017. Për të gjitha këto raste lirimi nga detyra është bërë pas kërkesës së kandidatëve për deputet.

<sup>88</sup> Pika nr. 2, Shkresa nr. 3298 prot., datë 07.06.2017 të dërguar nga Zv/Kryeministri të gjitha ministrive.

<sup>89</sup> Pika nr. 5, shkresa nr. 3298 prot., datë 07.06.2017.

<sup>90</sup> Shkresa nr. 3300/5 prot., datë 09.06.2017 e Ministrisë së Punëve të Brendshme, faqe 2.

**(iv) Angazhimi si komisionerë në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve të punonjësve të administratës dhe institucioneve të tjera**

Lidhur me numrin e kërkesave për tu angazhuar si komisionerë pranë KZAZ, KQV dhe GNV dhe rastet e miratimit dhe refuzimit të këtyre kërkesave dhe eventualisht arsytet e refuzimit<sup>91</sup> rezulton se kanë kthyer përgjigje të gjitha Prefekturat. Sipas këtij informacioni kanë kërkuar leje për tu angazhuar si komisionerë dhe i është miratuar kërkesa gjithsej 17 (shtatëmbëdhjetë) punonjësve. Konkretisht kanë depozituar kërkesë dhe i është miratuar ajo në Prefekturën e Qarkut Shkodër 3 (tre), Kukës 2 (dy), Korçë 2 (dy), Gjirokastrë 3 (tre), Durrës 3 (tre), Vlorë 3 (tre) dhe Berat 1 (një) punonjësve.

**III. Bashkitë dhe ndërmarrjet në pronësi të tyre**

**(i) Lejet vjetore gjatë fushatës zgjedhore**

Lidhur me çështjen e lejeve vjetore<sup>92</sup> për punonjësit e Bashkive rezulton se 45 (dyzet e pesë) Bashki kanë kthyer përgjigje. Sipas këtij informacioni 109 (njëqind e nëntë) punonjësve iu është dhënë leje gjatë periudhës zgjedhore.

Në shkresën e dërguar nga ana jonë i është kërkuar Bashkive të tregohet procedura e ndjekur për dhënien e lejeve vjetore për punonjësit duke e shoqëruar me listën emërorë të punonjësve të cilët kanë marrë apo pritet të marrin lejen vjetore. Informacioni i dërguar ka qenë në përgjithësi i shoqëruar vetëm me emrat e punonjësve që kanë dhe priten të marrin leje pa shpjeguar nëse është respektuar procedura për marrjen e lejeve vjetore për punonjësit e administratës shtetërore.

Për Bashkitë Gramsh, Peqin, Bulqizë, Krujë dhe Vau i Dejës nga informacioni që ka ardhur pranë Task-Forcës rezulton se është pezulluar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë dhënia e lejet vjetore për periudhën zgjedhore.

Nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje 16 (gjashtëmbëdhjetë) Bashki, konkretisht Bashkitë Korçë, Libohovë, Kolonjë, Has, Këlcyrë, Tiranë, Rrogozhinë, Librazhd, Finiq, Dibër, Vlorë, Kavajë, Berat, Mat, Selenicë dhe Shkodër.

<sup>91</sup> Shkresa nr. 3372 prot., datë 12.06.2017.

<sup>92</sup> Pika nr. 2, shkresa nr. 3297 prot., datë 07.06.2017.

Për sa i përket ndërmarrjeve të cilat janë në pronësi të Bashkive është dërguar informacion nga 15 (pesëmbëdhjetë) institucione ku në total kanë marrë lejen vjetore 21 (njëzet e një) punonjës:

- kanë pezulluar lejet vjetore të punonjësve me Urdhër të titullarit të Institucionit, Ujësjiellësi i Kuçovës, Ndërkomunale Bushat dhe Ujësjiellësi i Vau Dejës.
- kanë qenë me leje vjetore 12 (dymbëdhjetë) punonjës në Ujësjiellësin e Durrësit, 6 (gjashtë) punonjës në Ujësjiellësin e Elbasanit, 2 (dy) punonjës të Ujësjiellësit Fshat Elbasan dhe 1 (një) punonjës në Ujësjiellësin e Tepelenës.

**(ii) Masat e marra ndaj nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë civilë për pjesëmarrje në fushatë elektorale**

Lidhur me çështjen e masave administrative për pjesëmarrjen në fushatë elektorale të punonjësve<sup>93</sup> rezulton se 45 (dyzet e pesë) Bashki kanë kthyer përgjigje. Kanë marrë masa disiplinore ndaj punonjësve për pjesëmarrje në fushatë elektorale gjatë orarit të punës Bashkia Skrapar 2 (dy) largime nga detyra dhe ka pezulluar 1 (një) punonjës. Ndërsa në Bashkinë Krujë është rasti i largimit të një punonjësi për shkak se vëllai i tij ishte kandidat për deputet të një force politike të ndryshme nga forca politike e kryetarit të kësaj bashkie. Këto dy Bashki janë të vetmet të cilat e kanë cituar në informacionin e dërguar arsyen e largimit të këtyre punonjësve.

Nuk kanë kthyer përgjigje Bashkitë: Divjakë, Gramsh, Mirditë, Himarë, Libohovë, Has, Tiranë, Finiq, Patos, Përrenjas, Kavajë, Mat, Klos, Përmet, Kamëz dhe Dropull.

Duhet të theksojmë se pyetjes lidhur me masat disiplinore për shkeljet e punonjësve të administratës shtetërore në fushatën zgjedhore informacioni i dërguar nga Bashkitë ka qenë jo i saktë dhe duke mos iu përmbytur pyetjes. Kjo pasi largimet nga puna edhe pse kanë qenë për shkaqe të tjera janë raportuar si largime që kanë lidhje me fushatën zgjedhore.

*Lidhur me këtë pyetje kanë dërguar informacion 17 (shtatëmbëdhjetë) ndërmarrje në pronësi të Bashkive për të cilat rezulton se nuk është marrë*

<sup>93</sup> Pika nr. 5, shkresa nr. 3297 prot., datë 07.06.2017.

*masë disiplinorë ndaj punonjësve të institucioneve të tyre për raste shkeljeje në fushën e zgjedhjeve.*

### **(iii) Masat e pezullimit ndaj punonjësve kandidatë për deputetë**

Për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.06.2017 rezulton që 14 punonjës të Bashkive kanë qenë të regjistruar si kandidat për deputet dhe konkretisht në Bashkinë Shkodër tre (3), Elbasan shtatë (7) Përrenjas një (1), Vlorë një (1), Krujë një (1) dhe Cërrik një (1) punonjës.

Sipas informacionit të ardhur nga këto Bashki rezulton që 12 punonjës janë pezulluar dhe 2 punonjës janë larguar për shkak të regjistrimit si kandidat në listat shumë emërore për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.06.2017.

Të dhënat në lidhje me punonjësit e administratës, kandidatë për deputetë dhe masat marra ndaj tyre janë të paraqitura në formë tabelare.<sup>94</sup>

### **(iv) Angazhimi si komisionerë në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve të punonjësve të administratës dhe institucioneve të tjera**

Për sa i përket pyetjes së rasteve kur punonjësit kanë bërë kërkesë për tu angazhuar si komisionerë në KZAZ, GNV dhe KQV<sup>95</sup> rezulton që kanë sjellë informacion 40 (dyzet) Bashki. Sipas këtij informacioni rezulton që për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.06.2017 kanë kërkuar leje për të qenë komisioner 359 (treqind e pesëdhjetë e nëntë) punonjës. Të gjitha kërkesat janë miratuar nga titullaret e Bashkive.

Nuk kanë dërguar informacion për këtë çështje Bashkitë: Sarandë, Poliçan, Roskovec, Konispol, Mirditë, Fushë Arrëz, Libohovë, Delvinë, Skrapar, Has, Këlcyrë, Tiranë, Rrogozhinë, Gjirokastër, Berat, Kavajë, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Selenicë, Përmet dhe Kamzë.

Nga ndërmarrjet në pronësi të Bashkive lidhur me kërkesat për komisioner ka dërguar informacion vetëm Ujësjiellësi Kuçovë, ku informon se është depozituar vetëm një kërkesë për komisioner e cila është miratuar nga titullari i Institucionit.

<sup>94</sup> Shih **Tabela nr. 1**

<sup>95</sup> Shkresa nr. 3374 prot. datë 12.06.2017.

Të dhenat në lidhje me angazhimin si komisionerë apo numërues janë të paraqitura në formë tabelare në anekset e Materialit Përmbledhës.<sup>96</sup>

## **E. Punësimet, largimet, transferimet dhe lëvizjet paralele gjatë fushatës elektorale**

### ***I. Ministrinë, Institucionet e Varësisë, Entet Publike dhe shoqëritë shtetërore***

Lidhur me informacionin e kërkuar mbi numrin e kontratave të reja të punës (apo emërimet të reja në administratë), largimet, transferimet dhe lëvizjet paralele në ministrinë dhe institucionet e tyre të varësisë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, në respekt të parashikimeve të nenit 88 të Kodit Zgjedhor rezultojnë se në total ky informacion është dhënë nga 12 (dymbëdhjetë) ministri dhe 93 (nëntë dhjetë e tre) institucione varësie. Nga të gjitha ministrinë dhe institucionet e varësisë së tyre janë raportuar gjithsej 316 (treqind e gjashtëmbëdhjetë) raste të rekrutimeve të reja në administratë, përfshirë pozicione të përkohshme.

Përgjithësisht informacioni nuk është dhënë i qartë për të gjitha rubrikat e kërkuara. Ai është dhënë në mënyrë të pjesshme dhe shpeshherë janë përfshirë edhe largimet nga detyra për shkaqe si mbushja e moshës së daljes në pension, dorëheqja nga vetë punonjësi, etj.

Nga informacioni i ardhur dhe i përpunuar rezultojnë se në total nga ministrinë dhe institucionet e varësisë së tyre janë larguar nga detyra 32 (tridhjetë e dy) punonjës, janë transferuar 53 (pesëdhjetë e tre) punonjës dhe janë pezulluar 22 (njëzet e dy) punonjës.

Referuar Tabelës nr. 4 ‘Punësime të bëra gjatë fushatës elektorale në Ministri dhe Institucione të varësisë’, referuar vetdeklarimit nga institucionet rezultojnë se gjatë fushatës elektorale në Ministrinë dhe institucionet e varësisë janë punësuar 356 persona, ndërkohë që të dhënat nga DPT tregojnë një numër prej 1098 të punësuarish gjatë kësaj periudhe.

<sup>96</sup> Shih Tabela nr. 1

**Ministria e Drejtësisë** dhe institucionet e varësisë së saj janë larguar nga detyra 11 punonjës për shkak të masave disiplinore të marra, përveç numrit të të larguarve apo pezulluarve si rezultat i përfshirjes në fushatë elektorale në kundërshtim me ligjin. Numri i punësimeve gjatë fushatës elektorale, ka qenë 62. 11 punonjës janë punësuar në aparatën e MD, ku janë përfshirë 9 persona në funksione këshilltarë të , sekretar të ministrit në kuadër të ndryshimeve në qeveri. Vihet re një numër i madh punësimesh gjatë kësaj periudhe në ATP (40 persona), të cilët janë justifikuar me ngarkesën e punës në Agjenci, gjë e cila nuk është provuar. Punësimet e tjera kanë qenë në ZRPP dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

**Ministrina e Shëndetësisë** dhe institucionet e varësisë së saj janë larguar nga detyra 4 punonjës, janë pezulluar 8 punonjës dhe janë transferuar 16 punonjës. Nga këta 2 janë larguar dhe 8 të tjerët janë pezulluar për shkak të pjesëmarrjes në fushatë elektorale në kundërshtim me ligjin. Ndërkohë janë punësuar 36 persona, nga të cilat 22 në QSUT, por që nuk tregohen shkaqet për të cilat janë realizuar punësimet gjatë kësaj periudhe. Në MSH janë punësuar 6 persona, të cilat kanë lidhje me ndryshimet në Qeveri që janë pasuar dhe me ndryshimet në kabinetin e ministrit.

**Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë** dhe në institucionet e saj të varësisë janë larguar nga detyra 3 punonjës, janë pezulluar 5 punonjës dhe janë transferuar 2 punonjës, nga të cilët 5 janë të pezulluar dhe një i larguar për shka të pjesëmarrjes në fushatë në kundërshtim me ligjin. Ndërkohë gjatë fushatës lektorale, nga deklaratimet e MMSR janë punësuar 12 persona, nga të cilët 7 i përkasin kabinetit të ministrit dhe sekretareve referuar ndryshimeve më të fundit të qeveri, ndërsa punësimet e tjera janë në Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe në Shërbimin Social Shtetëror.<sup>97</sup>

**Ministria e Punëve të Brendshme** dhe institucionet e saj të varësisë janë larguar nga detyra 3 punonjës, është pezulluar 1 (një) punonjës dhe janë transferuar 23 punonjës. Gjatë kësaj periudhe rezultoi të jenë punësuar 83 persona, nga të cilët 60 persona në Qendrën e Pushimit të MPB, ku justifikimi është për ngarkesë pune në sezonin e verës, por që nuk është provuar kushtet e emergjencës referuar numrit. 8 persona i përkasin aparatit të MPB, duke reflektuar ndryshimet në kabinetin e ministrit si rezultat i ndryshimeve në qeveri.

**Ministria e Financave** dhe institucionet e varësisë (konkretisht në DPT) janë larguar nga puna 2 punonjës në dhe janë pezulluar 3 punonjës. Numri i punësimeve në këtë

---

<sup>97</sup> Shih Tabela nr. 4



Ministri 39, nga të cilët 13 i përkasin aparatit të MF, ku përfshihen ndryshimet në kabinetin e Ministrit si rezultat i ndryshimeve në kabinetin qeveritar. Në DPT rezulton të jenë punësuar 20 persona, por nuk jepen sqarime për kushtet emergjencës që kanë diktuar këto punësime.

**Ministria e Arsimit dhe Sportit** dhe institucionet e saj të varësisë është pezulluar nga detyra 1 (një) punonjës. Gjatë kësaj periudhe janë punësuar 11 persona, nga të cilët 8 i përkasin ndryshimeve në kabinetin e ministrit, ndërsa i përkasin punësimeve në DAR Vlorë, ku nuk tregohen kushtet e emergjencës për të realizuar këto punësime.

**Ministria e Mbrojtjes** dhe institucionet e varësisë së saj kanë raportuar vetëm 1 (një) rast largimi nga puna, ndërkohë që janë 14 punësime të justifikuara për nevoja operacionale.

**Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave** dhe institucionet e varësisë së saj kanë pezulluar 2 punonjës dhe janë transferuar 4 punonjës. Ndërkohë janë deklaruar 19 punësime, ku nga këto 8 janë në Qendrën e Transferimit të Teknologjive në Vlorë dhe 6 në Drejtorinë e VBujqësisë Vlorë. Në asnjë rast nuk tregohen kushtet e emergjencës për realizimin e këtyre punësimeve.<sup>98</sup>

**Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit dhe Sipërmarrjes** dhe institucionet e saj të varësisë, janë raportuar vetëm 2 punonjës të transferuar. Ndërkohë gjatë kësaj periudhe janë deklaruar 6 persona të punësuar gjatë fushatës elektorale, ku 5 nga këta janë emëruar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metereologjisë, ku nuk tregohen kushtet e emergjencës referuar nenit 88 të Kodit Zgjedhor.

**Ministria e Transporteve dhe Infrastrukturës** ka deklaruar 11 persona të punësuar gjatë fushatës elektirale, ku 7 nga ata i përkasin Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, ndërsa 4 të tjerë Nd.Kontrollit të Shërbimeve Mjeteve Ujore. Në asnjë rast nuk janë justifikuar kushtet e emergjencës referuar nenit 88 të Kodit Zgjedhor.

**Ministria e Punëve të Jashtme** ka raportuar 11 punësime në aparatit e MPJ, ku nuk tregohen kushtet e emergjencës referuar nenit 88 të Kodit Zgjedhor.

---

<sup>98</sup> Po aty.

**Ministria e Zhvillimit Urban** ka raportuar 43 raste të punësimeve gjatë fushatës elektorale, nga të cilat 20 i përkasin aparatit të ministrisë dhe 15 ALUIZNI, ku nuk tregohen kushtet e emergjencës referuar nenit 88 të Kodit Zgjedhor.

**OSHEE** ka raportuar se janë larguar nga puna 2 punonjës dhe janë pezulluar 2 punonjës.

Sipas informacion të përcjellë nga Administratori i OSHEE Z. Mustafa, është konstatuar një numër mjaft i madh i rasteve të rekrutimeve të reja të punonjësve nga OSHEE sh.a., sipas informacionit të dhënë nga Administratori i kësaj shoqërie, Këshilli Mbikëqyrës i OSHEE sh.a. me vendimin nr.18, datë 15.05.2017 ka vendosur miratimin e një shtese fuqie punëtore të shoqërisë me 400 (katërqind) punonjës, duke filluar nga muaji prill 2017 deri në përfundim të vitit 2017. Në fakt këto punësime është vendosur të bëhen mbi numrin e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Sipas VKM për strukturën e OSHEE sh.a., numri total i punonjësve të shoqërisë është 6.331, ndërkohë që gjendja aktuale e punonjësve është 6.664. Pra, megjithë faktin që VKM e mësipërme kishte përcaktuar numrin tavan të punonjësve, nga ana e shoqërisë, në kundërshtim të hapur me VKM në fjalë dhe madje edhe pa vendim të Këshillit Mbikëqyrës, janë punësuar 330 punonjës të rinj duke filluar nga muaji shkurt 2017, praktikisht edhe më parë në kohë se Këshilli Mbikëqyrës të merrte vendim për rekrutime të reja. Praktikisht Këshilli mbikëqyrës i OSHEE sh.a. me vendimin e tij nr. 18, datë 15.5.2017, duke i dhënë vendimit në fjalë fuqi prapavepruese, është munduar të “ligjërojë” një situatë të paligjshme për sa i përket punësimeve të 330 (treqind e tridhjetë) punonjësve të bëra nga muaji shkurt 2017 deri më sot.<sup>99</sup>

Pavarësisht vetdeklarimeve të ministrive apo institucioneve të tyre të varësisë, entet publike apo shoqëritë shtetërore, referuar denoncimeve nga ana e qytetarëve apo subjekteve elektorale në zyrën e Zv/ Kryeministrit ka rezultuar se të dhënat e përcjella nuk ka qenë të sakta.

Kështu, një nga rastet që nuk është relatuar në lidhje me punësime, largime është ai i shoqërisë së varësisë Posta Shqiptare sha ku, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, nga data 25.5.2017 deri në ditën e zgjedhjeve, në këtë shoqëri janë bërë lëvizje masive të pajustificuara të punonjësve të shoqërisë në qendër dhe në filialet e saj në rrethe. Ky rast është evidentuar nga zyra e Zëvendëskryeministrit të cilës i është

---

<sup>99</sup> Shih shkresën nr. 16264/1, datë 24.6.2017 të Administratorit të OSHEE dhe informacionet bashkëlidhur.

përcjellë informacioni i shoqëruar me fotografi te shkresave përkatëse për lëvizjen nga detyra të mbi 30 (tridhjetë) punonjësve.

Nga ana e Zëvendëskryeministrit i është kërkuar zyrtarisht ministres së linjës (MZHETTS) Znj. Milva Ekonomi dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare<sup>100</sup>, ndërhyrja e menjëhershme për marrjen e masave të nevojshme për rikthimin e ligjshmërisë në këtë shoqëri publike duke pezulluar menjëherë këtë veprimtari dhe duke revokuar të gjithë urdhrat apo vendimet për marrjet në punë, pushimet nga puna, lirimet, lëvizjes dhe transferimit në detyrë të punonjësve, për periudhën nga data 25.5.2017. Asnjë veprim i tillë nuk rezultoi të ishte bërë. Rezulton që MZHETTS nuk i ka raportuar këto raste, pavarësisht se është e provuar katërcipërisht. Nga Zëvendëskryeministri rasti është referuar në organin e prokurorisë së Rrethit Tiranë.<sup>101</sup>

Po ashtu rezulton që të mos jenë relatuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë rastet e punësimit dhe shkarkimet në shoqëritë e varësisë Albpetrol sh.a. dhe OSHEE. Në lidhje me punësimet masive të bëra nga shoqëria Albpetrol sh.a. gjatë periudhës së fushatës zgjedhore nga ana e Zëvendëskryeministrit është bërë referim në organin e prokurorisë.<sup>102</sup>

## **II. Prefektura**

Lidhur me pyetjen për rastet e ndryshimit të strukturës organike që prekin numrin e punonjësve të institucionit nga data 01.01.2017 deri në muajin Qershor 2017<sup>103</sup> rezulton se janë përgjigjur 7 (shtatë) nga 12 (dymbëdhjetë) Prefektura. Sipas këtij informacioni rezulton që nuk ka pasur ndryshime në strukturën organike të këtyre institucioneve për periudhën Janar – Qershor 2017. Nuk kanë kthyer përgjigje lidhur me këtë çështje Prefektura e Qarkut Tiranë, Dibër, Durrës, Shkodër dhe Berat.

Lidhur me emërimet, lëvizjet apo transferimet e bëra pas datës 25.05.2017 deri në ditën e zgjedhjeve<sup>104</sup> rezulton se i janë përgjigjur të gjitha Prefekturat e vendit. Sipas këtij informacioni rezulton që gjatë periudhës zgjedhore Prefektura e Qarkut Lezhë ka bërë 3 (tre) emërimet punonjësish të rinj, Prefektura e Qarkut Durrës ka bërë 1 (një)

<sup>100</sup> Shih shkresën nr. 3557 prot., datë 22.06.2017.

<sup>101</sup> Shih shkresën nr. 3560, datë 22.6.2017.

<sup>102</sup> Shih shkresat nr. 3544, datë 21.06.2017 dhe nr. 3544/1, datë 22.06.2017 të Zëvendëskryeministrit.

<sup>103</sup> Pika nr. 3, shkresa nr. 3472 prot., datë 16.06.2017.

<sup>104</sup> Pika nr. 4, shkresa nr. 3472 prot., datë 16.06.2017.

emërim punonjësi të ri, Shkodër emëruar një punonjës i ri dhe është transferuar një punonjës, Fier emëruar në detyrë një punonjës të ri. Duhet thënë se në përgjigjet e ardhura nga këto prefektura, nuk citohet dhe nuk justifikohet që këto emërim të jenë bërë në kushtet e emergjencës. Në total janë bërë 6 (gjashtë) punësime të reja si dhe një transferim.

### **III. Bashkitë dhe ndërmarrjet në pronësi të tyre**

Në lidhje me punësimet, largimet, transferimet dhe lëvizjet paralele gjatë fushatës elektorale deri në ditën e zgjedhjeve rezulton se 53 Bashki kanë sjellë informacion pranë Task-Forcës. Nga informacioni i përpunuar rezulton se për periudhën zgjedhore janë bërë në total 298 (dyqind e nëntëdhjetë e tetë) emërimet punonjësish rishtazi. **Bashkitë kanë pohuar që këto emërimet nuk janë bërë në kushtet e emergjencës.** Është shumë e qartë që këto lëvizje në administratë kanë ardhur si rezultat i përdorimit të burimeve njerëzore për qëllime elektorale. **Mjafton të përmendim një rast sipas të cilit është kërkuar shtesë personeli për këtë periudhë vetëm për arsyen që ndërtesa e Bashkisë është me 4 kate dhe nuk mund të kontrollohet e gjithë ndërtesa me personelin aktual.**<sup>105</sup>

Bashkitë Sarandë, Divjakë, Mirditë, Has, Tiranë, Finiq, Kavajë, Klos dhe Kamzë **nuk kanë sjellë informacion për këtë çështje.**

Për sa i përket zgjidhjes së kontratave të punës me punonjësit kanë sjellë informacion 44 Bashki, sipas të cilave janë bërë 47 zgjidhje të marrëdhënieve të punës. Sipas këtij informacioni nuk specifikohet arsyet përse janë zgjidhur këto kontrata pune. Gjithashtu rezulton që janë kryer dhe 15 transferime të brendshme, pa specifikuar arsyet se përse janë bërë këto transferime.

Gjithsesi, situata e punësimeve, shkarkimeve nuk është ajo që duket për sa kohë nga monitorimi i bërë drejtpërdrejtë nga Zyra e Zëvendëskryeministrit ka rezultuar se në ndërmarrjet në pronësi të disa Bashkive të monitoruara si Tiranë, Durrës ekzistojnë raste të punësimeve dhe shkarkimeve gjatë fushatës elektorale. Referuar edhe

<sup>105</sup> Shkresa e Bashkisë Poliçan, nr. 3373 prot., datë 16.06.2017.

informacionit të përcjellë nga DPT, rezulton se ky numër është shumë më i madh se ai që rezulton sipas monitorimit të kryer përmes pyetësorit.

#### ***IV. Trajtimi i rasteve të tilla nga Zyra e Zëvendëskryeministrit (neni 88(3) i Kodit Zgjedhor)***

Zyra e Zëvendëskryeministrit gjatë ushtrimit të detyrës në periudhën 01.6.2017 deri në 24.06.2017 ka marrë njoftime të ndryshme nga subjektet zgjedhore për punësime me qëllime elektorale në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor.

Nisur nga këto të dhëna zyra e Zëvendëskryeministrit, edhe pse në një kohë të shkurtër, ka kryer disa verifikime në institucione të ndryshme siç ishte rasti i shoqërisë së Ujësjiellës Kanalizime Durrës, Hekurudhës Shqiptare, Albpetrol sh.a. Posta Shqiptare sh.a, Ujësjiellës Kanalizime Tiranë etj.

Përveç verifikimeve pranë institucioneve të mësipërme, për të kryqëzuar të dhënat e mbledhura, është kërkuar informacion dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për **punësimet e bëra rishtazi dhe largimet nga puna për periudhën zgjedhore**, për këto institucione dhe institucione të tjera shtetërore. Sipas këtij informacioni rezulton që për periudhën 25.05.2017 deri në datën 23.06.2017, në të gjithë administratën shtetërore, janë **punësuar rishtazi dhe larguar nga puna 3617 shtetas**. Megjithatë këto të dhëna nga DPT, dyshohet që nuk janë të sakta, pasi në të nuk përfshihen të gjitha shoqëritë aksionare me kapital shtetëror.

Nga verifikimet e kryera nga kabineti i Zëvendëskryeministrit ka rezultuar që:

- Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Durrës ka bërë punësime në periudhë zgjedhore në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor.<sup>106</sup>
- Hekurudha Shqiptare sh.a. ka bërë punësime në periudhë zgjedhore në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor.<sup>107</sup>
- Albpetrol sh.a. ka bërë punësime në periudhë zgjedhore në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor.<sup>108</sup>
- Posta Shqiptare sh.a. ka bërë punësime në periudhë zgjedhore në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor.<sup>109</sup>

<sup>106</sup> Denoncim i bërë nga subjekti elektorale PD.

<sup>107</sup> Denoncim i bërë nga subjekti elektorale PD.

<sup>108</sup> Denoncim i bërë nga subjekti elektorale PD.

<sup>109</sup> Denoncim i bërë nga subjekti elektorale LSI.

- Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Tiranë ka bërë punësime në periudhë zgjedhore në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor.<sup>110</sup>

Për të gjitha këto raste është kërkuar marrja e masave administrative nga titullarët e institucioneve, por që në asnjë rast nuk është konfirmuar nisja e një procedure administrative. Në këto institucione janë punësuar me qindra shtetas gjatë periudhës zgjedhore, siç është rasti i Albpetrol sh.a. me rreth 170 të punësuar rishtazi etj. Të gjitha punësimet e bëra në këto institucione rezultojnë që nuk janë për raste emergjencash dhe dyshohet që ashtu si në rastin e Bashkive të përmendura më lart këto lëvizje në administratë kanë ardhur si rezultat i përdorimit të burimeve njerëzore për qëllime elektorale.

Nga një analizë e tabelës së të dhënave rezulton MAS dhe Institucionet e varësisë kanë 67 punësime dhe 484 largime; MSH dhe institucionet e varësisë kanë 321 punësime dhe 245 largime; Ministria e Energjisë dhe institucionet e varësisë kanë 168 punësime dhe 25 largime; Ministria Brendshme dhe institucionet e varësisë kanë 102 punësime dhe 277 largime; Ministria e Mbrojtjes 67 punësime dhe 83 largime; Bashkitë dhe institucionet e varësisë kanë 310 punësime dhe 233 largime, etj.

Nga analiza e bërë rezulton që këto lëvizje gjatë fushatë elektorale janë bërë në institucionet e varësisë, dhe me shumë mundësi ky informacion nuk është vënë në dijeni të Ministrive përkatëse. Ky informacion është në kundërshtim me vetë informacionet e Ministrive dhe institucioneve të varësisë, të cilat janë në formën e vetë-deklarimit dhe vënë në dyshim dhe pjesën tjetër të informacionit të përcjellë gjatë këtij procesi monitorimi.

**Vlen të theksojmë që të gjitha këto raste duke përfshirë dhe të dhënat e marra në DPT, Task-Forca i ka përcjellë për vlerësim dhe hetim të mëtejshëm pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe rezulton që akoma shkresa për rkatë se që përmban materialin kallëzues nuk është përcjellur nga protokollin e Kryeministrit në Prokurorinë e Përgjithshme.**

## **F. Përdorimi i burimeve financiare dhe logjistike të shtetit gjatë procesit zgjedhor**

<sup>110</sup> Denoncim i bërë nga subjekti elektorale LSI.

**I. Ministrinë, Institucionet e Varësisë, Entet Publike dhe shoqëritë shtetërore**

**(i) Shpenzimet e programuara dhe faktike gjatë procesit zgjedhor**

Lidhur me informacionin për programimin analitik të buxhetit dhe përdorimin e buxhetit jashtë zërave të programit analitik të vitit 2017 duhet theksuar se ky informacion në shumë raste është dërguar i paqartë dhe i papërpunuar. Shumë ministri dhe institucione të varësisë së tyre janë mjaftuar duke sjellë tabela me të dhënat e shpenzimeve të bëra dhe të programuara sipas zërave të ndryshëm pa dhënë detaje dhe pa iu përgjigjur pyetjes në mënyrë të drejtpërdrejtë. 3 (tre) ministri nuk e kanë dhënë aspak informacionin e kërkuar, duke përjashtuar këtu ministrat pa portofol. Për sa i përket institucioneve të varësisë rezulton se informacioni është sjellë vetëm nga 50 (pesëdhjetë) institucione nga 173 (njëqind e shtatëdhjetë e tre) të identifikuar dhe në këto raste përgjigjet janë gjithashtu të paqarta. Në ministrinë të cilat kanë sjellë të dhëna, rezulton se përgjithësisht nuk është relatuar ndonjë problematikë në këtë pikë, me përjashtim të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave.

**Ministria e Drejtësisë (MD)** raporton përdorimin e procedurave të prokurimit për fushatë zgjedhore në të paktën 3 raste. Ministria e Drejtësisë ka prokuruar dhe lidhur kontrata, duke marrë përsipër detyrime në vlera disa herë më të larta se parashikimet buxhetore për vitin 2017. Konkretisht:

**(I) PROJEKTI: SISTEMI I MENAXHIMIT ELEKTRONIK TË SHËRBIMIT PËRMBARIMOR (ALBIS)**

- Fondi i parashikuar në Buxhetin e vitit 2017 sipas shkresës nr. 17911/268 prot., datë 31.01.2017 të Ministrisë së Financave - **15.000.000 lekë**
- Urdhër Prokurimi nr. 7260/60 datë 05.12.2016, fondi limit - 67.136.000 Lekë
- Vlera e kontratës së lidhur me nr. 7260/13 Prot., datë 09.02.2017 - **67.080.000 lekë**
- Shuma e detyrimit për vitin 2017 sipas kontratës – **60.930.000 lekë**.
- Shuma e likuiduar deri në datë 30.06.2017, 15.000.000 lekë.
- **Detyrim i krijuar rishtas për vitin 2017 për mungesë planifikimi në Buxhet 45.930.000 lekë.**

**(II) PROJEKTI: SISTEMI I MBIKQYRJES ELEKTRONIKE NË FUSHËN PENALE**

- Fondi i parashikuar në Buxhetin e vitit 2017 sipas shkresës nr. 17911/268 prot., datë 31.01.2017 të Ministrisë së Financave – **150.000.000 lekë.**
- Urdhër Prokurimi nr. 8383/4, datë 29.12.2016, fondi limit 235.255.999 Lekë.
- Vlera e kontratës së lidhur me nr. 8383/10 Prot., datë 21.02.2017 - **233.952.000 lekë.**
- Shuma e detyrimit për vitin 2017 sipas kontratës **223.952.000 lekë.**
- Shuma e likuiduar deri në datë 30.06.2017 - 150.000.000 lekë.
- **Detyrim i krijuar rishtas për vitin 2017 për mungesë planifikimi në Buxhet 73.952.000 lekë.**

### **(III) PROJEKTI: SISTEMI ELEKTRONIK PËR MENAXHIMIN E SIGURIMIN E FUNKSIONALITETIT DHE IMPLEMENTIMI I "HIGH AVAILABILITY" PËR INFRASTRUKTURËN QENDRORE TË SISTEMEVE IT NË MINISTRINË E DREJTËSISË**

- Fondi i parashikuar në Buxhetin e vitit 2017 sipas shkresës nr. 17911/268 prot., datë 31.01.2017 të Ministrisë së Financave – **21.000.000 lekë.**
- Urdhër Prokurimi nr. 855/2, datë 8.02.2017, fondi limit 33.485.120 Lekë.
- Vlera e kontratës së lidhur me nr. 855/8 prot., datë 26.04.2017 – **33.433.200 lekë.**
- Shuma e detyrimit për vitin 2017 sipas kontratës **21.182.400 lekë.**
- Shuma e likuiduar deri në datë 30.06.2017 - 0 lekë.
- **Detyrim i krijuar rishtas për vitin 2017 për mungesë buxheti 182.400 lekë.**

Dy nga tre procedurat e mësipërme të prokurimit janë fituar nga bashkimi i operatorëve “Soft Solution” sh.p.k. dhe “Fastech” sh.p.k. Për këto dy kompani, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, ka prokuruar dhe lidhur kontrata në vlerë totale më shumë se vlera e parashikuar dhe miratuar nga Buxheti i Shtetit në masën 119.882.000 lekë. E gjithë kjo shumë e kontraktuar, mbi parashikimet në Buxhet, është aktualisht borxh i akumuluar vetëm për 6 muajt e parë të vitit 2017.<sup>111</sup>

**Ministria e Financave** pas analizimit të të gjithë treguesve analitikë fiskalë për shpenzimet qeveritare nga specialistët përkatës u vu re se ne **shpenzimet kapitale (investime) ka një rritje shumë të madhe në krahasim me vitin 2016**, me rreth 9 miliard lekë (65 milion Euro).

<sup>111</sup> Shih Raportin Përfundimtar të MD faqe 16 dhe 17.



Rritja më e madhe, rreth 7 miliardë është me financime të brendshme. Nga te dhënat nuk mund të nxirren konkluzione se në cilat vepra janë bërë investimet, por **vërehet se shpenzimet për investime janë në vlera më të larta në muajt mars, prill e maj, që përkojnë me periudhën e prag fushatës dhe të fushatës zgjedhore**, kur janë planifikuar rreth 13 miliardë lekë, ose rreth 90% e shpenzimeve për investime të 5 mujorit të planifikuara me burime të brendshme.<sup>112</sup>

## **(ii) Konsumi mujor i karburantit**

Lidhur me informacionin për konsumin mujor të karburantit duke filluar nga data 01.01.2017 rezultojnë se janë përgjigjur 11 (njëmbëdhjetë) ministri. Në analizë të informacioneve të sjella, rezultojnë se përgjithësisht konsumi i karburantit është në nivelin mesatar të përgjithshëm, pra është konstant.

Është për tu evidentuar rasti i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ku për periudhën janar - maj 2017, sasia e karburantit të konsumuar është në total 14.491 litra, nga të cilat 7.500 litra janë konsumuar vetëm nga ministri, ndërkohë që administrata ka konsumuar 5.791 litra, ndërsa për kaldajën janë harxhuar 1.200 Litra.

Për sa i përket institucioneve të varësisë, kanë dhënë informacion vetëm 57 (pesëdhjetë e shtatë) institucione, në të cilat gjithashtu raportohet një ecuri normale të harxhimit të karburantit.

## **(iii) Përdorimi i aseteve**

Ka disa raste të raportuara nga disa ministri në raportet përfundimtare të monitorimit sipas VKM 473/2017, për përdorimin nga administrata shtetërore të aseteve publike për qëllime elektorale. Këto raste janë të konstatuara kryesisht nga stafi i ministrave, por në kushtet e mungesës së infrastrukturës së nevojshme për kontrolle të vazhdueshme apo të mungesës së bashkëpunimit nga punonjësit civilë dhe drejtues të tjerë të administratës, nuk përjashtohet rasti që problematika e përdorimit të aseteve publike në funksion të fushatës zgjedhore të jetë një fenomen më masiv.

Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) raporton rastin si më poshtë:

<sup>112</sup> Shih Raportin Përfundimtar të MF, faqe 20.

Drejtori i Shkollës “Mihal Davidhi” z. Gent Andrea në fshatin Gorre është angazhuar në mënyrë aktive, në fushatë zgjedhore në favor të një subjekti politik, pavarësisht detyrës specifike dhe jashtëzakonisht të rëndësishme që ai mban, si dhe pavarësisht nevojës për paanësi politike që duhet të tregojnë funksionarët publike. Një informacion i ardhur Ministrit të Arsimit i shoqëruar edhe me fotografi të publikuara në rrjetet sociale të rezultojnë në datë 25.05.2017, provon qartësisht angazhimin e z. Gent Andrea, i cili ka vendosur infrastrukturën shkollore në shërbim të fushatës elektorale.<sup>113</sup>

**Ministria e Financave** gjatë ditës së zgjedhjeve përmes mediave të hapura u njoftua për një punonjës të administratës doganore për keqpërdorim të aseteve shtetërore në shkelje të VKM-së nr. 473/2017. Rasti është referuar menjëherë në piken e kontaktit me policinë e shtetit me qëllim marrjen e masave të menjëhershme për evidentimin dhe ndalimin e përdorimit të aseteve shtetërore për fushatë zgjedhore. Gjithashtu për këtë fakt është u njoftua dhe Task-Forca. Sipas këtij njoftimi Ministria e Financave kishte informacion që një punonjës i Doganave po përdorte ditën e zgjedhjeve automjetin e administratës ndërkohë që Ministri i Financave kishte urdhëruar që ndalohet përdorimi i këtyre automjeteve ditën e zgjedhjeve.<sup>114</sup>

Deri në përgatitjen e Raportit Përfundimtar nga kjo ministri, nuk është marrë informacion si është proceduar nga ana e policisë me këtë denoncim.

**Zyra e Zëvendëskryeministrit** ka verifikuar rastin kur në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë Telegrafike Shqiptare është publikuar një artikull në datën 25.5.2017, pra ditën e zgjedhjeve, i cili shoqërohet me një fotografi ilustruese të një flete votimi të zgjedhjeve për Kuvendin në të cilën është shënuar vota “pro” një subjekti politik pjesëmarrës në këto zgjedhje. Rasti në fjalë u shtrua për diskutim edhe në mbledhjen e datës 25.6.2017 të Task- Forcës, nga ku u arrit në përfundimin se ky veprim, është dukshëm në tejkalim të etikës dhe në shkelje të parimeve të neutralitetit dhe paanshmërisë të institucioneve shtetërore dhe aq më tepër kur bëhet fjalë për një institucion i kategorisë së ATSH. Publikimi i fotografisë si një mesazh sugjestionues për të treguar mënyrën se si të plotësojnë fletën e votimit, pra se për cilin subjekt politik duhet të votojnë qytetarët, është në kundërshtim me nenin 77 të Kodit

---

<sup>113</sup> Shiko Raportin Përfundimtar të MAS faqe 14.

<sup>114</sup> E-mail i ardhur nga personi i kontaktit në Ministrinë e Financave në datën 25.06.2017 në orën 11:48 dhe Raporti Përfundimtar i MF, faqe 16.

Zgjedhor, sipas të cilit në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë lloj fushate zgjedhore nëpërmjet organeve të medias.<sup>115</sup>

**(iv) Dhënia e premtimeve, favoreve, cënimi i të drejtave me qëllim favorizimin apo dhënien e votës një subjekti të caktuar politik**

Janë konstatuar disa raste të raportuara në Task-Forcë nga ministrat në raportet përfundimtare të monitorimit sipas VKM 473/2017 të dhënies së premtimeve, favoreve, me qëllim favorizimin apo dhënien e votës një subjekti të caktuar politik, gjatë procesit zgjedhor. Këto raste janë të konstatuara kryesisht nga stafi i ministrave, por në kushtet e mosbashkëpunimit nga punonjësit civilë apo drejtues të tjerë të administratës, në mungesë të infrastrukturës dhe mjeteve monitoruese për kryerjen e verifikimit në terren për çdo rast të referuar (aktivitetin në institucionet e varësisë) nuk përjashtohet mundësia që problematika e përdorimit të aseteve publike në funksion të fushatës të jetë më e shtrirë.

Raste të tilla janë raportuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Ndërkohë, nga Ministrinë e tjera nuk raportohen raste të kësaj natyre.

**Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)** raporton disa raste të dhënies së premtimeve për favorizime në kundërshtim me ligjin, gjatë fushatës zgjedhore. Konkretisht:

**Rasti 1:** Ministrja e Arsimit gjatë monitorimit të mbarëvajtjes së procesit të provimeve të Maturës Shtetërore në datë 22.6.2017 në Provimet e Lëndëve me Zgjedhje, në Zyrën Arsimore Kamëz, ka vërejtur se nxënësit ishin të pajisur me byzylyk të Partisë Socialiste dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim, me qëllim identifikimin e këtyre votuesve të rinj, duke i premtuar atyre lehtësi dhe favorizim në provimet e Maturës Shtetërore.

Deri në periudhën e raporti, Komiteti i Maturës Shtetërore (drejtuar nga zëvendësministrat dhe drejtorët e MAS) që ka përgjegjësinë e të raportuarit mbi rastet e kopjimit apo të premtimit të dhënies ndihmë maturantëve në këmbim të votës, nuk ka raportuar pranë Ministrit të Arsimit dhe Sportit, çka sjell natyrshëm bindjen se ky proces është përdorur politikisht dhe vota e pothuaj 40 mijë maturantëve ka qenë e deformuar nga vullneti i tyre i lirë.<sup>116</sup>

<sup>115</sup> Shkresa e Zëvendëskryeministrit nr. 3598, datë 27.06.2017 drejtuar Kryeministrit.

<sup>116</sup> Shiko Raportin Përfundimtar të MAS faqe 9 dhe 10.

**Rasti 2:** Në datë 10 Maj 2017 gjatë provimit të Gjuhë Letërsisë Ministrja e Arsimit gjatë monitorimit të mbarëvajtjes së procesit, në Zyrën Arsimore Krujë, pati mundësi të fliste nga afër me mësuese e mësues pjesë e procesit të administrimit të provimeve, të cilët kanë konfirmuar se janë nën një presion të madh nga ana e Drejtuesve të Drejtorive dhe Zyrave Rajonale, për të lënë nxënësit të kopjojnë, pasi si votues për herë të parë, janë kontingjent i ndikueshëm për të votuar krahun politik që i ndihmon apo premtion ndihmë në shkëmbim të votës. Vetë disa maurantë kanë konfirmuar përpara Ministrit të Arsimit dhe Sportit se janë joshur me premtime për rritje note në shkëmbim të votës, aq sa nëpër klasa të ndryshme maurantët që mbanin në dorë byzylykë me të njëjtën ngjyrë dalluese, ishin ata që do të ndihmoheshin në këmbim të premtimit të dhënies së votës.<sup>117</sup>

**Rasti 3:** Në datë 10 Maj 2017 gjatë provimit të Gjuhë Letërsisë Ministrja e Arsimit gjatë monitorimit të mbarëvajtjes së procesit, në një shkollë në qytetin e Laçit (Zyra Arsimore Kurbin), u konstatua kopjim masiv nëpër klasa, ndërkohë që u kapën disa maurantë duke kopjuar në celular, me tezën e provimit të dalë nga ambienti i provimit në rrugë elektronike dhe hyrë përsëri i zgjidhur. Edhe gjatë këtij provimi Ministri i Arsimit dhe Sportit pati mundësi të fliste nga afër me mësuese e mësues pjesë e procesit të administrimit të provimeve, të cilët kanë konfirmuar se janë nën një presion të madh nga ana e Drejtuesve të Drejtorive dhe Zyrave Rajonale, për të lënë nxënësit të kopjojnë, pasi si votues për herë të parë, janë kontingjent i ndikueshëm për të votuar krahun politik që i ndihmon apo premtion ndihmë në shkëmbim të votës. Vetë disa maurantë kanë konfirmuar përpara Ministrit të Arsimit dhe Sportit se janë joshur me premtime për rritje note në shkëmbim të votës, aq sa nëpër klasa të ndryshme maurantët që mbanin në dorë byzylykë me të njëjtën ngjyrë dalluese, ishin ata që do të ndihmoheshin në këmbim të premtimit të dhënies së votës.<sup>118</sup>

**Rasti 4:** Gjatë monitorimit të proceseve të Maturës Shtetërore në DAR Elbasan (Gramsh, Librazhd) u konstatuan parregullsi në administrimin e ambienteve në disa shkolla, ku përfaqësues të këtij DAR kishin përdoruar ambientet e klasave dhe monitoruesit për të favorizuar maurantët sipas premtimeve paraprake për përdorim gjatë fushatës zgjedhore. Disa maurantë kanë konfirmuar se ju janë bërë premtime për rritje note në shkëmbim të votës, aq sa nëpër klasa të ndryshme maurantët që

---

<sup>117</sup> Shiko Raportin Përfundimtar të MAS, faqe 12.

<sup>118</sup> Shih Raportin Përfundimtar të MAS, faqe 13 dhe 14.

mbanin në dorë byzylykë me të njëjtën ngjyrë dalluese, ishin ata që do të ndihmoheshin në këmbim të premtimit të dhënies së votës.<sup>119</sup>

**Rasti 5:** Në DAR Korçë është faktuar se në provimin e lëndës Gjuhë dhe Letërsi kanë qenë të pranishëm dy ish-drejtues të lartë të administratës civile në MAS, Z. Alqi Kushi ish-Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse dhe Znj. Ornela Koleka ish-Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Të dy këta persona kanë qenë të paautorizuar dhe kjo përbën një shkelje të rëndë të akteve nënligjore që rregullojnë procesin e Maturës Shtetërore.

Po ashtu, ka të dyshime të forta se Z. Plarent Ndreca, ish sekretar i Përgjithshëm i MAS, ka hyrë në mjediset e shkollës “Shote Galica” në Fushë-Krujë, me qëllim favorizimin e të rinjve që votonin për herë të parë, me qëllim që të mbështesnin Partinë Socialiste.<sup>120</sup>

**Rasti 6:** Përveç rasteve të monitorimit të maturës shtetërore dhe ushtrimit të autoritetit nga persona në hierarkinë e lartë të administratës shtetërore, me qëllim dhënien e privilegjeve në këmbim të votës, Ministria e Arsimit ka evidentuar raste të dhënies së privilegjit në favor të familjarëve të pronarëve të medias që mbështesin subjekte elektorale. Kështu, raportohet rasti i akordimit të fondit të ekselencës për djalin e një pronari të medias z. Mero Baze. Me urdhrin nr.289, datë 22.05.2017 ‘Për shpalljen e kandidatëve fiues dhe pagesën që përfitojnë kandidatët nga Fondi i Ekselencës për ndjekjen e studimeve jashtë vendit për vitin akademik 2017-2018’, në ditën që në Parlament votoheshin ndryshimet në qeveri, përfshirë Ministrin e Arsimit, ish-Ministri i Arsimit zj.Lindita Nikolla i ka akorduar një fond të konsiderueshëm z. Aldion Mero Baze, mbështetës i Kryetarit të Bashkisë së Tiranës z. Veliq dhe djali i gazetarit të njohur që mbështet publikisht një subjekt politik. Sipas Ministrin të Arsimit zj. Karabina, në asnjë rast nuk është bërë e mundur transparenca lidhur me përmbushjen e kriterëve, vënies në dispozicion për të monitoruar proces-verbalet e vlerësimit të dokumentacionit, mënyrës së intervistimit të kandidatëve, apo urdhrave të tjerë për akordim bursash në këtë rast apo raste të tjera.<sup>121</sup>

Zyra e OSBE për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut në raportin e ndërmjetëm të publikuar të datës 2 Qershor 2017 ka konkluduar se ‘*..interesat ekonomike dhe politike të pronarëve të mediave, shpesh influencojnë raportimet e*

<sup>119</sup> Shih Raportin Përfundimtar të MAS, faqe 7.

<sup>120</sup> Shih Raportin Përfundimtar të MAS, faqe 20.

<sup>121</sup> Po aty, faqe 17-18.

*gazetarëve, duke krijuar një perceptim të gjerë , që mediat janë të polarizuara fuqishëm sipas linjave partiake*<sup>122</sup>. Është e qartë që znj. Nikolla një ditë para largimit ka favorizuar një nga familjarët e ngushtë të një pronari të medias, me qëllim mbështetjen mediatike gjatë fushatës elektorale.

**Ministria e Drejtësisë (MD)** raporton disa raste të dhënies së premtimeve dhe favoreve për fushatë zgjedhore. Konkretisht:

**Rasti 1:** Z. Ledian Shehu Regjistruer i Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, gjatë një veprimtarie me karakter politik dhe fetar, ka lejuar që veprimtaria institucionale e regjistrimit të pasurive, të përdoret për qëllime politike nga kandidati për deputet në Qarkun Berat, për subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” z. Fadil Nasufi. Ky i fundit, ka bërë shpërndarje të certifikatës për vërtetim pronësie, edhe pse kjo jo vetëm nuk është detyrë e tij, por është veprimtari normale institucionale e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Aplikimi për certifikatë vërtetimi pronësie dhe shpërndarja e saj, bëhet sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Në këtë rast kandidati për deputet ka përvetësuar shpërndarjen e certifikatave për vërtetim pronësie, duke e përdorur atë për qëllime të përfitimit politik. Aplikimi ka qenë në përputhje me ligjin dhe për pasojë pajisja me certifikatë vërtetimi pronësie është detyrim për Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ndërkohë që kandidati për deputet nuk ka asnjë arsye për ta konsideruar këtë veprimtari shtetërore si “meritë” apo “kënaqësi” të tij.<sup>123</sup>

**Rasti 2:** Kandidatët për deputet të Lëvizjes Socialiste për Integrim në Qarkun Shkodër z. Agron Çela dhe z. Dritan Ylli, si dhe koordinatori i kësaj partie për Malësinë e Madhe z. Ardit Hodaj nëpërmjet veprimeve dhe deklarimeve të tyre, kanë luajtur rol në krijimin e perceptimit të rremë tek qytetarët për punësimin e tyre në IEVP Shkodër, në këmbim të mbështetjes për një forcë të caktuar politike.<sup>124</sup>

Objekti “Qendra e re e paraburgimit dhe burgut Shkodër” është një investim i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Qeverisë Shqiptare, dhe aktualisht është në fazën e garancisë së punimeve. Në datë 1 Qershor, në një kronikë reklamë për Lëvizjen Socialiste për Integrim, të bërë në Televizionin lokal të qytetit të Shkodrës

---

<sup>122</sup> Raporti i ndërmjetë m i OSBE-ODHIR lidhur me zgjedhjet e 25 Qershor 2017, faqe 7.

<sup>123</sup> Shih Raportin Përfundimtar të MD, faqe 44 – 45.

<sup>124</sup> Shih Raportin Përfundimtar të MD, faqe 45 - 48.

“TV1 Channel”, nga zyrat e kësaj force politike, z. Ardit Hotaj, koordinator i saj për Malësinë e Madhe, pasi shpjegon angazhimin e LSI për vende të reja pune, e ilustron me vendet e lira në burgun e Shkodrës. Z. Hotaj gjatë kronikës reklamuese ku theksohet se “LSI do të thotë punësim, mirëqenie dhe zhvillim” angazhohet të shpjegojë pse për mbi 400 aplikantë për vende pune në burgun e Shkodrës do kenë një vend të sigurt aty, të ndara në 342 vende punonjës me uniform dhe rreth 50 punonjës të administratës....., në faqen zyrtare të drejtorisë së burgjeve të gjithë mund të konsultojnë shpalljen si dhe procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm që aplikantët kanë dorëzuar për të fituar të drejtën e punësimit”. Po sipas koordinatorit të LSI-së në Malësi të Madhe, i cili nuk rezulton të ketë asnjë funksion zyrtar në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, “në përfundim të këtyre procedurave ka mbërritur urdhri 24 Majit në të cilin janë emërimet e rreth 42 fituesve të parë që janë pjesë e administratës. Shumë shpejt do të përfundojnë edhe procedurat për emërimet e pjesës tjetër të punonjësve të këtij institucioni”. Në të njëjtën kronikë televizive pasqyrohet se një rol për këtë ka luajtur edhe deputeti z. Agron Çela, i cili është edhe kandidat për deputet në zgjedhjet e datës 25 Qershor 2017. Nga ana tjetër, në një intervistë të dhënë për Rrjetin investigativ “BIRN”, kandidati për deputet z. Dritan Ylli, është shprehur se: “Nuk është aspak e vërtetë që të jenë premtuar vende pune në këmbim të votave për LSI, punësimet janë bërë krejtësisht të rregullta dhe gjithë këto procedura së bashku me fituesit janë shpallur në faqen zyrtare. Ndërkohë Ministria e Drejtësisë konfirmon se ligjërisht nuk është kryer asnjë pranim apo punësim në I EVP Shkodër.

Hartimi, nënshkrimi dhe protokollimi i urdhrit fiktiv të shpalljes së fituesve, publikimi i tij në mediat lokale të qytetit të Shkodrës, reklamimi i tij me zë dhe figurë nga një përfaqësues i lartë politik i një partie politike, mbrojtja e rregullshmërisë së procesit nga një kandidatë për deputet dhe deklaratimet e rreme se fituesit janë shpallur në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, krijojnë bindjen e plotë se këta shtetas, nëpërmjet veprimeve apo deklaratimeve të tyre, si dhe kryerja e këtij procesi fiktiv, kanë luajtur rol në krijimin e perceptimit të rremë tek qytetarët për punësimin e tyre në I EVP Shkodër, në këmbim të votave për një forcë të caktuar politike.

**Rasti 3:** Ministri i Drejtësisë nëpërmjet medias u njoh me deklarin publik të Kryetarit të Partisë Socialiste z. Edi Rama, dhe Nënkyetarit të Lëvizjes Socialiste për Integrim z. Luan Rama, sipas të cilëve për motive politike apo shkaqe të tjera të paligjshme, po pengohen qytetarët të pajisjen me certifikata pronësie, pavarësisht se janë pajisur më parë me

certifikatën e legalizimit të pasurisë së tyre. Në përfundim të inspektimit mbi këto akuza<sup>125</sup> të ndërsjella për qëllime të përfitimit politik, rezulton se nuk ekziston problematika e pengimit të qëllimshëm nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të regjistrimit të lejeve të legalizimit. Evidentohet qartësisht se ndërsa ALUIZNI lëshon lejet e legalizimit dhe bën aplikimin për regjistrim, këtë aplikim nuk e shoqëron me dokumentacionin e plotë të nevojshëm për regjistrimin e lejeve të legalizimit. E gjitha problematika e ngritur në takimin e Vorës, rezulton të ketë pasur si qëllim kryesor përdorimin për efekte elektorale të veprimitarisë institucionale të Ministrisë së Drejtësisë, për të përfituar politikisht nga procesi i legalizimeve. Ndërkohë që qartësisht evidentohet se pjesa dërrmuese e problematikës buron pikërisht nga mospërmbushja e rregullt e detyrës nga ana e institucionit përgjegjës për lëshimin e lejeve të legalizimit (ALUIZNI).

Nga **Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë** është raportuar rasti mbi keqpërdorimet dhe abuzimet e mundshme në shpërndarjen e Ndhmës Ekonomike. Konkretisht:

Ministri urdhëroi ngritjen e grupeve për kontrollin e disa prej Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Nga kontrolli u konstatua që për 3 qarqet ku po zbatohet skema e re e Ndhmës Ekonomike (Tiranë, Durrës dhe Elbasan) kishte mangësi procedurale në zbatimin e skemës së Ndhmës Ekonomike. Në kuadrin ligjor për skemën të re, parashikohet që aktet nënligjore kërkojnë që përpos formatit elektronik që ndodhet në sistem, lista të dërgohet edhe në formatin zyrtar (letër) e vulosur dhe firmosur, në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligj, ndërkohë që nga kontrolli u konstatua se lista mbahej vetëm në format elektronik, çka rrit mundësinë e abuzimeve.

Gjithashtu, nga kontrolli rezultoi një rritje shqetësuese e numrit të përfituesve për Bashkinë Librazhd dhe Bashkinë Peqin dhe për këtë arsye iu la si rekomandim Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Elbasan, kontrolli i këtyre dy Bashkive mbi këtë pikë.

Nga kontrolli i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Sociale Shtetëror, (DRSHSSH) Korçë u konstatuan një sërë shkeljesh ligjore në mënyrën e përdorimit të fondeve të ndihmës ekonomike. Shkelja më e rëndë e konstatuar është mungesa e listave emërore të përfituesve të ndihmës ekonomike në këtë qark, për një periudhë prej 4 muajsh. Ky fakt përbën shkelje të Udhëzimit Nr. 3, datë 17.02.2017, të ndryshuar, të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ku kërkohet që vendimet e këshillave bashkiakë për përfituesit e ndihmës ekonomike të shoqërohen me listat emërore të përfituesve. Mungesa e listave të familjeve që përfitojnë nga ndihma ekonomike ngre dyshime për keq menaxhim financiar, shpërdorim të detyrës apo korrupsion nga ana e punonjësve të përfshirë në proces.

---

<sup>125</sup> Shih Raportin Përfundimtar të MD, faqe 48-50.



Nisur nga këto të dhëna Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i ka kërkuar Ministrisë së Financave, nisjen urgjent të inspektimit financiar. Gjithashtu, nisur nga dyshimi se mungesa e listave të përfituesve, dhe mos afishimi i tyre është bërë për të favorizuar individë në mbështetje të fushatës zgjedhore për subjekte të caktuara politike.<sup>126</sup>

## **II. Prefektura**

### **(i) Shpenzimet e programuara dhe faktike gjatë procesit zgjedhor**

Lidhur me programin analitik të përditësuar, zbatimin e tij si dhe informacion lidhur me realizimin faktik të buxhetit për financimin e brendshëm si dhe informacionin për përdorimin e buxhetit jashtë zërave (nëse ka) të programit analitik të miratuar për vitin 2017 si dhe analizë krahasuese me buxhetin për vitet 2015 dhe 2016.

Rezulton se kanë kthyer përgjigje vetëm 10 (dhjetë) Prefektura. Sipas informacionit të ardhur nga Prefekturat e Qarkut Elbasan, Lezhë, Korçë, Gjirokastrës, Vlorë, Fier dhe Durrësit rezulton që shpenzimet financiare kanë qenë brenda programit analitik të miratuar. Informacioni i ardhur nga Prefekturat e Qarkut Shkodër, Dibër dhe Kukës ka qenë krejtësisht i paqartë. Ndërsa Prefekturat e Qarkut Tiranë dhe Berat nuk kanë kthyer përgjigje.

### **(ii) Konsumi mujor i karburantit**

Rezulton se kanë kthyer përgjigje 8 (tetë) nga 12 Prefektura. Sipas këtij informacioni për Prefekturat e Qarkut Elbasan, Shkodër, Lezhë, Korçë, Gjirokastrë, dhe Vlorë konsumi i karburantit ka qenë konstant.

Prefektura e Qarkut Tiranë dhe Dibër kanë sjellë informacion të pasaktë në lidhje me këtë çështje. Nuk kanë kthyer përgjigje Prefektura e Qarkut Kukës, Durrës, Fier dhe Berat.

<sup>126</sup> Raporti përfundimtar i monitorimit nga MMSR, faqe 13-15.

### **(iii) Përdorimi i asetëve**

Referuar pyetjes kësaj pyetje rezulton që kanë sjellë informacion 9 (nëntë) nga 12 Prefektura.

Nga informacioni i ardhur Qarkut Dibër dhe Shkodër e kanë të paqartë informacionin, ndërsa për prefekturat e tjera rezulton të mos ketë pasur raste të përdorimi i asetëve gjatë periudhës të fushatës zgjedhore.

Prefekturat e Qarkut Tiranë, Fier dhe Kukës nuk kanë sjellë informacion.

## **III. Bashkitë dhe ndërmarrjet në pronësi të tyre**

### **(i) Shpenzimet e programuara dhe faktike gjatë procesit zgjedhor**

Lidhur me shpenzimet e programuara sipas programit analitik, realizimin faktik të buxhetit për financimin e brendshëm apo përdorimin e buxhetit jashtë zërave të programit analitik të programuar për vitin 2017 rezulton që 38 Bashki kanë sjellë informacion pranë Task-Forcës. Megjithatë informacioni i ardhur nga ana e tyre është krejtësisht i paqartë, konfuz dhe nuk është kthyer përgjigje saktësisht për çështjet të cilat është kërkuar informacion.

Bashkitë Peqin, Belsh, Roskovec, Kurbin, Librazhd, Memaliaj, Fier, Elbasan, Malësi e Madhe, Vorë, Cërrik. Shkodër dhe Kukës kanë informuar që buxheti është shpenzuar sipas parashikimeve.

Bashkitë Tepelenë, Gramsh, Ura Vajgurore, Poliçan, Konispol, Mirditë, Himarë, Libohovë, Delvinë, Skrapar, Lushnje, Patos, Prrenjas, Shijak, Kuçovë, Krujë, Berat, Vau i Dejës, Pogradec, Klos, Përmet, Mallakastër, Devoll, Lezhë dhe Kamëz kanë sjellë informacion të paqartë.

Bashkitë Sarandë, Korçë, Maliq, Divjakë, Fushë-Arrëz, Kolonjë, Pukë, Has, Pustec, Tiranë, Rrogozhinë, Finiq, Kavajë, Mat, Tropojë, Dropull, Këlcyrë, Gjirokastër, Bulqizë, Dibër, Vlorë, Selenicë dhe Durrës **nuk kanë sjellë informacion për këtë çështje.**

**Vlen të theksohet që asnjë nga Bashkitë nuk ka sjellë një analizë të detajuar për realizimin e buxhetit krahasuar me vitet 2016 dhe 2015 ashtu siç ishte kërkuar.**

## **(ii) Konsumi mujor i karburantit**

Lidhur me kërkesën për informacion për konsumin e karburantit për periudhën Janar – Qershor 2017 rezulton që kanë sjellë informacion vetëm 44 Bashki. Edhe ky informacion i ardhur nga këto Bashki nuk ka qenë plotësisht i saktë. Në disa raste informacioni ka qenë vetëm për vitin 2017. Pra nuk kemi një krahasim me të njëjtën periudhë të dy viteve të mëparshme. Në disa raste të tjera informacioni për konsumimin e karburantit ka qenë në total për 5 mujorin e parë të 2017 pa e specifikuar konsumin mujor, ashtu siç ishte kërkuar nga Task-Forca.

## **(iii) Përdorimi i asetëve**

Lidhur me përdorimit të mjeteve logjistike për qëllime elektorale për të favorizuar një subjekt zgjedhor të caktuar, asnjë nga bashkitë që kanë dhënë informacion, nuk ka relatuar ndonjë rast të konstatuar.

Nga monitorimi i kryer nga zyra e Zëvendëskryeministrit mbi bazën e kërkesës së subjektit elektoral LSI në lidhje me përdorimin e shesheve dhe ambienteve nga Bashkia Vlorë, ka rezultuar se nga ana e kësaj bashkie, në mungesë të plotë të transparencës, nuk është dhënë informacion për rastin e dhënies nga ana e Kryetarit të kësaj bashkie të lejes dy mujore subjekti politik Partia Socialiste për të përdorur sheshe dhe vendkalime publike (sheshit para pallatit të sportit “Flamurtari” Vlorë) të administruara nga kjo bashki. Ky është një veprim i cili vjen në kundërshtim me ligjin nr. 8773, datë 23.4.2001 “Për tubimet” sipas (paragrafi 5 i nenit 2), dhe gjithashtu edhe me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (nenit 54 “*Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak*”, pikës “e”) pasi miratimi i tjetërsimit ose dhënies në përdorim të pronave të bashkisë të tretëve, është kompetencë ekskluzive e këshillit bashkiak dhe jo e Kryetarit të bashkisë.

Ky rast, i cili mund të konsiderohet një rast tipik i përdorimit të kundërligjshëm të asetëve publike për të favorizuar një subjekt politik, është referuar në organin e prokurorisë nga zyra e Zëvendëskryeministrit pas shqetësimeve të bëra publike nga një grup i këshilltarëve bashkiakë të subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim, lidhur me mosmiratimin nga ana kryetarit të bashkisë Vlorë të kërkesës së këtij subjekti për përdorimin e sheshit para pallatit të sportit “Flamurtari” Vlorë, pikërisht

me argumentin se ky shesh i është dhënë në përdorim një subjekti tjetër politik (Partia Socialiste) për periudhën dymujore nga 01.05.2017 deri me 30.06.2017.<sup>127</sup>

Përveç këtij rasti, përmes medias dhe denoncimeve në zyrën e Zëvendëskryeministrit janë denoncuar raste të përdorimit të aseteve të bashkive si kopshte, qendra të rehabilitimit, shkolla etj. të vëna në dispozicion nga bashkitë. Përmendim rastin e Bashkisë Tiranë, Pogradec, Durrës etj.

Gjithashtu, edhe rasti i shpërndarjes së ftesave në qytetin e Tiranës për të votuar subjektin elektoral PS, ndërkohë që ishte ditë e heshtjes zgjedhore është një nga rastet e diskutuara në Task-Forcë në mbledhjen e datës 25 Qershor 2017, ku në asnjë rast nuk është bërë transparenca në lidhje me kostot dhe mbulimit të shpenzimeve sa i takon përgatitjes dhe shpërndarjes të ftesave.

## **G. Përdorimi gjatë fushatës dhe procesit zgjedhor të mjeteve financiare nga burime të paligjshme apo të krijuara nga veprimtari të paligjshme**

### **(i) Transaksionet e dyshimta gjatë fushatës elektorale dhe vitit elektoral 2017**

Pjesë e Task-Forcës është edhe DPPP, e cila është një institucion që ka kapacitet për të hetuar lidhur me pastrimin e parave nga burime të paligjshme të cilat mund të përdoreshin gjatë fushatës zgjedhore.

Nga raportimet e DPPP<sup>128</sup> rezulton se është identifikuar vetëm një rast i një kandidati për deputet me initiale T.V., i cili në 2 muajt e fundit ka bërë tërheqje parash për të cilat nuk dihet destinacioni dhe që nuk janë karakteristikë e sjelljes financiare të këtij personi. Rasti i është referuar Policisë së Shtetit për veprime të mëtejshme dhe po përgatitej për referim në prokurori të mëtejshme.

### **(ii) Tërheqjet e parave nga bankat e nivelit të dytë; paraja në qarkullim gjatë fushatës elektorale dhe vitit elektoral 2017**

<sup>127</sup> Shkresa e Zëvendëskryeministrit nr. 3514, datë 20.6.2017.

<sup>128</sup> E-mail datë 14.06.2017 dërguar Zëvendëskryeministrit.

Nga raportimet e kësaj drejtorie<sup>129</sup>, veçanërisht pas kërkesës së kësaj të fundit për shqetësime të ngritura nga Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë se ka informacione për tërheqje të konsiderueshme të parave gjatë muajit maj 2017 nga bankat e nivelit të dytë, para kjo që mund të përdoret për qëllime të kundërligjshme gjatë fushatës zgjedhore, një informacion i tillë sipas analizës së kësaj drejtorie nuk rezultoi i mbështetur.

Gjithsesi, raportohet se vërehet një rritje në tërheqjen e parave gjatë muajit prill 2017, por sipas Drejtorit kjo rritje nuk lidhet me faktorë të rëndësishëm. Z. Gjokuta ka pranuar që në muajin Prill nuk ka tërheqje. Prilli përgjithësisht është muaj i paqartë që herë ka rritje të tërheqjeve dhe herë ulje, por kjo rritje nuk e lidh me ndonjë faktor të rëndësishëm.<sup>130</sup>

Gjithashtu, sipas drejtorit është e pamundur të provohet se tërheqjet janë përdorur për veprimtari të paligjshme në funksion të fushatës zgjedhore.

Më tej, Drejtori i drejtorisë në fjalë shprehet se transaksionet janë brenda trendit sezonal dhe madje fluksi i parasë fizike në qarkullim dhe i asaj jashtë bankave ka shënuar nivelin më të ulët të pesë viteve të fundit.<sup>131</sup>

### **(iii) Financimi i subjekteve elektorale përmes mjeteve financiare të krijuara nga veprimtari e paligjshme**

Në raportin Përfundimtar të paraqitur nga Ministria e Punëve të Brendshme, rezulton se nga procesi i monitorimit dhe nga denoncimet që kanë mbërritur nga qytetarët, ka rezultuar se: janë angazhuar në mënyrë masive burime të dyshimta financiare në shitblerjen e votës nga subjekte politike ose persona të lidhur me këto subjekte.<sup>132</sup>

## **H. Përditësimi dhe ndjekja e problematikës me listat e zgjedhësve**

Lidhur me listat e zgjedhësve nuk është vërejtur ndonjë problematikë shqetësuese. Ministri i Brendshëm në mbledhjen e Task-Forcës të datës 21 Qershor 2017 ka raportuar në lidhje me

<sup>129</sup> Shkresë nr. 477 prot., datë 20.06.2017 dhe mbledhje e Task-Forcës e datës 21.06.2017.

<sup>130</sup> Proces-Verbal i Mbledhjes Task-Forcë datë 21.06.2017, faqe 25.

<sup>131</sup> Proces-Verbali i mbledhjes së Task-Forcë datë 20 Qershor 2017.

<sup>132</sup> Shih Raportin Përfundimtar nr. 5474/1, datë 10.7.2017 të MPB, faqe 1 dhe 2.

ecurinë e procedurës për hartimin e listave të zgjedhësve për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Qershor 2017. Duke pasur në konsideratë Dekretin nr. 9883, dt. 5.12.2016 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin”, janë marrë edhe masat në drejtim të hartimit të listave të zgjedhësve, duke respektuar detyrimet dhe afatet kohore sipas Kodit Zgjedhor të R.SH-së.

Situata politike e krijuar prodhoi një realitet të ri në lidhje me procesin zgjedhor. Sipas Dekretit nr. 10351, dt. 21.05.2017 u përcaktua data e re e zgjedhjeve. Në këto kushte MPB ka marrë masa për gjenerimin edhe një herë të listës përfundimtare, listë e cila përfshiu të gjithë shtetasit të cilët mbushin moshën 18 vjeç më datë 25.05.2017. Në datë 24 Qershor 2017 është hartuar lista e re e zgjedhësve, e cila i është vënë në dispozicion KQZ-së.

Lista zgjedhësve është hartuar duke pastruar në maksimum rastet e dublimeve të dyshuara dhe rregullimin e adresës 10 shifrore zgjedhore për zgjedhësit, si dhe janë pezulluar nga lista e votuesve gjithë personat që preken nga ligji 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.<sup>133</sup> Gjithsesi, ashtu si dhe në zgjedhjet e kaluara nga Avokati i Popullit në mbledhjen e Task-Forcës së datës 23.06.2017 është ngritur shqetësimi i mungesës së letërnjoftimeve për rreth 900 të dënuar që vuajnë dënimin në institucionet penale, çka i pengon ata të ushtrojnë të drejtën e votës. Ky fenomen më të shumtën e rasteve ka si shkak pamundësinë financiare të këtyre të dënuarve të aplikojnë për tu pajisur me letërnjoftim pasi nuk krijojnë të ardhura në kushtet kur janë duke vuajtur dënimin. Por ka dhe raste kur letërnjoftimet kanë mbetur në dosjet e prokurorisë.<sup>134</sup>

## **I. Njoftimi apo kryerja e kallëzimeve penale në organin e Prokurorisë për rastet e marrjes/vënies në dijeni për veprat penale në fushën zgjedhore.**

### **(i) Rastet e referuara apo kallëzuara në Prokurori nga Ministritë apo institucionet e tjera**

Nga informacioni i ardhur pranë Task-Forcës rezulton që disa ministri kanë bërë njoftime apo kallëzime penale pranë Prokurorisë për vepra penale që lidhen me

<sup>133</sup> Shih Shkresa e MPB nr. 4997/1, datë 19.06.2017 si dhe raportimi i MPB ne mbledhjen e Task-Forcë datë 21.06.2017.

<sup>134</sup> Proces verbali i mbledhjes së Task-Forcë, datë 21.06.2017.

zgjedhjet në Republikën e Shqipërisë. Këto informacione janë vetëm nga Ministrinë titullarët e të cilëve u emëruan në detyrë në datën 22 Maj 2017. Ministrinë e tjera edhe pse u është kërkuar zyrtarisht të sillnin informacion për raste të tilla nuk kanë kthyer përgjigje për këtë çështje. Sipas këtij informacioni rezulton si më poshtë:

1. **Ministria e Shëndetësisë**, bazuar në informacionet dhe ankesat e bëra në drejtim të Ministrisë për pjesëmarrje aktive në fushatë zgjedhore, 3 (tre) raste u referuan në Prokurori dhe u mor masa e pezullimit nga detyra për personat si më poshtë<sup>135</sup>:
  1. Bledar Hima, Drejtor i shërbimit spitalor Librazhd.
  2. Armida Lula, Drejtore e komanduar e Shërbimit spitalor Tepelenë.
  3. Pandeli Çunge, Kryeinfermier i shërbimit spitalor Kolonjë.
  
2. **Ministria e Arsimit dhe Sportit** raporton se ka referuar në prokurori 9 (nëntë) raste për punonjësit e administratës të institucioneve të varësisë së saj si më poshtë:
  - 1- Bedrie Manjani, me detyrë Përgjegjës i Zyrës Arsimore Bulqizë, për arsye të pjesëmarrjes aktive në fushatë zgjedhore duke përdorur funksionin.
  - 2- Bardhok Pula, me detyrë Drejtor i DAR Lezhë, për arsye të pjesëmarrjes aktive në fushatë zgjedhore duke përdorur funksionin.
  - 3- Fatbardha Qatja, me detyrë Përgjegjës i Zyrës Arsimore Librazhd, për arsye të pjesëmarrjes aktive në fushatë zgjedhore duke favorizuar një subjekt politik të caktuar.
  - 4- Xhevit Dyrmishi, me detyrë Përgjegjës i Zyrës Arsimore Gramsh, për arsye se ka ushtruar presion mbi stafin pedagogjik në mbështetje të një kandidati për deputet të një subjekti të caktuar politik.
  - 5- Selman Qema, me detyrë Përgjegjës i Zyrës Arsimore Has, së bashku me tre persona pjesë e stafit, janë angazhuar në mënyrë aktive në fushatë zgjedhore në favor të një subjekti politik.
  - 6- Gent Andrea, me detyrë drejtor i shkollës “Mihal Davidhi” në fshatin Gorre, Lushnje, për arsye të përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike dhe zgjedhore në favor të një subjekti të caktuar politik.
  - 7- Agim Maci, me detyrë drejtor i shkollës 9-vjecare në fshatin Çermë e Sipërme, Lushnje, për arsye të përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike dhe zgjedhore në favor të një subjekti të caktuar politik.
  - 8- Lindita Rova, me detyrë Drejtor i DAR Gjirokastrë, për arsye se ka kryer veprimtari politike në favor të një subjekti politik të caktuar si edhe ka ushtruar presion mbi stafin pedagogjik.

---

<sup>135</sup> Shih Raporti i Ministrisë të Shëndetësisë, faqe 10.

9- Sonila Peza, me detyrë Drejtor i DAR Kavajë, për arsye se ka kryer veprimtari politike duke marrë pjesë aktivisht në fushatë zgjedhore në favor të një subjekti politik të caktuar si edhe ka ushtruar presion mbi stafin pedagogjik.<sup>136</sup>

Ministria e Arsimit nuk është njoftuar nga ana e organit të Prokurorisë në lidhje me statusin e çdo rasti të referuar.

**3. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë**, raporton se për periudhën 01 – 25.06.2017 janë referuar në prokurori 4 (katër) raste të shkeljeve ligjore që kanë lidhje me procesin zgjedhor, si më poshtë vijon:

1. Marisa Kocorri, me detyrë Drejtor Rajonal i Shërbimit të Punësimit Tiranë, për arsye se ka marrë pjesë aktive në kundërshtim me ligjin në fushatë zgjedhore.
2. Gent Halilaj, me detyrë Drejtor Rajonal i Shërbimit të Punësimit Kukës, për arsye se ka marrë pjesë aktive në kundërshtim me ligjin në fushatë zgjedhore.
3. Luiza Qipo, me detyrë Përgjegjëse e Agjencisë së Sigurimeve Shoqërore Ersekë, se ka marrë pjesë aktive në kundërshtim me ligjin në fushatë zgjedhore.
4. Ervis Xhelo, me detyrë Drejtor Rajonal i Sigurimeve Shoqërore Elbasan, për arsye se ka marrë pjesë aktive në kundërshtim me ligjin në fushatë zgjedhore.<sup>137</sup>

Në të gjitha rastet organi i Prokurorisë ka regjistruar procedim penal.

**4. Ministria e Financave** ka referuar në prokurori 7 (shtatë) raste për punonjës të institucioneve të vartësisë për veprën penale të parashikuar nga neni 328/a i Kodit Penal, si me poshtë:

1. Kliton Bistrin, me detyrë inspektor i Hetimit Tatimor për përfshirje në fushatë zgjedhore.
2. Pranvera Resulaj, me detyrë Drejtoreshë Rajonale e Tatimeve në Vlorë për përfshirje në fushatë zgjedhore për përfshirjes në fushatë zgjedhore.
3. Alber Halitaj, me detyrë Drejtor Rajonal i Tatimeve në Kukës për përfshirje në fushatë zgjedhore.
4. Adriatik Hamza, me detyrë punonjës i degës doganore Tiranë.
5. Misto Kano, me detyrë punonjës i doganës Kakavijë për përfshirje në fushatë zgjedhore.
6. Erlish Shalari, me detyrë punonjës i doganës Kakavijë për përfshirje në fushatë zgjedhore.

---

<sup>136</sup> Shiko Raportin Përfundimtar të MAS, faqe 28-29.

<sup>137</sup> Shiko Raportin Përfundimtar të MMSR, faqe 17.



7. Enid Hito, me detyrë inspektor kontrolli pranë DR Tatimeve Sarande për përfshirje në fushatë zgjedhore.

Në një rast është njoftuar regjistrimi i procedimit penal, ndërsa në rastet e tjera nuk ka pasur një përgjigje nga organi i Prokurorisë, pavarësisht kërkesës të bërë nga ana MF-së.

**5. Ministria e Drejtësisë** ka referuar në prokurori 9 (nëntë) raste, për punonjësit e administratës së institucioneve të varësisë së kësaj ministrie si më poshtë:

1. Për përfshirjen e Drejtorit të IEVP Tropojë në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetasit Granit Kurmekaj, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 328/a i Kodit Penal.

2. Për përfshirjen e Regjistruesit të ZVRPP Shkodër në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetasit Edmond Ndou, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 328/a i Kodit Penal.

3. Për përfshirjen e Kryetarit të Zyrës Përmbartimore Gjyqësore Durrës në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetasit Surin Hoxha, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 328/a i Kodit Penal.

4. Për përfshirjen e Drejtorit të IEVP Fier në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetasit Jetnor Krakulli, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 328/a i Kodit Penal.

5. Për përfshirjen e Drejtorit të IEVP Burrel në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetasit Fatjon Kurti, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 328/a i Kodit Penal.

6. Për përfshirjen e Regjistruesit të ZVRPP Durrës në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetasit Ani Dyrmishi, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 328/a i Kodit Penal.

7. Për përfshirjen e Regjistruesit të ZVRPP Sarandë në fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetases Adriana Shehu, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 328/a i Kodit Penal. Gjithashtu, sipas medias ndaj kësaj

shtetaseje është kërkuar nga gjykata marrja e masës së sigurimit personal “arrest me burg”.

8. Për përfshirjen e Regjistruerit të ZVRPP Berat për përdorim të funksionit publik për veprimtari zgjedhore në kundërshtim me ligjin. Ministria e Drejtësisë është njoftuar për regjistrimin e kallëzimit penal ndaj shtetasit Ledian Shehu, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga paragrafi i katërt i nenit 328/a i Kodit Penal.

9. Për disa punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për përdorim të funksionit publik në favor të një subjekti zgjedhor, si dhe për shpërdorim të detyrës sipas nenit 248 të Kodit Penal. Menjëherë është njoftuar organi i prokurorisë dhe Policia e Shtetit, të cilët kanë kryer veprimet e para hetimore dhe mbledhjen e provave.

Gjithashtu, Ministri i Drejtësisë ka përcjellë informacion mbi dyshimet e kryerjes së veprës penale për disa kandidatë për deputet dhe një përfaqësues të një subjekti zgjedhor, si më poshtë:

1. Është kallëzuar penalisht kandidati për deputet i Partisë Socialiste në Qarkun Berat z. Fadil Nasufi, për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 246 “Përvetësimi i titullit apo i detyrës shtetërore” dhe 328 “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” të Kodit Penal.

2. Janë kallëzuar penalisht kandidatët për deputet të Lëvizjes Socialiste për Integrim në Qarkun Shkodër z. Agron Çela dhe z. Dritan Ylli, si dhe koordinatori i kësaj partie për Malësinë e Madhe z. Ardit Hodaj, për shkak se dyshohen se kanë kryer veprën penale të parashikuar në nenin 328 “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” të Kodit Penal, sepse nëpërmjet veprimeve dhe deklarimeve të tyre, kanë luajtur rol në krijimin e perceptimit të rremë tek qytetarët për punësimin e tyre në IEVP Shkodër, në këmbim të mbështetjes për një forcë të caktuar politike.

Mbi këto kallëzime nuk ka ende asnjë përgjigje apo reagim zyrtar nga organi i prokurorisë, dhe Ministria e Drejtësisë nuk është informuar për regjistrimin e procedimit penal.<sup>138</sup>

**6. Ministria e Punëve të Brendshme** nuk ka relatuar asnjë rast të referuar në organin e prokurorisë për personelin e aparatit të kësaj ministrie. Sipas raportimit të bërë ka pasur vetëm një denoncim, i cili është shqyrtuar dhe nuk është provuar.<sup>139</sup>

---

<sup>138</sup> Shih Raportin Përfundimtar të MD, faqe 42 dhe 43.

<sup>139</sup> Shih Raportin Përfundimtar nr. 5474/1, datë 10.7.2017 të MPB, faqe 2.

7. **Ministria e Bujqësisë** nuk ka referuar ndonjë rast në prokurori për vepra penale në fushën zgjedhore, por Ministri ka raportuar se nga media ka mësuar se Policia e Shtetit ka ndaluar z. Pajtim Myrtollari me funksion Specialist i Sektorit të Monitorimit dhe Inspektimit për rrethin e Korcës pranë Vrejtorisë Bujqësore Korçë, me akuzën ‘Korrupsion aktiv në zgjedhje’. Ministri ka raportuar se nuk ka informacion të mëtejshëm nga Policia e Shtetit apo organi i prokurorisë, përveç asaj çfarë është njoftuar përmes medias.<sup>140</sup>

Në **Ministrinë e Mbrojtjes**, në **Ministrinë e Energjetikës dhe Industrisë**, në **Ministrinë e Punëve të Jashtme**, në **Ministrinë e Integritimit Evropian**, në **Ministrinë e Mjedisit**, në **Ministrinë e Kulturës**, , në **Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës**, në **Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes**, nga **Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike**, nga **Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin** nuk janë evidentuar raste të referuara në prokurori për vepra penale në fushën zgjedhore.

Ndërsa nga **Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore** nuk është sjellë asnjë informacion.

## **(ii) Rastet e referuara në Prokurori nga Policia e Shtetit**

Zëvendëskryeministri në cilësinë e drejtuesit të Task-Forcës, ka mbajtur një komunikim të vazhdueshëm me Policinë e Shtetit lidhur me veprimtarinë e Policisë së Shtetit për garantimin e sigurisë publike dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Duke filluar nga data 15.06.2017 deri në datën 24.06.2017 Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit i ka paraqitur Zëvendëskryeministrin informacion ditor për situatën e sigurisë kryesisht në drejtim të aktiviteteve zgjedhore të zhvilluara, numrin e forcave policore të angazhuara për ruajtjen e sigurisë dhe rendit në këto aktivitete dhe numrin e incidenteve të evidentuara.

Nga informacionet e mësipërme ka rezultuar se në shkallë vendi nga Drejtoritë Vendore të Policisë së Shtetit nga data 15 – 24.6.2017 janë konstatuar 34 (tridhjetekatër) incidente apo ngjarje që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor, për të

<sup>140</sup> Shih Raporti Përfundimtar i Monitorimit MABZHRAU, datë 24.07.2017, faqe 2.

cilat pas veprimeve paraprahe, materialet i janë referuar organit të prokurorisë për ushtrimin e ndjekjes penale.<sup>141</sup>

Policia e Shtetit ka informuar gjithashtu që ditën e zgjedhjeve janë evidentuar **25 vepra penale** që prekin zgjedhjet e lira dhe janë proceduar penalisht 27 persona, nga të cilët 7 të arrestuar, 10 në gjendje të lirë dhe 10 në kërkim.<sup>142</sup>

Policia e Shtetit ka raportuar se gjatë periudhës zgjedhore nga data 26 Maj deri 25 Qershor janë evidentuar 69 vepra penale, që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, nga të cilat është konstatuar një rast i policisë kufitare Durrës, arrestuar për shkak se i përfshirë në mbështetje të subjekteve zgjedhore si dhe tre raste të tjera të kapura në flagrancë dhe referuar në Prokurori. Sipas Policisë së Shtetit, të gjitha veprimet procedurale për veprat penale të mësipërme janë kryer nga punonjës të Policisë së Shtetit, jo vetëm nën mbikëqyrjen e superiorëve të strukturave policore, por në monitorimin dhe drejtimin e Prokurorëve të Prokurorisë së Rretheve Gjyqësore.<sup>143</sup> Nuk ka informacion të mëtejshëm nga ana e policisë së shtetit në lidhje me statusin e çdo çështjeje.

Ndërkohë, që Policia e Shtetit raporton për **69 raste të referuara në Prokurori**, për të cilat janë kryer të gjitha veprimet procedurale, Ministri i Punëve të Brendshme ka raportuar **484 denoncime që lidhen me vepra të ndryshme penale**, të parashikuara në nenet 332/a; 330; 329; 328/a; 329; 328 dhe 328/b të Kodit Penal, për të cilat i ka kërkuar Policisë së Shtetit t'i adresojë në organin e Prokurorisë.<sup>144</sup> Nga ana tjetër, referuar Aneksit nr. 3 bashkëngjitur raportimit të Ministrit të Punëve të Brendshme të dt. 10.07.2017, ka rezultuar *se janë shumë raste në të cilat Policia e Shtetit nuk ka ndjekur ngjarjet dhe personat e përfshirë të denoncuar nga qytetarët kryesisht për shitblerje vote apo intimidim dhe kërcënim të votuesve* në Kukës, Dibër, Durrës, Divjakë, Shkodër, Gjirokastrë, Pogradec, Krujë, Korçë, Kurbin, Sarandë, Delvinë, Ksamil, Tiranë.<sup>145</sup>

Gjithashtu, Ministri i Punëve të Brendshme sipas monitorimit të bërë ndaj veprimtarisë së Policisë së Shtetit ka raportuar se “...c) është vërejtur angazhim i punonjësve të Policisë së Shtetit me veprimet dhe mosveprimet e tyre, në mbështetje të

---

<sup>141</sup> Raporte ditore të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë nga data 15- 24 Qershor 2017.

<sup>142</sup> Shkresa e Policisë së Shtetit Nr. 879/4, datë 26.06.2017

<sup>143</sup> Po aty, faqe 5.

<sup>144</sup> Raporti i MPB i përcjellë përmes shkresës nr. 5474/1, datë 10.07.2017, faqe 1 dhe 2.

<sup>145</sup> Raporti i MPB i përcjellë përmes shkresës nr. 5474/1, datë 10.07.2017, **Aneksi III.**

*subjekteve politikë dhe/ose kandidatëve në këtë proces zgjedhor; d) Puna e Policisë së Shtetit në parandalimin e korrupsionit zgjedhor dhe angazhimit të grupeve kriminale në procesin zgjedhor, për shkaqe objektive dhe subjektive, ka qenë joefektive”.*<sup>146</sup>

### **(iii) Rastet e trajtuara dhe adresuara/kallëzuara në Prokurori nga Zyra e Zëvendëskryeministrit**

Zyra e Zëvendëskryeministrit gjatë ushtrimit të detyrës në periudhën 23.05.2017 dhe deri në ditën e zgjedhjeve ka referuar 10 (dhjetë) raste në prokurori për vepra penale që prekin zgjedhjet e lira. Këto raste kanë të bëjnë kryesisht për vepra penale të parashikuara nga neni 328 e Kodit Penal (Korrupsioni aktiv në zgjedhje), neni 325 i Kodit Penal (Pengimi i subjekteve zgjedhore), neni 248 i Kodit Penal (shpërdorimi i detyrës) etj.

1. Zyrtarët e Ujësjellës Kanalizime sh.a. Durrës (Punësime gjatë periudhës zgjedhore).
2. Zyrtarët e Hekurudha Shqiptare sh.a. (Punësime gjatë periudhës zgjedhore).
3. Zyrtarët e Albpetrol sh.a. (Punësime gjatë periudhës zgjedhore).
4. Zyrtarët e Posta Shqiptare sh.a. (Lëvizje masive të paargumentuara të punonjësve dhe punësime gjatë periudhës zgjedhore).
5. Zyrtarët e Ujësjellës Kanalizime sh.a. Tiranë (Punësime gjatë periudhës zgjedhore).
6. Kryetari i Bashkisë Vlorë (Pengim i subjekteve zgjedhore, shpërdorim detyre)
7. Drejtoresha e Postës Berat (pjesëmarrje në fushatë zgjedhore dhe ushtrim autoriteti ndaj punonjësve në favor të një subjekti elektoral).
8. 16 shtetas të identifikuar në Shkodër dyshuar për korrupsion aktiv në zgjedhje (shpërndarje parash)
9. 2 shtetas të pidentifikuar në Lushnjë dyshuar për korrupsion aktiv në zgjedhje (shpërndarje parash).
10. 15 shtetas të identifikuar në Korçë dyshuar për korrupsion aktiv në zgjedhje (shpërndarje parash).

Përveç sa më sipër, Zyra e Zv/Kryeministrit ka adresuar për hetim të mëtejshëm punësimet, shkarkimet dhe lëvizjet e tjera gjatë fushatës elektorale duke marrë indicie nga disa verifikime të bëra nga kjo zyrë, si dhe bazuar në informacionin e përcjellë nga DPT. Ky rast i diskutuar në Task-Forcë ku edhe është njoftuar adresimi

<sup>146</sup> Po aty, faqe 2.

në organin e Prokurorisë për vlerësim të mëtejshëm, është referuar nga Zyra e Zv/Kryeministrit në organin e Prokurorisë, por rezulton që prej disa ditësh shkresa nuk përcillet nga Zyra e Protokollit të Kryeministrit.

Për të gjitha rastet e referuara në Prokurori zyra e Zëvendëskryeministrit ka kërkuar informacion se në çfarë faze është hetimi. Deri në hartimin e këtij raporti ka kthyer përgjigje Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë në Durrës<sup>147</sup>, Lushnjë<sup>148</sup>, Fier<sup>149</sup> dhe Korçë.<sup>150</sup> Sipas këtij informacioni të ardhur konfirmohet që janë regjistruar procedimet penale dhe janë në fazën e hetimeve paraprake.

#### **(iv) Rastet e referuara në Prokurori nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë vendim për të kallëzuar penalisht 76 shtetas të cilët kanë kryer detyrën e numëruesit për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.06.2017 pasi është provuar që këta shtetas kanë konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 326 i Kodit Penal.<sup>151</sup>

### **J. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës me Policinë e Shtetit në funksion të marrjes së masave të menjëhershme kur konstatohen raste të sjelljeve apo veprimtarisë së paligjshme**

#### **(i) Koordinimi dhe bashkëveprimi i Task-Forcës me Policinë e Shtetit në ndjekjen e rasteve të caktuara gjatë fushatës zgjedhore**

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka qenë anëtar i Task-Forcës dhe ka pasur detyrimin të të marrë masa në drejtim të garantimit të zgjedhjeve të lira dhe vendosjes së të gjitha subjekteve elektorale në kushte të barabarta.

Task Forca gjatë gjithë kohë së funksionimit të saj ka mbështetur dhe inkurajuar Policinë e Shtetit, por nga ana tjetër ka kërkuar nga ana e saj një angazhim maksimal me qëllim garantim të një procesi të zgjedhjeve të lira për qytetarët shqiptarë si dhe krijimin e kushteve të barabarta për të gjitha subjektet elektorale që garojnë për Zgjedhjet e Kuvendit 2017.

<sup>147</sup> Shkresat e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me Nr. 3534 prot. dhe 3535/3, datë 10.07.2017.

<sup>148</sup> Shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë me nr. 3597/1 prot., datë 13.07.2017.

<sup>149</sup> Shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier me nr. 3544 prot., datë 13.07.2017.

<sup>150</sup> Shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë me nr. 3645/3 prot., datë 13.07.2017.

<sup>151</sup> Vendim nr. 550, datë 19.07.2017 i KQZ.

Sipas pikës 18 të VKM 473/2017, 'Strukturat e Policisë së Shtetit kanë detyrimin e bllokimit të automjeteve shtetërore të institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor për veprimtari të fushatës zgjedhore dhe të bënte referimin në organe kompetente për përdorimin e të mirave publike në favor të subjekteve zgjedhore.'

Sipas pikës 26 të VKM 473/2017 'Policia e Shtetit ka detyrimin t'i raportojë me shkrim Task-Forcës çdo rast kur konstatohet përdorim në procesin zgjedhor të mjeteve financiare të krijuara nga veprimtari të paligjshme.'

Sipas pikës 31/g të VKM 473/2017 'Policia e Shtetit ka detyrë të bashkëpunojë dhe bashkërendojë punën me Task-Forcën në funksion të marrjes së masave të menjëhershme në përputhje me ligjin kur konstatohen raste të sjelljeve apo veprimtarive të kundërligjshme gjatë procesit zgjedhor.'

Sipas pikës 25 të VKM 473/2017 'Çdo institucion shtetëror dhe institucion i pavarur, pjesë e Task-Forcës, raporton me shkrim periodikisht lidhur me zbatimin e masave të detyrave të ngarkuara, si dhe për problematikat e hasura gjatë procesit të monitorimit sipas këtij vendimi'

(A) Referuar detyrave të Policisë së Shtetit sipas pikës 18 të VKM 473/2017, nuk rezulton që në asnjë rast të jetë raportuar në Task-Force për raste të përdorimit të automjeteve shtetërore të institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor.

(B) Referuar detyrave të Policisë së Shtetit sipas pikës 26 të VKM 473/2017, ka rezultuar që në asnjë rast Policia e Shtetit të ketë raportuar për ndonjë rast të përdorimit në procesin zgjedhor të mjeteve financiare të krijuara nga veprimtari të paligjshme.

(C) **Raportimi ditor**

Në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga pika 25 të VKM 473/2017 ka rezultuar se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka raportuar sa herë i është kërkuar nga ana e Task-Forcës për çështje të caktuara dhe duke filluar nga data 15.06.2017 deri në datën 24.06.2017 Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit i ka paraqitur Zëvendëskryeministrit informacion ditor për situatën e sigurisë kryesisht në drejtim të aktiviteteve zgjedhore të zhvilluara, numrin e forcave policore të angazhuara për

ruajtjen e sigurisë dhe rendit në këto aktivitete dhe numrin e incidenteve të evidentuara.

**(D) Raportimi sipas kërkesës së Kryetarit të Task-Forcë dhe anëtarëve të Task-Forcës**

Në mbledhjet e Task-Forcës raportimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për situatën në përgjithësi, punën e Policisë së Shtetit dhe masat e marra lidhur me problematikat e ndryshme të dala gjatë periudhës së fushatës zgjedhore ka qenë i vazhdueshëm.

Drejtori i Policisë ka raportuar sa herë i është kërkuar nga ana e Task-Forcës në lidhje me raste të ndryshme të cilat ishin ndjekur, apo ishin në ndjekje nga ana e Policisë së Shtetit.

Në mbledhjen e datës 16 Qershor 2017, sipas kërkesës së subjektit elektoral LSI, Kryetarja e Task-Forcës i ka kërkuar Z. Çako informacion në lidhje me procedurat e ndjekura nga ana e Policisë së Shtetit në rastin Gjoza. Z. Çako ka raportuar në lidhje me rastin, duke njoftuar dhe regjistrimin e procedimit penal nga organi i Prokurorisë.<sup>152</sup>

Referuar kërkesave zyrtare të subjektit elektoral LSI në lidhje me kanosjen e drejtuesit të subjektit elektoral LSI, dega Berat si dhe për rastet e dhunës në Pukë, Fushë-Krujë, Lezhë dhe Fushë-Arrëz në mbledhjen e Task-Forcës të datës 20.06.2017 u raportua nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë në mënyrë shteruese për trajtimin e këtyre rasteve, duke marrë në konsideratë që akuzat ishin të drejtpërdrejta për implikimin e forcave të policisë në këto akte dhune. Z. Çako ka sqaruar që në të gjitha rastet ishin ndjekur procedurat sipas ligjit dhe për secilin rast ishte regjistruar procedim penal në Prokurori.<sup>153</sup> Në këtë mbledhje z. Çako ka pranuar se: *‘përgjegjësi e Policisë së Shtetit është moskryerja e veprimeve, mosidentifikimi i autorëve ose mosveprimi në ngjarje dhe në raste të tilla.’* dhe se në këtë rast strukturat e policisë kanë bërë detyrën e tyre.<sup>154</sup>

---

<sup>152</sup> Shih Proces Verbali i Mbledhjes së Dytë të Task-Forcës, datë 16.06.2017, faqe 36-39.

<sup>153</sup> Shih Proces Verbali i Mbledhjes së Tretë të Task-Forcës, datë 20.06.2017, faqe 2-5.

<sup>154</sup> Po aty, faqe 8.



Në mbledhjen e datës 20 Qershor, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka bërë raportim<sup>155</sup> në lidhje me rastet e identifikuar të shitblerjes së votës, duke listuar dhe dhënë detaje për rastet e shtetasve Ildir Frashëri, Drejtor i Spitalit Rajonal Berat dhe Gledion Rehovica deputet në Kuvendin e Shqipërisë për veprën penale ‘Detyrim pjesëmarrje në veprimtari politike’ dhe ‘Korrupsion pasiv në zgjedhje’; Elez Gjoza; Miklovan Kopani, Majual Zylfo, Arta Selamaj për veprat penale të ‘Korrupsionit aktiv në zgjedhje’; Pjetër Prendi për vepër penale ‘Korrupsion aktiv në zgjedhje’. Ndërsa Ministri i Punëve të Brendshme z. Demiraj ka pranuar se deri në atë ditë janë identifikuar 14 raste të shitblerjes së votës.<sup>156</sup>

Në këtë mbledhje Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka pohuar se deri në datë 19 Qershor ‘strukturat e Policisë së Shtetit nuk disponojnë asnjë informacion për përfshirje të ndonjë punonjësi policie në procesin zgjedhor apo bashkëpunimi me element kriminalë’<sup>157</sup>

**(E) Raportim lidhur me ngritjen e Task-Forcës së Policisë në nivel vendor dhe koordinimi me Ministrinë dhe institucionet e tjera të përfshira në proces monitorimi sipas VKM 473/2017**

Drejtori i Përgjithshëm ka raportuar në mbledhjen e Task-Forcës të datës 20 Qershor edhe lidhur me planin e masave operacionale të marra për trajtimin e incidenteve gjatë fushatës elektorale apo ditën e zgjedhjeve. Mbi bazën e Urdhrit nr. 222/17, datë 1.06. 2017 “Për krijimin dhe organizimin e grupeve të Task-Forcës në nivel vendor, në bashkëpunim me Prokurorinë, për ndjekjen dhe hetimin e veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, gjatë procesit zgjedhor në 25 Qershor 2017”.<sup>158</sup> Në këto kushte, Drejtori Çako ka pranuar se të gjitha Ministrinë dhe Institucionet e tjera që janë të përfshira në procesin e monitorimit referuar VKM 473/2017 mund të koordinohen me pikat e kontakteve në nivel vendor për të monitoruar apo ndjekur rastet që iu referohen. Z. Çako ka deklaruar që në nivel vendor Policia ka organizuar patrulla të cilat janë në ndjekje të aktiviteteve të ndryshme të paligjshme që dëmtojnë procesin zgjedhor.

Pavarësisht vullnetit të shprehur nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, nuk ka rezultuar që Ministrinë apo institucionet që kanë monitoruar sjelljen e administratës

<sup>155</sup> Shih raportimin përmes shkresës nr. 865, datë 19.06.2017, faqe 2-3.

<sup>156</sup> Shih Proces-Verbalin e mbledhjes së datës 20.06.2017, faqe 6.

<sup>157</sup> Shkresa nr. 865, dt. 19.06.2017 e DPPSH drejtuar Zëvendëskryeministrit, faqe 6.

<sup>158</sup> Shkresa nr. 865, dt. 19.06.2017 e DPPSH drejtuar Zëvendëskryeministrit.

apo raste të tjera sipas VKM 473/2017 të kenë gjetur bashkëpunimin në kohë reale për të siguruar identifikimin e autorëve në rastet që janë denoncuar nga qytetarë apo subjekte elektorale dhe po ndiqeshin nga Ministritë apo Institucionet, punonjës të cilëve ishin përfshirë në fushatë elektorale në kundërshtim me ligjin. Këtu duhet sqaruar se denoncimi ishte përmes fotove të cilat shpesh herë ishte e pamundur që të verifikoheshin nga Ministritë për shkak largësisë apo shkaqe të tjera dhe në këto kushte, kur kishte *indicie*, ishin strukturat e policisë në nivel lokal që mund të koordinonin dhe mbështesnin në identifikimin e këtyre autorëve deri në kapjen në flagrancë të tyre. Kjo gjë nuk ka funksionuar në përgjithësi dhe në rastin më të mirë ka funksionuar në raste të rralla.

**(F) Detyrat e Policisë së Shtetit sipas planit të masave operacionale të miratuara në mbledhjen e Task-Forcës, datë 23 Qershor 2017**

Në mbledhjen e Task-Forcës të datës 23.06.2017<sup>159</sup> në agjendë ishte diskutimi i “Planit të masave operacionale”. Këto masa kishin si qëllim koordinimin sa më të mirë mes institucioneve, me qëllim ndjekjen e rasteve të cilat do të çënonin procesin zgjedhor në kuptim të përfshirjes së administratës në shitblerje të votës dhe intimidim të votuesve, apo edhe të forcave të policisë në mbështetje në subjekteve elektorale dhe bashkëpunimit me elementë kriminalë.

Referuar planit të masave operacionale, në Zyrën e Kryetarit të Task-Forcës ishte vendosur një pikë kontakti (nr. telefoni) nëpërmjet të cilit të gjitha subjektet elektorale ishin të ftuar të denonconin përfshirjen e administratës dhe Policisë së Shtetit në veprimtari të paligjshme në ditën e zgjedhjeve dhe gjatë procesit të numërimit.

Në të njëjtën kohë ishte krijuar një portal për të gjithë qytetarët për denoncimin e rasteve sa më sipër.

Gjithashtu, parashikohej që të gjitha Ministritë do të bënin njoftime përmes medias që t’i ftonin qytetarët të denonconin raste të tilla, të cilat më pas do të referoheshin në Polici për verifikime të mëtejshme dhe ndjekjen e procedurave sipas ligjit. Në çdo Drejtori Policie në Qark do të vendosej një pikë kontakti që do të trajtonte rastet e

---

<sup>159</sup> Shih Proces- Verbalin e Task-Forcës, datë 23.6.2017.

referuara nga Task-Forca. Përveç sa më sipër, parashikohej shtimi i masave të sigurisë në pikat kufitare doganore nga ana e Policisë së Shtetit.<sup>160</sup>

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka deklaruar se Policia e Shtetit është në gatishmëri dhe janë marrë të gjitha masat për monitorimin e procesit zgjedhor. ***Për sa i përket çështjes së përfshirjes së punonjësve të administratës në veprime të kundërligjshme të shitblerjes së votës apo të ushtrimit të presionit ndaj votuesve***, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit deklaroi se ‘*Policia ka të gatshëm informacionin, për të gjitha rastet e përfshirjes të administratës. Ky informacion vazhdon çdo moment të përditësohet..... Sektori i Krimit Ekonomik merret me çështjen e korrupsionit-aktiv, me problemin e shitblerjes së votës ose të veprimeve të tjera.*’<sup>161</sup>

Z. Çako ka garantuar se sipas ligjit do të veprojnë Forcat Speciale dhe Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë si dhe ka raportuar se në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë është ngritur dhe funksionon *Qendra e Koordinimit të Procesit Zgjedhor, e cila bën të mundur përpunimin dhe marrjen e të gjithë informacionit, që vjen nga qytetarët dhe Task Forca* dhe funksionon 24 orë për të gjitha institucionet, për të gjithë administratën e shtetit Shqiptar, por dhe për të gjitha informacionet si dhe ka bërë me dije përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të saj. Nga ana tjetër Z. Çako ka njoftuar që në bashkëpunim me Prokuroritë e rretheve gjyqësore janë ngritur *Task-Forca me oficerë policie gjyqësore për të vepruar në kohë reale ndaj çdo veprimi apo çdo informacioni në terren, me qëllim që më pas vlerësimet t’i bëjë prokuroria.*<sup>162</sup>

Sipas Planit të Masave Operacionale të miratuara në mbledhjen e datës 23 Qershor 2017, Ministria e Punëve të Brendshme, të ushtrorë kontrole me grupet e veta, për monitorimin e punës së policisë, të Gardës së Republikës dhe një monitorim të veprimtarisë të subjekteve të skeduar si kriminale, të cilat janë informacione për ministrin e Punëve të Brendshme dhe për Policinë e Shtetit.<sup>163</sup>

#### **(G) Raportimi në ditën e zgjedhjeve datë 25.06.2017 (ora 17:00 – 18:30)**

Në mbledhjen e Task-Forcës të mbajtur ditën e zgjedhjeve, pra në datë 25.6.2017, mbledhje, e cila u thirr me qëllim raportimin nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të

<sup>160</sup> Shih Proces-Verbalin e Task-Forcës, datë 23.06.2017, faqe 4.

<sup>161</sup> Po aty, faqe 9.

<sup>162</sup> Po aty, faqe 7-8.

<sup>163</sup> Shih Planin e Masave Operacionale.

Policisë në lidhje me rastet e referuara nga Ministrinë dhe nga Zyra e Zëvendëskryeministrit.

Në mungesë të z. Çako, ka raportuar z. Altin Qato, Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm Policisë së Shtetit, ku gjatë mbledhjes përveç sa më sipër u ngritën shumë problematika në lidhje me punën e Policisë së Shtetit, si më poshtë vijon:

- Nga 20 rastet e referuara nga ana e zyrës së Zëvendëskryeministrit vetëm dy raste ishin trajtuar nga ana e Policisë së Shtetit, pavarësisht vullnetit të shprehur të një dite më parë për koordinim dhe angazhim maksimal të trajtimit të rasteve një ditë më parë. Z. Qato është justifikuar me ngarkesën e madhe të informacionit dhe ka deklaruar se: *'..... më pas... ne kemi ndjekur edhe dinamikën e sigurisë në territor. Kodi Zgjedhor e kufizon hapësirën e punonjësve të policisë për të patrulluar në qytete. Ky është një problem, sepse gjatë punës të vijnë shumë njoftime, por punonjësi i policisë e ka të pamundur për të shkuar kudo dhe pika kryesore për të shkuar në qendër të votimit bëhet me kërkesë zyrtare nga qendra e votimit ose nga KZAZ.'* Gjatë diskutimit, referuar paqartësisë nga ana e z. Qato, është vënë në dyshim nëse forcat e policisë kanë dalë në territor dhe nuk kanë shkuar në ambientet përreth qendrave të votimit.<sup>164</sup> Z. Qato në mbledhje deklaroi se: *'... Pasi fillon procesi i votimit, këto forca, në zbatim të ligjit duhet të grupohen në vendbanimi që njoftojnë KQZ-në. Nuk mund t'i lë në patrullim në çdo moment, pas çdo njoftimi shkojmë, por jo pas çdo njoftimi do ta gjej, pasi nga momenti i njoftimit do pak kohë që të shkosh, por unë nuk kam forca që t'i nxjerr në patrullim, sepse nuk ma lejon ligji.'*<sup>165</sup>
- Në ora 17:00, të datës 25 .06.2017, z. Qato ka pranuar se nuk mund të tregonte një shifër për raste e trajtuara të përfshirjes së administratës në shit-blerje vote dhe kjo për efekt kohe, duke pretenduar se 37 raste janë adresuar nga Task-Forcë dhe janë kthyer 27 përgjigje, ndërkohë që ky informacion nuk duket të jetë i vërtetë, në një kohë veç zyra e Zëvendëskryeministrit kishte adresuar 20 raste dhe kishte marrë përgjigje veç për dy raste.<sup>166</sup>
- U referuan raste konkrete të denoncimeve për përfshirje të punonjësve të policisë në mbështetje të subjekteve të caktuara politike. Sipas Ministrisë të Punëve të Brendshme këto raste të identifikuara ishin 29 (njëzetënëntë) të cilët

<sup>164</sup> Proces-Verbali datë 25 .06.2017, faqe 6.

<sup>165</sup> Proces-Verbali datë 25 .06.2017, faqe 11.

<sup>166</sup> Po aty, faqe 9-14.

janë në proces verifikimi. Personat që denoncohen janë punonjës policie të të gjitha niveleve.<sup>167</sup>

- U referuan raste konkrete të denoncimeve për implikime të punonjësve të policisë në mbështetje të personave apo grupeve kontingjent kriminal. Sipas Ministrit të Punëve të Brendshme këto raste të identifikuar ishin 7 (shtatë) në Delvinë, Sarandë, Dibër, Pukë, Lezhë, Tiranë, të cilët janë në proces verifikimi. Personat që denoncohen janë policë të të gjitha niveleve, madje edhe drejtorë policie në qarqe. Nga Ministri i Punëve të Brendshme u pranua fakti se ka kërkuar shkarkimin e 2 apo 3 shefave të komisariateve, por një masë e tillë nuk ishte marrë. Z. Qato ka qenë i painformuar për këto raste, duke pranuar se nuk është linja e tij.<sup>168</sup>
- U pranua mundësia e rrjedhjes së informacionit nga Drejtoritë Rajonale të Policisë, për sa kohë që shefa komisaratesh janë të implikuar me element kriminalë dhe policë në mbështetje të subjekteve elektorale. Zëvendësdrejtori i Policisë pranoi mundësinë se këto raste mund të ekzistojnë dhe po verifikohet informacioni për të nxjerrë përgjegjësitë.<sup>169</sup>
- U referuan raste të shitblerjes së votës të ekzekutuara, të kapjes në flagrancë, të referuara në Prokurori. Z. Qato ka dështuar të japë shifra të sakta, ndërkohë që Ministri i Punëve të Brendshme nuk e ka justifikuar mungesën e informacionit në mbledhjen e Task –Forcës referuar angazhimit të DPPSH në dt.23.06.2017.<sup>170</sup>
- U diskutua për mënyrën e monitorimit të punës së policisë nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme që sipas MB ishte realizuar përmes komunikimit me të gjitha strukturat si dhe përmes denoncimeve. Sipas ministrit ka pasur raste mangësie në Komisariate të ndryshme dhe gatishmëria nuk ka qenë e duhur, apo niveli i kontrollit të territorit. Ka pasur persona të armatosur, që lëviznin në qendër të qytetit (në Lezhë kishte persona me precedent kriminal që lëviznin lirshëm para Komisarariatit) etj. Këto raste janë adresuar tek Drejtori i Përgjithshëm, i cili do ti vlerësojë dhe do të marrë masat përkatëse.<sup>171</sup>
- Rastet e kapura në flagrancë me denoncimet e bëra janë shumë të vogla. Nuk ka qenë e mundur të monitorohet nga MB nëse kanë shkuar në vend forcat e policisë.<sup>172</sup>

---

<sup>167</sup> Shih Proces- Verbalin e Mbledhjes së Task-Forcës datë 25.6.2017, faqe 17.

<sup>168</sup> Po aty, faqe 19-21.

<sup>169</sup> Po aty, faqe 23.

<sup>170</sup> Po aty, faqe 24.

<sup>171</sup> Po aty, faqe 25.

<sup>172</sup> Po aty, faqe 25.

- U diskutua lidhur me masat shtesë që mund të merren për garantimin deri në fund të procesit të votimit. Propozimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme ishte marrja e masave përforcuese menjëherë në disa qarqe, në Lezhë, Shkodër, Elbasan, Berat, të dërgohen njësi speciale, ose grupe të ndërhyrjes në mënyrë që të rritet prezenca e Policisë dhe siguria në drejtim të parandalimit.<sup>173</sup>

DPPSH ka raportuar në datë 6 Korrik 2017 se në ditën e votimit u angazhuan 5851 punonjës të policisë për ruajtjen e objekteve zgjedhore në të gjithë Shqipërinë, si dhe 1356 punonjës policie nga njësitë policore në Tiranë dhe Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit sipas një plani shpërndarje, me qëllim garantimin e rendit publik në të gjithë territorin e vendit, në mënyrë që votuesit shqiptarë të mos ndjeheshin të intimiduar, kërcënuar apo nën presion para, gjatë apo mbas votimit si dhe në sigurimin e objekteve zgjedhore.<sup>174</sup>

*Por pavarësisht këtij angazhimi, referuar sa më sipër, është e dukshme që mekanizmi i ngritur nuk ka qenë efektiv. Është dhënë informacion minimal për rastet e referuara nga Ministri dhe Zëvendëskryeministri dhe ka rezultuar se procesi mund të konsiderohej i cënuar si rezultat i ekzistencës së elementëve kriminalë në mbështetje të subjekteve kriminale, në bashkëpunim me forcat e policisë.*

#### **(H) Adresimi i rasteve të ndryshme nga zyra e Zëvendëskryeministrit**

Zyra e Zëvendëskryeministrit në cilësinë e drejtuesit të Task-Forcës, në zbatim të detyrave të lëna në mbledhjet periodike të Task-Forcës ka administruar dhe ndjekur raste të denoncimeve të ndryshme të ardhura drejtpërdrejt në këtë zyrë, dhe kur është konsideruar e nevojshme ia ka përcjellë ato për ndjekje Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Këto denoncime/njoftime kanë konsistuar kryesisht në raste të referuara për korrupsion aktiv në zgjedhje, vënie në dispozicion e asetëve publike për subjekte të caktuara, përfshirje e administratës publike në fushatë zgjedhore për subjekte të caktuara etj.

<sup>173</sup> Po aty, faqe 28.

<sup>174</sup> Shih shkresa nr. 879/9, dt.6.07.2017 e DPPSH drejtuar Zv/Kryeministrit.

Konkretisht nga zyra e Task-Forcës është kërkuar bashkëpunimi dhe veprimi i Policisë së Shtetit për një sërë rastesh të ardhura në adresë tonë si më poshtë:

- Shoqëria tregtare “Victoria Invest sh.p.k.”, ka paraqitur ankesa zyrtarisht sipas të cilave, pretendohet se anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në Bashkinë Librazhd dhe anëtarët e Komisionit të Prokurimeve Publike, kanë marrë vendime në kundërshtim flagrant me ligjin me qëllim që të favorizojnë operatorë ekonomikë (shoqëri tregtare) të caktuar të cilët janë shumë pranë një subjekti zgjedhor. Dy ankesat e shoqërisë në fjalë, janë të shoqëruara me fotografi të aktiviteteve të ndryshme politike ku evidentohet pronari i një subjekti konkurrues i shpallur fitues në një tender të **Bashkisë Librazhd**, kundrejt të cilit është paraqitur ankesa.

Ky rast i është referuar për kompetencë dhe hetime të mëtejshme Drejtorit të Policisë së Shtetit, *por që nuk ka asnjë përgjigje në lidhje me procedurat e ndjekura.*

- Zyra e Zëvendëskryeministrit ka marrë një kallëzim nga z. Nesti Nestor sipas të cilit pretendohet se zyrtarë të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, e kanë kërcënuar dhe kanë kryer veprime arbitrare në dëm të biznesit të tij, për shkak se ai nuk është angazhuar në fushatë zgjedhore në favor të një subjekti të caktuar politik.

Për këtë arsye, zyra e Zëvendëskryeministrit i ka përcjellë për kompetencë dhe hetime të mëtejshme Drejtorit të Policisë së Shtetit, *por akoma sot nuk ka një përgjigje për procedurat e ndjekura dhe për rezultatin.*

- Zyra e Zëvendëskryeministrit në cilësinë e drejtuesit të Task-Forcës së ngritur në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 473, datë 1.06.2017, mori njoftime nga subjekte të ndryshme elektorale të regjistruara për të marrë pjesë në zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2017 dhe individë, se në territorin e Bashkisë Durrës dhe me konkretisht në zonën e Kënetës janë evidentuar disa objekte në ndërtim e sipër të cilat pretendohej që janë zhvilluar pa leje në këtë periudhë e cila përkonte me periudhën zgjedhore.

Për këtë arsye, Zyra e Zëvendëskryeministrit i ka kërkuar zyrtarisht Policisë së Shtetit<sup>175</sup> të bëjë verifikimet e duhura në bazë të informacioneve të ardhura për problemin e pretenduar, si dhe të merrte masat e nevojshme në bashkëpunim me Inspektoratin Kombëtar të Kontrollit të Territorit.

*Policia e Shtetit ka kthyer përgjigje për këtë rast, duke vënë në dijeni Zyrën e Zv/Kryeministrit se ka bërë verifikimet e duhura dhe më pas janë marrë masat ligjore për procedimin penalisht për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a i KP ‘Ndërtim i Paligjshëm’ shtetasit Linë Tom Rogaj, Gramos Shefit Bici, Sokrat Hate Ziu, banues në lagjen 16/1, Durrës dhe materialet procedurale i kanë kaluar Prokurorië pranë Gjykatës së Rrathit Gjyqësor Durrës.*<sup>176</sup> Në vijim Policia nuk ka njoftuar në lidhje me hetimin e mëtejshëm dhe vendimmarrjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Për një rast të ngjashëm në Qarkun e Elbasanit Policia e Shtetit solli njoftim pranë Task-Forcës që kishte bërë bllokimin e disa mjeteve dhe kishte shoqëruar në komisariatit e policisë disa shtetas të cilat po bënin punime pa leje në një zonë të caktuar.

- Zëvendëskryeministri gjatë mbledhjes së Task-Forcës së datës 23.06.2017 i ka përcjellë DPPSH një shqetësimi të ngritur nga subjekti elektoral PD<sup>177</sup>, për materiale propagandistikë të vendosura në kundërshtim me udhëzimin e KQZ dhe që Bashkia Peshkopi nuk kishte marrë masa dhe për një numër makinash të identifikuar dhe të verifikuara si makina pa dokumentacionin e duhur ligjor, të cilat lëviznin me postera dhe flamuj të PDIU nëpër qytet në prani të forcave të policisë së shtetit. Gjithashtu, në shkresën e subjektit elektoral pretendohej që punonjësit e policisë po qëndrojnë në një zyrë elektorale të PDIU në fshatin Muhur.<sup>178</sup>

Policisë iu kërkuua që të merreshin masa për të bërë verifikime dhe bllokimin e tyre në rast të konstatimit të mungesës së dokumentacionit ligjor.

Për këtë rast është kthyer përgjigje nga Policia e Shtetit duke dhënë informacion për automjete të cilat nuk ishin në materialin që i është përcjellë Policisë së Shtetit për ndjekje, duke pretenduar që këto automjete janë bllokuar nga Drejtoria

<sup>175</sup> Shkresa e Zv/Kryeministrit drejtuar Policisë së Shtetit nr. 3416 Prot., datë 13.06.2017.

<sup>176</sup> Shkresa nr.4671/1 prot, datë 28.07.2017 e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit drejtuar Zv/Kryeministrit në përgjigje të shkresës nr. 3416.prot, datë 13.06.2017.

<sup>177</sup> Proces verbali i mbledhjes së Task-Forcës datë 23.06.2017, faqe 17.

<sup>178</sup> Shih shkresë nr.12/2, datë 16.06.2017 e subjektit elektoral PD drejtuar Zv/Kryeministrit.



Vendore e Policisë së Qarkut Dibër. Rastet e trajtuara nga policia nuk janë ato për të cilat ishte bërë denoncimi.<sup>179</sup> Gjitashtu, policia e shtetit në lidhje me denoncimin e efektivit të policisë nuk ka kthyer përgjigje, por e ka trajtuar si denoncim të mjetit pa dokumeta të rregullta, ndërkohë që fotot tregonin efektivin e policisë në zyrën elektorale të PDIU.

Në vijim Policia e Shtetit ka trajtuar dhe dy foto të tjera, të cilat nuk ishin objekt i ankimit të subjektit elektoral PD në kërkesën e tij drejtuar Task Forcës.

Pra, si rezultat Policia e Shtetit nuk ka arritur t'i kthejë përgjigje kërkesës konkrete të paraqitur nga subjekti elektoral në Task Forcë.

## **(ii) Implikimi i forcave të policisë në mbështetje të subjekteve elektorale dhe bashkëpunim me elementët kriminalë**

### **A. Implikimi i forcave të policisë në mbështetje të subjekteve elektorale**

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, në përgjigje të kërkesës së Zëvendëskryeministrit ka dërguar zyrtarisht informacion shkresor në datën 19.06.2017 ku sqarohet se deri në atë moment strukturat e Policisë së Shtetit nuk disponojnë asnjë informacion për përfshirje të ndonjë punonjësi policie në procesin zgjedhor apo bashkëpunimi me elementë kriminalë.<sup>180</sup>

Ndërkohë, Ministria e Punëve të Brendshme ka konstatuar një numër të shumtë rastesh ku punonjësit e policisë së shtetit janë përfshirë në mbështetje të subjekteve elektorale. Ministri i punëve të Brendshme në mbledhjen e datës 25.06.2017 të Task-Forcës referoi raste konkrete të denoncimeve për përfshirje të punonjësve të policisë në mbështetje të subjekteve të caktuara politike. Sipas Ministrit të Punëve të Brendshme këto raste të identifikuar ishin 29 (njëzetënëntë). Personat që denoncohen janë punonjës policie të të gjitha niveleve.<sup>181</sup>

<sup>179</sup> Shih shkresë nr.878prot, datë 24.06.2017 e DPPSH drejtuar Zv/Kryeministrit.

<sup>180</sup> Shih shkresën nr. 865, datë 19.6.2017 të DPPSH, faqe 6.

<sup>181</sup> Procesverbal i mbledhjes së Task-Forcës datë 25.6.2017 faqe 17.

Ndërsa, sipas informacionit të sjellë nga Ministria e Punëve të Brendshme në Raportin Përfundimtar<sup>182</sup>, rezulton se janë referuar 32 (tridhjetedy) punonjës të policisë të përfshirë në fushatë elektorale, duke shpërdoruar autoritetin policor në rastet si më poshtë:

1. Roni Shqopa, Drejtor i Konvaleshencës në MPB, në bashkëpunim me Vangjush Dakon, Kryetar i Bashkisë Durrës, ka vepruar në zonat Spille dhe Plazh.
2. Oficeri i policisë Fatmir Davidhi, me detyrë Shefi i Stacionit të Policisë në Rroskovec, është përfshirë në fushatë duke shpërndarë lekë së bashku me kandidatin e PS-së Anduen Xhindi.
3. Oficeri i policisë Alfred Velçani, efektiv i Drejtorisë Vendore të Policisë Berat, është përfshirë në mënyrë të paligjshme në procesin zgjedhor duke qënë prezentë në QV 2911 Rrapëz Sektor, në Njësinë Administrative Kolonjë të Lushnjës, ndërkohë që ky oficer policie ditën e zgjedhjeve sipas shërbimit zyrtar duhet të ishte me shërbim në Tepelenë. Është rast i dokumentuar edhe me fotografi.
4. Oficeri i Policisë, Astrit Jella punonjës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, i përfshirë në fushatë duke shpërdoruar autoritetin policor.
5. Specialisti i SH.Ç.B.A në Durrës, Fatos Hasani, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
6. Specialist i SH.Ç.B.A në Shkodër, Arben Dekovi i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
7. Shefi Komisarariatit të Peshkopisë Admir Trupja, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
8. Shefi i Komisarariatit të Pukës, Pal Marku, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
9. Shefi Komisarariatit Gramsh, Alfred Maksuti, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
10. Oficeri i Policisë në Drejtorinë Vendore Korçë, Alfred Dumani, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
11. Shefi Komisarariatit Maliq, Gentian Diko, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
12. Shefi i Komisarariatit Nr. 4 Tiranë, Agim Hoxha, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.

<sup>182</sup> Shih Aneksin 1 në Raportin Përfundimtar nr. 5474/1, datë 10.7.2017 të MPB.

13. Shefi i Komisarariatit Nr. 5 Tiranë, Sali Skura, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
14. Shefi i Komisarariatit Kavajë, Aliosha Brokaj, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
15. Shefi i Komisarariatit Elbasan Zija Sula, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
16. Shefi i Komisarariatit të Kufirit, Sarandë, Përparim Xhaferi, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
17. Zëvendës drejtori i Policisë Vendore Vlorë, Sokrat Gode, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
18. Shefi i Komisarariatit Shkodër, Hamdi Shullani, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
19. Ish Shefi i Komisarariatit Rinas Ermal Milori.
20. Shefi i Rendit i Komisarariatit të Policisë, Rinar Altin Zeka, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
21. Lektori në Akademinë e Sigurisë, Boge Bodini, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
22. Specialisti për Hetimin e Krimeve Veli Alliraji, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
23. Shef i trafikeve në Policinë Vendore Fier Hysen Bajrami, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
24. Shefi i Financës në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve, Ramadani Smulja, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
25. Operator në Qarkullimin Rrugor Erjola Smulja.
26. Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit, Ernest Dimashi, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
27. Shef i Komisarariatit të Lushnjës, Eduard Sulejmani, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
28. Oficeri Policisë në Drejtorinë Vendore Vlorë, Shpëtim Kripa, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
29. Drejtori i Policisë Korçë, Arben Skëndo, ish Drejtor i SHÇBA, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
30. Drejtori Policisë Shkoder, Gjovalin Loka, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
31. Oficeri i Policisë Naim Doçi, punonjës në Komisariatin e Policisë Durrës, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.
32. Oficeri i policisë Nexhmi Kaliaj në Drejtorinë Vendore të Policisë

Korçë, i përfshirë në fushatë ka shpërdorur autoritetin policor.  
**33.** Drejtor i INUK Korçë, Enver Shahinas i përfshirë në shitblerje votash në Korçë.

Policia e Shtetit nuk ka dhënë informacion për trajtimin e këtyre rasteve, nëse janë në verifikim, nëse janë referuar në Prokurori apo janë marrë masa disiplinore. Në mbledhjen e datës 25 Qershor 2017 të Task-Forcës, Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka thënë që janë në verifikim e sipër, por në raportin e datës 06.07.2017 nuk ka raportuar asgjë në lidhje me denoncimet ndaj efektivëve të policisë si dhe procedurat e ndjekura për trajtimin e këtyre rasteve, duke mos bërë transparencën e duhur me Task-Forcën.

Institucione të tjera nuk kanë raportuar për përfshirje të punonjësve të policisë në mbështetje të subjekteve elektorale.

**B. Implikimi i efektivëve të policisë në mbështetje të subjekteve elektorale në bashkëpunim me elementë kriminalë.**

Në mbledhjen e datës 25 Qershor 2017, Ministri i Punëve të Brendshme ka pranuar se në 7 raste të denoncimeve të efektivëve të policisë të cilët janë të implikuar me elementë kriminalë, të cilat kanë ndodhur 2-3 ditë përpara zgjedhjeve në Delvinë, Sarandë, Dibër, Pukë, Lezhë dhe Tiranë dhe i përkasin të gjitha niveleve, nga më i lartë duke filluar nga drejtor qarqesh e poshtë.<sup>183</sup> Vetë Ministri i Brendshëm ka deklaruar që në bazë të këtyre informacioneve ka kërkuar dhe shkarkimin apo pezullimin e tre shefave të komisariateve, dhe meqë kjo nuk ishte realizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë nuk kishte vijuar me propozimin për lëvizje të tjera.<sup>184</sup> Avokati i Popullit gjatë kësaj mbledhje ka deklaruar se *'nëse kemi të bëjmë me raste të tilla, atëherë dëmi është tepër i madh'*. Më tej Avokati i Popullit është shprehur se *'... kjo Task-Forcë duhet të rriste besimin tek qytetarët tek zgjedhjet e lira...'*. Në këtë mbledhje pavarësisht insistimit, në asnjë rast nuk është bërë e mundur që të verifikohet dhe të merret informacion në lidhje me këta efektivë të policisë të cilët bashkëpunojnë me elementë kriminalë dhe mbështesin subjekte të caktuara elektorale. Më tej Ministri i Brendshëm ka informuar që në Lezhë 2 ditë para zgjedhjeve elementë kriminalë lëviznin të armatosur dhe Komisariati nuk u gjet në nivelin e duhur të gatishmërisë, ndërkohë që denoncimet ishin kohë më parë për situatë të tillë dhe Drejtori i

<sup>183</sup> Proces-Verbal i Task-Forcës datë 25.06.2017, faqe 18.

<sup>184</sup> Po aty, faqe 19.

Përgjithshëm i Policisë nuk kishte marrë asnjë masë. Është e qartë, që në kushte të tilla dëmi ishte bërë dhe procesi zgjedhor nuk mund të garantohet. Kjo është pranuar nga Ministri i Brendshëm, i cili përgjegjësinë në lidhje me këtë e ka kërkuar tek Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, i cili nuk ka marrë masa për të ndryshuar situatën.<sup>185</sup> ***Drejtori i Përgjithshëm i Policisë në raportimin e tij të datës 06.07.2017 nuk ka dhënë asnjë sqarim për këto 7 efektive policie të nivelit të lartë për të cilët ka pasur informacione se kanë lidhje me elementë kriminalë.***

Ndërkohë z. Çako ka raportuar se ditën e votimit nuk është konstatuar asnjë rast që punonjës policie me gradë policore, administrative apo me status të punonjësit civil të jenë implikuar në shkelje të ligjit apo të pozicionit ligjor të tyre dhe ka raportuar 0 efektive policie të lidhur me elementë kriminalë.<sup>186</sup> Ndërsa Ministri i Brendshëm ka raportuar se: 'b) Janë angazhuar grupime të njohura kriminale në mbështetje të subjekteve politike në garën elektorale, veçanërisht në rajonin e Dibrës, Elbasanit, Lezhës, Shkodrës etj.; d) Puna e Policisë së Shtetit në parandalimin e korrupsionit zgjedhor dhe angazhimit të grupimeve kriminale në procesin zgjedhor, për shkaqe objektive dhe subjektive, ka qenë jo efektive.'<sup>187</sup>

Ministri i brendshëm ka raportuar se për sa i përket përfshirjes së paligjshme të Policisë së Shtetit në procesin zgjedhor në mbështetje të subjekteve politike, denoncimet i janë përcjellë për ndjekje SH.C.B.A Policisë Shtetit dhe Gardës së Republikës dhe si rezultat është arrestuar një punonjës policie, janë liruar nga detyra dy punonjës të strukturave të MPB një oficer policie dhe një oficer i Gardës Republikës si dhe transferuar një oficer policie. Ministri Demiraj ka propozuar për t'u transferuar si të përfshirë në shpërdorimin e autoritetin policor tre drejtues të lartë të Policisë së Shtetit në funksionin e shefit të komisariatit të Policisë (Pukë, Gramsh, Dibër), ndërkohë që Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka refuzuar pezullimin dhe zëvendësimin e tyre.<sup>188</sup>

### **(iii) Shitblerja e votës gjatë fushatës elektorale dhe ditën e votimit**

Policia e Shtetit përmes Drejtorit të Përgjithshëm ka raportuar në lidhje me rastet e shitblerjes së votës në mbledhjen e datës 20 Qershor 2017 dhe më pas në mbledhjen e datës 25 Qershor 2017, janë denoncuar mjaft raste të shitblerjes së votës. Z. Qato në raportimin e

<sup>185</sup> Po aty, faqe 26-27.

<sup>186</sup> Shkresa nr.879/9, datë 06.07.2017, faqe 4.

<sup>187</sup> Shkresa nr. 5474/1, datë 10.07.2017 e MPB drejtuar Zv/Kryeministrit, faqe 2.

<sup>188</sup> Po aty.

bërë në datë 25.06.2017, ka raportuar 10 raste të shitblerjes së votës, ndërkohë që denoncimet kanë qenë pa fund.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, në raportimin e bërë në datë 26.06.2017, përmes shkresës nr. 679/4 ka evidentuar 25 vepra penale që lidhen me procesin zgjedhor, ku janë proceduar gjithsej 27 persona, nga të cilët 7 të arrestuar, 10 në gjendje të lirë dhe 10 në kërkim. Nga këto vepra penale, z. Çako ka raportuar 10 raste të shitblerjes së votës sipas cilësimit 'Korrupsion aktiv në zgjedhje' neni 328 i KP.<sup>189</sup>

Për datën 25 Qershor 2017, Policia ka raportuar se 18 nga 25 rastet e evidentuara nga policia e shtetit janë referuar në organin e Prokurorisë, ku për 10 rastet e evidentuara të shitblerjes së votes rezulton që në dy raste është bërë arrest në flagrancë dhe në rastet e tjera është bërë referimi në organin e Prokurorisë.

Në raportimin e bërë nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë nuk është përcaktuar një shifër e saktë e rasteve të shitblerjes së votës gjatë fushatës elektorale të proceduara nga Policia e Shtetit, ndërkohë që kanë rezultuar **315 denoncime**.<sup>190</sup> Në raportimin e datës 21 Qershor 2017, MPB sipas Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit ka raportuar **6 raste për shitblerje vote** gjatë fushatës elektorale. MPB ka pranuar se *'janë angazhuar në mënyrë masive burime të dyshimta financiare në shit-blerjen e votës nga subjekte politike soe persona të lidhur me këto subjekte.'*<sup>191</sup>

Ndërkohë që Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka raportuar për 3 (tre) raste të konstatuara dhe të referuara për përdorim të parasë në mbështetje të subjekte zgjedhorë nga ana e egfektivëve të Policisë së Shtetit, të cilat janë kapur në flagrancë dhe referuar në Prokurori.<sup>192</sup>

#### ***A. Denoncimi pranë Zyrës së Zëvendëskryeministrit për shitblerje vote dhe implikimin e elementëve kriminal në këtë veprimtari***

Gjatë periudhës zgjedhore në adresë të zyrës së Zëvendëskryeministrit ka ardhur një numër i madh ankesash dhe informacionesh në lidhje me fenomenin e shitblerjes së votës dhe implikimin e elementëve kriminal në këtë veprimtari.

---

<sup>189</sup> Shih shkresë nr. 679/4, datë 26.06.2017 e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit drejtuar Zv/Kryeministrit, faqe 1 dhe tabela shoqëruese.

<sup>190</sup> Shih shkresa nr. 5287/1, datë 28.06.2016 e MPB drejtuar Zv/Kryeministrit, faqe 1.

<sup>191</sup> Shih shkresa nr.5474/1, datë 10.07.2017 (ANEKS VI) i MPB, faqe 2.

<sup>192</sup> Shih Shkresa nr. 4995/2, datë 21.06.2017 e DPPSH drejtuar Zv/Kryeministrit, faqe 1.

Rastet e denoncimeve në rend kronologjik të cilat kanë ardhur pranë zyrës së Zëvendëskryeminitrit vetëm për datën 24 dhe 25 Qershor janë si më poshtë:

1. Ka ardhur informacion që në fshatin Cas dhe Ndreç tre persona me emra konkret janë ndaluar nga policia e shtetit duke shpërndarë para dhe janë liruar sërish.
2. Ka ardhur informacion që në një fshat në Berat po shpërndahej vaj ulliri falas në këmbim të votës.
3. Ka ardhur informacioni që një shtetas me emër konkret ka kanosur punonjësit e tij, (privat) për të ri orientuar të votojnë kandidatin e Partisë Socialiste, duke bërë shenjë në fletën e votimit.
4. Ka ardhur informacion që në qendër të Njësisë Administrative Velipojë po shpërndahen para.
5. Ka ardhur informacioni që në zonën e Njësisë Administrative Velipojë 16 persona me emra konkret po shpërndajnë para tek votuesit.
6. Ka ardhur informacioni që në qendër të qytetit të Kukësit në Hotel Gjallica ku ndodhet një zyrë elektorale po shpërndahen para.
7. Ka ardhur sërish informacioni që në këtë vend nuk ka shkuar asnjë punonjës policie për verifikim dhe se vazhdon e njëjta situatë.
8. Ka ardhur informacioni që një makinë me targa konkrete në Velipojë po shpërndan para.
9. Ka ardhur informacioni që një automjet me targa konkrete po shkon nëpër shtëpi të ndryshme për të shpërndarë lekë për votuesit.
10. Ka ardhur informacioni nga Partia Socialiste e Priskës që në Priskë të Vogël një automjet dyshohet që po shpërndan para.
11. Ka ardhur informacioni që një shtetas me emër konkret dhe me automjet me targa konkrete ka dhënë lekë një automjeti tjetër po me targa konkrete dhe është nisur në një drejtim të caktuar.
12. Ka ardhur informacioni që rreth orës 9 të mëngjesit po ndodhin akte dhune përpara një qendre votimi në Velipojë.
13. Ka ardhur informacioni që në Korçë në disa vende persona të cilët pretendohen që janë zyrtarë shtetërore (gjithsej 15) po shpërndajnë para për votuesit.
14. Ka ardhur informacioni i bërë publike në TV Klan për shpërndarje parash për një votues. Rasti i filmuar dhe transmetuar publikisht.
15. Ka ardhur informacioni që në qendër të Lushnjës 4 automjete fuoristrada po lëvizin nëpër qytet të armatosur duke intimiduar zgjedhësit. Këto automjete

afrohen shpesh pranë shkollës Kongresi i Lushnjës dhe qëndrojnë.

16. Ka ardhur informacioni që pranë shkollës Kongresi i Lushnjës në Lushnjë po shpërndahet para nga persona të ndryshëm.
17. Ka ardhur informacioni që përpara gjimnazit të Divjakës po shpërndahen para.
18. Ka ardhur sërish shqetësim që përpara shkollës Kongresi i Lushnjës po shpërndahen para dhe se ka persona në 5 automjete që po kërcënojnë votues.
19. Ka ardhur informacioni që në fshatin Rrapes në Kolonjë të Lushnjës po shpërndahen para nga dy shtetase. Informacioni shoqërohet me dy foto. Vizualisht duket që këta dy shtetase kanë lista ë dorë.
20. Ka ardhur informacioni nga Ministria e Financave që automjete të doganave po përdoren nga punonjësit edhe pse janë jashtë shërbimit.

Theksojmë që gjitha denoncimet që kanë ardhur pranë Task-Forcës **janë përcjellë nëpërmjet e-mailit apo dhe telefonit** (*whatsapp, sms, viber*) në drejtim të pikës së kontaktit me Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

Pothuajse në të gjitha rastet nga pika e kontaktit është kthyer përgjigja që e morëm informacionin e dërguar dhe e kemi referuar për ndjekje kryesisht tek Drejtoritë Vendore të Policisë së Shtetit.

Nga të gjitha rastet e referuara, pranë Task-forcës kanë ardhur vetëm **katër përgjigje (pika 1<sup>193</sup>, 2<sup>194</sup>, 15 dhe 19<sup>195</sup>)** sipas të cilave informacioni i ardhur pranë Task-Forcës nuk është i vërtetë. Dy nga këto përgjigje (15 dhe 19) kanë ardhur **në orën 22:16 të datës 25.06.2017**.

Të gjitha rastet e tjera të denoncuar janë akoma pa ndonjë përgjigje apo veprim konkret nga ana e Policisë për masat e marra apo rezultatet e verifikimit .

Drejtori i Policisë së Shtetit nëpërmjet shkresës Nr. 879/9, të datës 06.07.2017 ka informuar që Task-Forca ka marrë përgjigje për 16 prej këtyre rasteve, por **ky informacion nuk është i saktë dhe i vërtetë**.

<sup>193</sup> E-mail i datës 24.06.2017, ora 19:59, kthim përgjigje nga Z. Albert Dervishaj.

<sup>194</sup> E-mail i datës 24.06.2017, ora 19:37, kthim përgjigje nga Z. Albert Dervishaj.

<sup>195</sup> E-mail i datës 25.06.2017, ora 22:16, kthim përgjigje nga Z. Albert Dervishi për pikën 15 dhe 19.



Gjithashtu, vlen të theksohet fakti që Policia e Shtetit, nuk është treguar korrekte dhe bashkëpunuese sikur premtoi për ndërmarrjen e veprimeve konkrete për të verifikuar rastet e denoncuara.

Ky qëndrim ka ardhur me justifikimin që Kodi Zgjedhor dhe Udhëzimi për detyrat e Policisë së Shtetit nuk e lejojnë lëvizjen e forcave të policisë ditën e zgjedhjeve. *(Ky qëndrim është mbajtur në mbledhjen e Task-Forcës nga Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Z. Altin Qato, verifikuar nga materiali i zbardhur i mbledhjes)<sup>196</sup>*

Ky pretendim i ardhur nga drejtues të lartë të Policisë së Shtetit është absolutisht i pa mbështetur në Kodin Zgjedhor dhe në aktet e nxjerra për zbatim të tij.

Po ashtu ky pretendim i Policisë së Shtetit është në kundërshtim me vetë veprimet e policisë pasi në disa raste Policia e Shtetit ka konfirmuar që ka nxjerrë forca në terren për të kontrolluar territorin siç është rasti i pikës 2, dhe 20.

Udhëzimi Nr. 7, datë 23.03.2009, “Për detyrat e Policisë së Shtetit dhe Forcave të Ushtrisë në Zgjedhje” në asnjë dispozitë të tij, nuk kufizon lëvizjen e forcave të policisë me qëllim kontrollin e territorit apo kryerjen e veprimeve të tjera hetimore në rastet kur ka informacione se po ndodhin vepra penale.

Pretendimet e ardhura nga drejtuesit e Policisë së Shtetit janë në kundërshtim të plotë me dispozitat e këtij udhëzimi, sipas të cilit Policia e Shtetit ka detyrimin që në rast të lëvizjeve të forcave të policisë ***vetëm të dërgojë kopje të urdhrave pranë KQZ-së (Pika 1, e nenit 4 të Udhëzimit)*** dhe jo të kërkojë leje nga KQZ-ja siç u pretendua nga Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit në mbledhjen e Task-Forcës të datës 25.06.2017. Ky qëndrim i Policisë së Shtetit është jo ligjor.

Policia e Shtetit nuk ka qenë korrekte në rastet e adresuara nga Task-Forca apo Ministrinë, duke marrë në konsideratë që numri i tyre nuk ka qenë i ulët 22. Kërkesa duhej të ishin trajtuar me përparësi dhe të tregoheshin dhe për masat dhe procedurat e ndjekura.

### ***B. Rastet e denoncuara për shitblerje vote tek MPB***

---

<sup>196</sup> Proces- Verballi i mbledhjes i datës 25.06.2017, faqe 14.

Nga Ministria e Punëve të Brendshme në Raportin Përfundimtar janë referuar shumë aktivitete apo ngjarje të dhënies së parave apo të ushtrimit të presionit në këmbim të votave, ngjarje të cilat kanë cënuar procesin zgjedhor por për të cilat Policia e Shtetit nuk ka vepruar<sup>197</sup>. Konkretisht janë referuar këto ngjarje:

Në **Qarkun Kukës** janë denoncuar raste të përfshirjes së personave konkretë në shitblerje vote. Shuma e parave të dhëna për votë është 5 mijë lek të rinj.

Në **Qarkun Dibër** janë denoncuar rreth 10 (dhjetë) raste të shantazheve dhe kërcënimit të votuesve për t'i detyruar të votonin për një subjekt të caktuar politik. Janë denoncuar punonjës publikë që kanë shpërdoruar detyrën duke bërë favorizime në ndërtime të paligjshme, tollona me naftë etj.

Në **Durrës** janë denoncuar rreth 12 (dymbëdhjetë) raste të shpërndarjes së parave në këmbim të votave.

Në **Divjakë** janë denoncuar 2 (dy) raste të shpërndarjes së parave në këmbim të votave.

Në **Shkodër** janë denoncuar 3 (tre) raste ku janë shpërndarë para për vota.

Në **Gjirokastrë** është denoncuar 1 (një) rast për korrupsion aktiv në shitblerjen e votës.

Në **Pogradec** janë denoncuar 2 (dy) raste të shpërndarjes së parave në këmbim të votave. Në fshatrat Cerav, Bratomirë, Hudenisht, Alarup, Blacë, Guras dhe Mokër, janë denoncuar përfshirje të punonjësve të administratës publike në blerje votash.

Në **Krujë** janë denoncuar 2 (dy) raste të punonjësve të administratës publike që kanë shpërndarë para dy ditë para zgjedhjeve votuesve.

Në **Korçë** janë denoncuar 16 (gjashtëmbëdhjetë) raste të punonjësve të administratës publike duke shpërndarë para në këmbim të votave.

Në **Kurbin** është denoncuar një rast që një person me precedent penal është përfshirë në shpërndarje të shumave të mëdha parash për blerje votash.

Në **Sarandë** janë denoncuar 5 (pesë) raste ku persona me precedentë kriminalë janë përfshirë aktivisht për blerje të votave.

Në **Ksamil** është denoncuar një rast ku përfaqësues të një subjekti zgjedhor shpërndarë para në këmbim të votave.

Në **Delvinë** janë denoncuar 2 (dy) raste ku nga një punonjës policie është bërë presion me armë ndaj banorëve për të votuar dhe janë ofruar para në këmbim të votave..

Në **Tiranë** janë denoncuar 2 (dy) raste kur është ushtruar presion dhe janë kërcënuar votuesit.

---

<sup>197</sup> Shih **ANEKSI VI** në Raportin Përfundimtar nr.5474/1, dat. 10.7.2017 të MPB.

**Në raportin e MPB nuk jepen arsyt përse nuk është vepruar për ndjekjen e këtyre rasteve nga ana e Policisë së Shtetit.**

***C. Trajtimi i rasteve të denoncuar nga Zyra e ZV/Kryeministrit, Ministritë dhe institucione të tjera lidhur me shitblerjen e votës dhe intimidimin e votuesve nga punonjës të administratës shtetërore dhe forcave të policisë***

Zyra e Zëvendëskryeministrit ka marrë njoftim ditën e zgjedhjeve se shtetas të ndryshëm punonjës të administratës shtetërore në Qarkun e Korçës kanë ofruar të holla për zgjedhës të ndryshëm ose persona të tjerë të lidhur me zgjedhësin me qëllim për të marrë pjesë ose jo në zgjedhje apo për të votuar në një mënyrë të caktuar ose kanë përdorur funksionin e tyre publik për veprimtari politike ose zgjedhore.

Me konkretisht, pranë zyrës së Zëvendëskryeministrit, ka ardhur njoftimi që shtetasit e mëposhtëm po kryenin shpërndarje parash në zona të ndryshme të Korçës si më poshtë:

1. Kliton Kita me detyrë Drejtor i Taksave, Bashkia Korçë;
2. Enver Shahinas me detyrë Drejtor i INUV, Bashkia Korçë;
3. Andi Sula punonjës në ZVRPP, Korçë;
4. Solien Prifti me detyrë Drejtor ne Bashki;
5. Petrika Tollkuci me detyrë Drejtor i ISKSH;
6. Fioralba Vukatana me detyrë Drejtor e Arkivës, Korçë;
7. Erion Qelemeni me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve Korçë;
8. Artur Qeramixhiu në Dvoran;

Në Njësinë Administrative Pirg, Podgorie dhe Maliq, shtetasit e mëposhtëm:

1. Vullnet Gjolla me detyrë Drejtor i Bujqësisë;
2. Vasillaq Cinoku me detyrë Nënkyetar i Bashkisë Maliq;
3. Florenc Tabaku në Vashtemi;
4. Kleanthi Mingo në Pirg;
5. Besmir Kulla me detyrë inspektor tatimesh;
6. Pranvera Begolli në lagjen Nr. 3 Maliq;
7. Luan Riska punonjës i Drejtorisë së Bujqësisë Podgorie;

Për të gjithë këta shtetas është pretenduar nga informacioni i ardhur që po ofrojnë para dhe po përdorin funksionin e tyre publik për veprimtari politike ose zgjedhore.

Këtë informacion, zyra e Zëvendëskryeministrit e ka përcjellë nëpërmjet e-mailit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shtetit me qëllim verifikimin dhe marrjen e

masave të menjëhershme<sup>198</sup>. Policia e Shtetit nuk ka kthyer përgjigje nëse është verifikuar rasti apo jo. Gjithashtu rasti është referuar dhe në Prokurori, e cila ka njoftuar regjistrimin e çështjes penale.

Ministria e Arsimit informon se nga ana e Grupit të Monitorimit të situatës së ditës së zgjedhjeve është raportuar pranë Policisë së Shtetit rasti i lidhur me ngjarjen e intimidimit të votuesve nga punonjës të administratës së MAS. Konkretisht një Drejtoreshë Shkolle në Sauk, Njësia Administrative 2, po ushtronte presion ndaj votuesve në ambientet e qendrës së votimit me qëllim orientimin e votës së tyre. Në mbledhjen e Task-Forcës në ditën e zgjedhjeve, Policia e Shtetit argumentoi mos marrjen e masave për të ndjekur këtë denoncim për shkak të mungesës së burimeve njerëzore. Policia e Shtetit nuk ka ofruar disponibilitetin e bashkëpunimit as për ruajtjen apo sigurinë e institucionit shtetëror të MAS.<sup>199</sup> Policia e Shtetit edhe në raportimin e saj përfundimtar nuk ka informuar për procedurat e ndjekura për verifikimin dhe marrjen e masave procedural.

Ditën e zgjedhjeve datë 25.06.2017 përmes mediave të hapura u raportua një rast në shkelje të VKM nr. 473/2017, e faktuar, për një punonjës të administratës doganore/antikontrabanda, për keqpërdorim të aseteve shtetërore ditën e zgjedhjeve. Rasti është referuar në pikën e kontaktit në Policinë e Shtetit duke vënë në dijeni edhe anëtarët e Task-Forcës. Sipas informacionit të përcjellë të MF në raportin e saj nuk duket të ketë informacion në lidhje me procedurat e ndjekura në këtë rast.<sup>200</sup>

## X. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

### *(i) Mbi ecurinë e procesit zgjedhor*

1. DPPP nuk ka njoftuar raste konkrete të përdorimit të burimeve financiare nga veprimtaria e paligjshme në mbështetje të subjekteve elektorale, ndërkohë që MB ka raportuar ekzistencën e një fenomeni të tillë gjatë fushatës elektorale. Konkretisht, sipas Ministrisë së Brendshme, në zgjedhje janë angazhuar në mënyrë masive burime të dyshimtar financiare në shit-blerjen e votës nga subjekte politike në qeverisje ose persona të lidhur me këto subjekte.

<sup>198</sup> E-mail i dërguar Policisë së Shtetit në datën 25.06.2017, në orën 09:25.

<sup>199</sup> Shiko Raportin Përfundimtar të MAS, faqe 32.

<sup>200</sup> Shih Raportin Përfundimtar i MF, faqe 12.

Pa paragjykuar raportimet dhe analizat e DPPP, është fakt që kursi i këmbimit i monedhës Euro kundrejt asaj Lek, referuar Bankës së Shqipërisë<sup>201</sup>, duke filluar nga data 19.05.2017 (një ditë pas marrëveshjes politike) ka pësuar rënie domethënëse deri në ditën e parë të punës (27.06.2017) pas datës së zgjedhjeve, duke arritur kështu nivelin më të ulët prej shumë vitesh, për të rifilluar përsëri rivlerësimin.

***Rekomandohet që fenomeni i zhvlerësimit domethënës të monedhës Euro mes datave 19.05.2017 deri në 27.06.2017 të analizohet në mënyrë të thelluar dhe të koordinuar nga institucione kompetente si INSTAT, DPPP dhe Banka e Shqipërisë apo dhe institucione të tjera kompetente për të analizuar shkaqet dhe për vlerësuar nëse kjo rënie e monedhës Euro është e lidhur me përdorimin e saj në mënyrë informale për shitblerjen e votave apo vepra të tjera penale në fushën e zgjedhjeve.***

2. Nga informacionet e Ministrisë së Brendshme, rezulton se në zgjedhje janë angazhuar grupime të njohura kriminale në mbështetje të subjekteve politike në garën elektorale, veçanërisht në qarqet Dibër, Elbasan, Lezhë, Shkodër, etj.
3. Policia e Shtetit pavarësisht se ka shprehur vullnetin për një bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera dhe në monitorimin tërësor të zgjedhjeve, rezulton se një bashkëpunim i tillë nuk është materializuar në shumë raste të denoncimeve të referuara qoftë gjatë fushatës elektorale apo ditën e zgjedhjeve, duke mbetur thjeshtë një angazhim deklarativ. Sipas Ministrisë së Brendshme, puna e Policisë së Shtetit, në parandalimin e korrupsionit zgjedhor dhe parandalimin e angazhimit të grupimeve kriminale në procesin zgjedhor, për shkaqe objektive dhe subjektive, ka qenë joefektive.
4. Koordinimi mes Policisë së Shtetit dhe Ministrive dhe institucioneve të varësisë nuk ka qenë në nivelin e duhur sa i takon monitorimit të sjelljes së administratës gjatë fushatës elektorale.
5. Rezulton fenomen i përhapur shitblerja e votës. Në këtë proces ka pasur të përfshirë punonjës të administratës të nivelit të lartë dhe punonjës të policisë, të cilët pavarësisht denoncimeve nuk është arritur të vihen para përgjegjësisë.

<sup>201</sup>[https://www.bankofalbania.org/web/Kursi\\_i\\_Kembimit\\_2014\\_1.php?evn=srm&kk\\_rs\\_sr\\_CP=1&startDate=2017-05-10&endDate=2017-06-30&pubcat=1,2](https://www.bankofalbania.org/web/Kursi_i_Kembimit_2014_1.php?evn=srm&kk_rs_sr_CP=1&startDate=2017-05-10&endDate=2017-06-30&pubcat=1,2)

6. Në zbatim të masave operacionale të miratuara nga Task Forca, reagimi dhe mbështetja e Policisë së Shtetit nuk ishte në nivelin që u deklarua nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

***Rekomandohet** të merren masa për të gjetur përgjegjësit në strukturat e policisë të cilat nuk kanë mundur zbatimin e masave operacionale të dakordësuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.*

7. Ministria e Brendshme ka raportuar një numër të konsiderueshëm të punonjësve të policisë në mbështetje të subjekteve elektorale, apo edhe bashkëpunime me elementë kriminelë, për të cilën MB i ka kërkuar Drejtorisë së Policisë largimin nga detyra të këtyre punonjësve të policisë. Deri më tani rezulton që Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit nuk ka marrë masat e kërkuara.
8. Nga institucionet shtetërore (kryesisht Zëvendëskryeministri dhe ministrat teknik, si dhe Policia e Shtetit), janë dërguar në organin e prokurorisë rreth 110 raste të dyshuara për kryerje të veprave penale në fushën e zgjedhjeve të cilat janë në proces hetimi.

***Kërkohet fuqimisht një hetim eficient dhe inkurajohet** Prokuroria të procedojë sa më parë në hetimin e plotë të çështjeve të adresuara dhe të realizojë ndjekjen deri në fazën finale të gjykimit.*

9. Në Ministrinë e Brendshme, nga ana e qytetarëve kanë mbërritur 484 denoncime lidhur me veprat penale në fushën zgjedhore, prej të cilave:
  - a) Shpërdorim i autoritetit policor, 30 raste;
  - b) Marrja apo përdorimi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit, 34 raste;
  - c) Pengimi i zgjedhësve, 17 raste;
  - d) Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje, 70 raste;
  - e) Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore, 18 raste;
  - f) Korrupsioni aktiv dhe pasiv në zgjedhje, 315 raste.Këto raste nga Ministria e Brendshme i janë përcjellë për trajtim Policisë së Shtetit, e cila vetëm 69 raste ka adresuar në prokurori dhe nuk ka dhënë informacion për verifikimet apo procedurat e ndjekuara për rastet e tjera.

10. Është dokumentuar se në disa raste është përdorur veprimtaria institucionale për qëllime elektorale dhe politike. Përvetësimi i veprimtarisë shtetërore nga kandidatët për deputetë, ka krijuar një pabarazi midis forcave politike pjesëmarrëse në zgjedhje.
11. Është konstatuar përdorimi i aseteve në mbështetje të subjekteve elektorale nga Ministri, institucione varësie dhe Bashkitë. Janë përdorur gjithashtu aktivitete në kopshte, shkolla, inaugurimin e shesheve dhe rrugëve për fushatë elektorale të subjekteve elektorale në qeverisje, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore janë shpërndarë ftesa për të votuar një subjekt elektoral në kundërshtim flagrant me Kodin Zgjedhor. Nga ana tjetër, shkolla, kopshte, ambiente të institucioneve janë vënë në dispozicion të subjekteve elektorale.

***Rekomandohet** që në të ardhmen të jetë e ndaluar me ligj mundësia që aktivitete të tilla të jenë në shërbim të një subjekti elektoral, apo edhe të shpërndarjes së ftesave për të votuar një subjekt elektoral ta caktuar në ditën e heshtjes zgjedhore.*

***Rekomandohet** të hetohet nga organet e prokurorisë apo edhe të auditohet nga KLSH në lidhje me përdorimin e fondeve publike në drejtim të realizimit të ftesave, materialeve të tjera të propagandës shpërndarjes së tyre nga Bashkia Tiranë.*

12. Është konstatuar dhënia e privilegjeve të ndryshme gjatë fushatës elektorale, si pajisja me certifikatë pronësie, legalizimit, premtimi i vendeve të punës, premtimi i vlerësimit kalues ose më të lartë gjatë procesit të maturës shtetërore, etj.. Janë denoncuar raste të tjera të cilat kanë qenë të pamundur që të verifikohen dhe ndiqen sipas ligjit, si pasojë e mungesës së mjeteve dhe mekanizmave në dispozicion, dhe mungesës së bashkëpunimit me organet ligjzbatuese.

***Rekomandohet** që rastet e dhënies privilegjeve në rastin e maturës shtetërore, bursave të ekselencë s të denoncuar nga MAS, rastet e denoncimit të kontrabandës kafesë, të rimbursimit të TVSH apo subjektivitetit gjatë vlerësimit tatimor të denoncuar nga MF, si dhe listat me ndihmën ekonomike të denoncuar nga MMSR duhet të jenë objekt i auditit në të ardhmen nga ana e KLSH apo edhe të hetimit të mëtejshëm nga organi i Prokurorisë duke dalë në përfundime konkrete me qëllim bërjen e transparencës me publikun.*

13. Është konstatuar që gjatë këtij viti elektoral të jenë tenderuar vlera të cilat tejkalojnë disa herë buxhetin e miratuar të një ministrie të caktuar. Kjo dëshmon për përdorim të

kontratave të prokurimit për qëllime të mundshme elektorale, apo për veprime korruptive, që kërkojnë domosdoshmërisht verifikim të thelluar nga institucionet përgjegjëse ligjzbatuese.

***Rekomandohet** që në rastet e denoncuar nga MD të jenë objekt i auditimit nga KLSH apo edhe hetimit të mëtejshëm nga organet e hetimit me qëllim bërjen e transparencës.*

*Gjithashtu, rekomandohet që në të ardhmen në një vit elektorale të mos lejohen procedurat tenderuese, koncesionare apo PPP të ndryshme, dhe të mbahen nën kontroll procedurat përkatëse të tenderimit.*

14. Strukturat e Policisë së Shtetit nuk kanë raportuar përdorimin e automjeteve shtetërore të institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor për veprimtari të fushatës zgjedhore. Në Task-Forcë, nuk është evidentuar mënyra e realizimit të mbikëqyrjes mbi këtë çështje nga ana e Policisë së Shtetit. Nga ana tjetër, nga analiza e të dhënave nuk rezulton të ketë pasur abuzime me konsumin e karburantit të institucioneve gjatë fushatës elektorale, pavarësisht se duhet theksuar që ky përfundim nxirret mbi të dhënat e dërguara nga vetë institucionet dhe të pranuar në mirëbesim.
15. Nëpunës të administratës publike, edhe pse ishin regjistruar si kandidatë në zgjedhje, nuk kanë përbushur detyrimin për të kërkuar pezullimin apo largimin nga detyra, sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin civil apo legjislacionin e posaçëm që rregullon pozicionin e tyre të punës. Ato vazhduan në kundërshtim me ligjin ushtrimin e detyrës, duke mbajtur kontakt të përditshëm me nëpunësit e tjerë civil në institucione, apo punonjësit e tjerë sipas rastit.
16. Nëpunës të administratës publike, në kundërshtim me ligjin, janë përfshirë në fushatë zgjedhore, në mbështetje ndaj subjekteve të caktuara elektorale, apo në intimidim të votuesve apo punonjësve në varësinë e tyre, duke i shërbyer në këtë mënyrë forcave të caktuara politike.

*Së pari, është shqetësuese pjesëmarrja në fushatë e nëpunësve civilë. Megjithëse u konstatuan shumë raste të tilla gjatë gjithë fushatës zgjedhore, ishte tepër e vështirë ndjekja e këtyre rasteve dhe marrja e masave pasi ligji për nëpunësit civilë lejon pjesëmarrjen jashtë orarit zyrtar në veprimtari politike të subjekteve zgjedhore, por jo shprehjen publikisht të bindjeve.*



*Së dyti, situata e faktit tregoi që është thujse e pamundur të monitorohet në praktikë respektimi i një detyrimi të tillë ligjor dhe akoma më e pamundur të provuarit e rasteve të konstatuara. Dihet që nëpunësit civilë ushtrojnë funksionet sipas parimit të paanësisë politike, por monitorimi në praktikë i respektimit të këtij parimi është thujse i pamundur.*

*Është shumë e dëshirueshme, sidomos në një realitet mjaft të politizuar si Shqipëria, që nëpunësit civilë të qëndrojnë larg ndikimeve politike dhe përfshirjes në politike. Kjo për të realizuar qëllimin e ngritjes së një administrate profesionale në shërbim të qytetarëve. Ky qëllim mund të arrihet vetëm nëse administrata nuk është e varur nga vullneti i subjekteve politike dhe respekton realisht parimin e paanësisë politike. Mirëpo, ky parim apo më saktë monitorimi i respektimit të këtij parimi, është i pamundur të kryhet nëse nëpunësve civilë, të cilët duhet të jenë të paanshëm politikisht u njihet e drejta e anëtarësimit në parti politike apo edhe në nivele drejtuese të tyre për nivelet e mesëm e poshtë si dhe e drejta për të marrë pjesë në veprimtari politike gjatë fushatës zgjedhore (megjithëse pa shprehur bindjet publikisht), por pa u shprehur publikisht.*

*Konsiderohet e pamundur, sidomos në realitetin e politizuar shqiptar, që nëpunësit civilë të jenë anëtarë partie apo në organet drejtuese të tyre dhe të marrin pjesë në veprimtari politike zgjedhore, por nga ana tjetër të jenë të veprojnë sipas parimit të paanësisë politike duke mos u përfshirë në fushatë për partinë anëtarë/drejtues të së cilës janë apo duke mos shprehur publikisht bindjet e tyre.*

*Ndërsa lidhur me punonjësit me kontratë pune në institucione shtetërore apo ente publike e shoqëri shtetërore përsëri do të ishte e dëshirueshme që të mos merrnin pjesë aktivisht në fushatë.*

***Rekomandohet*** se duhet ketë ndalim të plotë për mosanëtarësim të nëpunësve civilë në partitë politike dhe aq më tepër në organe drejtuese të tyre, pavarësisht nivelit të nëpunësit dhe ndalim të plotë pjesëmarrjeje në veprimtari politike zgjedhore brenda dhe jashtë orarit zyrtar.

*Ndërkohë, që për punonjësit me kontratë pune mund të kishte një rregullim kufizues të llojit që përdoret aktualisht për nëpunësit civilë, pra të mund të merrnin pjesë në veprimtari politike zgjedhore në mënyrë pasive dhe të anëtarësoheshin në parti, por jo të shprehnin publikisht bindjet apo të merrnin pjesë në organet drejtuese të*

*partive.*

*Një kufizim i tillë mendojmë se do të kishte disi efekt kufizues edhe në masën e punësimeve, pasi këta punonjës në rast punësimi nuk do të mund të përdreshin për fushatë zgjedhore nga subjektet zgjedhore, pavarësisht se do të kishte efekt negativ nga ana tjetër në drejtim të deformimit të drejtpërdrejtë të vullnetit për të votuar të lirë të këtyre punonjësve në kushtet që janë përfitues drejtpërdrejt nga punësimi.*

17. Një pjesë e titullarëve të institucioneve (kryesisht ministrat e rinj teknik), kanë dokumentuar përfshirjen në fushatë apo veprimtari politike të punonjësve të administratës publike, duke marrë edhe masat e nevojshme në përputhje me ligjin për shkarkimin apo propozimin për shkarkim ndaj tyre. Megjithatë ka rezultuar se mjetet dhe metodat në dispozicion të tyre pamundësonin dokumentimin e të gjitha rasteve që i referoheshin. Ka munguar bashkëpunimi me strukturat e Policisë së Shtetit, të cilat ishin angazhuar në mbledhjet e Task-Forcës të vinin në dispozicion pika të posaçme kontakti në çdo qark për një bashkëpunim të drejtpërdrejtë dhe të shpejtë mes këtyre Ministrive dhe Policisë së Shtetit.
18. Ka rezultuar se raste të përfshirjes së administratës në fushatë të jenë evidentuar veç në ministritë apo drejtoritë të drejtuara nga ministra/drejtorë teknik. Nuk ka pasur asnjë raportim për raste të tilla nga Ministritë apo institucionet e tjera, gjë që provon mungesën e vullnetit për ndalimin real të përfshirjes së administratës në fushatë zgjedhore. Madje edhe në rastet kur është adresuar nga ana e një Ministri, në një institucion varësie, sërish nuk është marrë asnjë masë, pavarësisht se provat kanë qenë të pakontestueshme.
19. Nga informacioni i marrë zyrtarisht nga zyra e Zëvendëskryeministrit nga sistemi elektronik i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, rezulton se gjatë fushatës zgjedhore janë kryer rreth 3600 lëvizje të burimeve njerëzore në administratë publike (punësime, largime, transferime etj.), edhe pse gjatë kësaj periudhe duhet të vepronte neni 88, pika 3 e Kodit Zgjedhor. Për shkak se i njëjti informacion nuk është përcjell edhe nga vetë institucionet publike që kanë kryer lëvizjet (duke fshehur në këtë mënyrë informacionin), është e pamundur që të arrihet në përfundime nëse këto punësime janë kryer në përputhje me strukturat e institucioneve, enteve publike apo shoqërive shtetërore, apo janë punësime me kontrata të përkohshme jashtë organikës së miratuar.

*Faktin që punësimet lejohen brenda strukturës së miratuar para zgjedhjeve e shohim si problematike pasi duke qene fushata zgjedhor shumë e shkurtër vetëm një muaj, ekziston një rrezik i rritur që në periudhë të afërt para datës së fillimit të fushatës zgjedhore të kryhen ndryshime në strukturë me qëllim legjitimimin e punësimeve të reja edhe pas datës së fillimit të fushatës zgjedhore. Gjithashtu, punësimet të konsiderueshme mund të kryhen fare lehtë edhe në disa muaj para fillimit të fushatës zgjedhore për t'i paraprirë ndalimeve të punësimit gjatë saj.*

***Rekomandohet*** se ndalimi i nenit 88 të Kodit Zgjedhor duhet të shtrihet nga 1 janari i vitit zgjedhor deri në datën e zgjedhjeve dhe jo vetëm gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, e cila është shumë e shkurtër, vetëm një muaj. Kjo masë do të shmangte ndryshimin e strukturave dhe punësime në nivele të larta për qëllime përfitimi të forcave ta caktuara politike në një kohë të shkurtër para datës së fillimit të fushatës zgjedhore. Sigurisht punësime të justifikuara për raste emergjencash mund të kryhen.

***Rekomandohet*** që punësimet apo largimet gjatë fushatës elektorale të jenë objekt i auditit të performancës nga ana e KLSH në Ministritë, Institucionet e varësisë, Prefektura dhe Bashki për periudhën gjatë fushatës elektorale.

***Kërkohet fuqimisht një hetim efektiv dhe inkurajohet*** Prokuroria të vijojë hetimin mbi bazën e adresimit të kësaj çështje të bërë nga ana e Task-Forcës në lidhje me punë simet, shkarkimet, transferimet gjatë fushatës elektorale në kundërshtim me nenin 88 të Kodit Zgjedhor.

## **(ii) Mbi veprimtarinë e Task-Forcës**

1. Miratimi i VKM për monitorimin e zgjedhjeve në administratë publike, u miratua më datë 01.06.2017, pra pasi kishte filluar fushata zgjedhore, duke ulur ndjeshëm, për shkak të kohës së shkurtër në dispozicion, mundësinë për një monitorim efektiv të zbatimit real të saj dhe prodhimit të efekteve për parandalimin e fenomeneve negative në zgjedhje. Ndërkohë, edhe pse ishte miratuar një Urdhër i Kryeministrit, i cili trajtonte të njëjtin efekt, por në aspekte më të pakta, rezultoi të mos ishin marrë masa konkrete për zbatimin e tij.

*Iniciativa ligjore për monitorimin e mbarëvajtjes së procesit zgjedhor nëpërmjet miratimit të një VKM-je si instrument ligjor më i lartë se urdhri i Kryeministrit dhe me fushë veprimi më të gjerë kundrejt subjekteve që iu drejtohet dhe fushës së*

*zbatimit është një praktikë që mendojmë se duhet të vijojë në zgjedhjet e ardhshme.*

2. Task – Forca e ngritur për monitorimin e zbatimit të VKM nr. 473/2017, u konstitua më datë 5 Qershor 2017. Kjo strukturë kishte në dispozicion vetëm 20 ditë për realizimin e monitorimit dhe koha e shkurtër pamundësoi një monitorim efektiv, duke penguar në këtë mënyrë parandalimin e shfaqjes së elementëve negativ në zgjedhje. Nga ana tjetër, një pjesë e konsiderueshme e anëtarëve të saj (kryesisht në nivel ministrash), nuk morë pjesë në asnjë mbledhje të Task-Forcës, si dhe nuk përcollën në kohë informacionet e kërkuara. Gjithashtu, Task-Forca, nuk kishte në dispozicion mjetet e nevojshme financiare apo logjistike, për të kryer një proces real monitorimi. Të gjitha këto shkaqe, bënë të vështirë, deri në pamundësi, përmbushjen e misionit të ngarkuar.

*Ngritja e një Task-Force, të asistuar nga një sekretariat teknik për të ndjekur procesin dhe marrë masa në kuadër të procesit të monitorimit konsiderohet një praktikë e dobishme.*

*Praktika e kësaj here tregoi se miratimi i një instrumenti të tillë dhe ngritja e Task-Forcës është e dëshirueshme të kryhet më parë në kohë dhe të ketë një shtrirje në nivele dhe pozicione që e bëjnë efektiv funksionimin e monitorimit.*

3. Nga vetëdeklarimet rezulton se Ministrinë dhe Institucionet e varësisë në shumicën e rasteve kanë ngritur grupet e monitorimit, pavarësisht se në shumicën e rasteve nuk kanë treguar procedurën e monitorimit dhe efektivitetin e saj; si dhe kanë publikuar listën e aktiviteteve dhe të projekteve, pavarësisht faktit që nuk ka qenë lehtësisht i dukshëm në faqen zyrtare.
4. Informacioni nuk ka ardhur në formën e kërkuar dhe në cilësinë e duhur. Në të shumtën e rasteve ka pasur zvarritje në përcjelljen e informacionit apo raportimit në cilësinë e duhur, duke penguar përpunimin e informacionit nga ana e Sekretariatit Teknik dhe diskutimin e problematikave në mbledhjen e Task-Forcës sa i takon objektit të monitorimit. Institucioni i vetëm që nuk ka sjellë asnjë informacion dhe nuk ka bashkëpunuar me Task-Forcën, ka qenë Bashkia Tiranë.

*Rekomandohet fillimi i procedimeve disiplinore ndaj punonjësve të cilët kanë penguar përcjelljen e informacionit në kohën dhe cilësinë e kërkuar.*

5. Në mbledhjet e Task-Forcës nuk kanë marrë pjesë në asnjë mbledhje Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Ministri i Shtetit për Marrëdhënien me Parlamentin, ndërkohë që janë anëtarë të Task-Forcës. Nuk kanë marrë pjesë përfaqësuesi i Prokurorisë dhe KQZ, në cilësinë e subjekteve të ftuara.
6. Është konstatuar që në disa raste informacioni apo raportimi i bërë, nuk përputhej me raste të monitoruara drejtpërdrejtë nga Task Forca sipas kërkesave të subjekteve elektorale apo qytetarëve, duke e bërë të dyshimtë edhe të të dhënat e tjera të raportuara nga këto ministri.
7. Nuk janë vërejtur probleme në lidhje me angazhimin si komisionerë në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve të punonjësve të administratës dhe institucioneve të tjera.
8. Përfshirja e opozitës në qeverisje gjatë vitit elektorale, në funksion të garantimit dhe monitorimit të procesit zgjedhor është një praktikë shumë e mirë në kushtet e një demokracie ende të brishtë në Shqipëri, shpesh e shoqëruar me tensione politike, megjithëse që kjo përfshirje për të qenë efektive duhet të ndodhë më parë, konkretisht nga 1 janari i vitit zgjedhor dhe jo pak javë para zgjedhjeve për Kuvendin.

***Rekomandohet** 3-6 muaj para datës së zgjedhjeve. Në këtë mënyrë, procesit i monitorit dhe masat e marra apo rekomandimet e dhëna nga Task-Forca do të mund të kryhen me një ritëm normal pune. Njëkohësisht institucionet dhe entet apo shoqëritë shtetërore do të kenë më shumë kohë në dispozicion për të mbledhur e përpunuar informacionin dhe për t'ia referuar atë Task-Forcës të plotë e të saktë për çka kërkohet.*

*Gjithashtu, nisja e punës më herët nga Task-Forca do të mundësonte edhe një monitorim më të mirë dhe më të hollësishëm të enteve publike dhe shoqërive shtetërore në drejtim të mospërdorimit të aseteve të tyre në funksion të fushatës politike apo mos lidhjes së kontratave të reja të punës si mekanizëm për të shtuar zgjedhësit që votojnë për një subjekt të caktuar politik dhe deformuar vullnetin e lirë të zgjedhësve.*

### **(iii) Mbi problematikat në administratën publike**

1. Ministrat teknik janë përballur me pengesa artificiale në ushtrimin e detyrës së tyre, të krijuar nga nëpunës civil apo funksionarë politikë, të cilët kishin si qëllim të pengonin punën e ministrave në kuadër të monitorimit sipas objektit të përcaktuar në VKM

473/2017. Konstatohet se Departamenti i Administratës Publike dhe veçanërisht KMSHC, kanë mbajtur një qëndrim tërësisht të njëanshëm dhe mbështetës për sjellje të tilla penguese nga nëpunës civilë të nivelit të lartë.

2. Praktika tregoi se vetëm emërimet e ministrave dhe disa drejtorëve të lartë të administratës është i pamjaftueshëm dhe jo efektiv për të përmbushur misionin e parandalimit të përfshirjes së administratës në fushatë elektorale, apo përdorimit të institucioneve për qëllime elektorale. U vu re një qasje e thellë e mosbashkëpunimit nga nëpunësit civilë që refuzonin autoritetin e ministrit, të mbështetur në disa raste edhe nga DAP. Institucionet e varësisë së Ministrive nuk kanë përcollën informacion në lidhje me shkelje të mundshme referuar objektit të monitorimit.
3. Mungesat pa arsye dhe lejet vjetore, në përgjithësi nuk kanë qenë një problem shqetësues, pavarësisht se duhet të kishte një hetim të thelluar administrativ për ato raste kur u konstatuan mungesat të pajustificuara.
4. Konstatohet se ka pasur një mungesë të plotë vullneti për të bashkëpunuar nga ana e Departamentit të Administratës Publike dhe KSHMC, nën justifikimin se nuk është ndjekur në përputhje me ligjin procedura për marrje mase disiplinore, apo duke vepruar në tejkalim të kompetencave që i njej ligji një organi të pavarur si KSHMC-ja. Në fakt me keqardhje konstatojmë se ka një mungesë gatishmërie nga këto institucione për të marrë masa disiplinore, apo për të trajtuar me paanësi rastet e referuara/trajtuara, veçanërisht kur bëhet fjalë për nëpunës civilë të nivelit të mesëm e të lartë. Është vërejtur një frymë për të mbyllur në mënyrë të nxituar çështjet e referuara pranë këtij departamenti.

***Rekomandohet që të kontrollohet veprimtaria e Institucioneve të Pavarura të cilat mbikëqyrin shërbimin civil si KMSHC, për sa kohë ka rezultuar që në disa raste ka kapërcyer kompetencën dhe ka bërë vlerësime jo objektive, duke anashkaluar hetimin e plotë dhe të njëanshëm, gjatë procesit administrativ.***